

DECENTRALIZIMI FISKAL - NDIKIMI NË ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR - RASTI I LEZHËS (2002 -2014)

Fatlum NURJA

Dorëzuar
Universitetit Evropian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Ekonomike, me profil: “Ekonomi dhe Zhvillim i Qëndrueshëm”,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: **Prof.Asoc.Dr.Nevila XHINDI**

Numri i fjalëve: 58.000

Tirane, Janar 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë i nënshkruari Fatlum Nurja deklaroj nën përgjegjësinë time ligjore që jam vënë në dijeni nga UET për pasojat e një punimi në plagjiature dhe gjithashtu deklaroj se ky punim është punë e imja kërkimore dhe rastet që janë përdorur citime të subjekteve të tjera janë të referuara në punim.

DEKLARUESI

Fatlum NURJA

ABSTRAKT

Nevojat në rritje të njësive vendore për kapitale financiare, për të bërë të mundur financimin e projekteve të tyre në infrastrukturë dhe jo vetëm, për të përmirësuar e për të mbështetur planet e zhvillimeve vendore nuk kanë gjetur hapësirë në qeverisjen qendrore në tërë këtë hark kohor që nga fillimi i proceseve decentralizuese në Shqipëri. Vetëm 9.1 % (2014) e shpenzimeve të konsoliduara publike zënë shpenzimet vendore në të dy nivelet. Temat e decentralizimit fiskal janë tepër të debatueshme në harkun kohor 2002-2014 që shtrihet studimi, ndërsa temat e zhvillimeve vendore dhe rolit të njësive vendore në këtë proces janë pothuaj të paprekura fare.

Diskursi nëse thellimi i decentralizimit dhe në veçanti atij fiskal dhe si do ndikonte ai në zhvillimin ekonomik është trajtësë e këtij punimi. Hipoteza e punimit është: Nëse thellohet decentralizimi fiskal zhvillimi ekonomik vendor ka kaheje pozitive. Pyetjet kërkimore si: A ndikon decentralizimi fiskal në zhvillimin ekonomik vendor; A mund të bëhet një matje e tillë në mënyrë empirike ekonometrike; Cilët janë faktorët që ndikojnë në thellimin e decentralizimit fiskal dhe si ndikojnë ato në performancën e indikatorëve të zhvillimit ekonomik vendor, përgjigjet ndaj tyre, do jenë ato që do drejtojnë punën kërkimore në këtë punim, do vërtetojnë apo do hedhin poshtë këtë hipotezë të ngritur.

Metodologjia në të cilin është bazuar puna ime është përgjithësisht narrative në kapitujt e parashtrësës, analize krahasuese në trajtesën mes vendeve të SEE por edhe në krahasimin e indikatorëve në kohe të ndryshme por dhe për huamarrjen vendore. Domethënës është përdorimi i metodave Ekonometrike për të matur në mënyrë Empirike ndikimin dhe peshën e indikatorëve fiskal në zhvillimin ekonomik vendor.

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet nënës sime, e cila ka ditur te vozisë e paepur ne detin e trazuar të jetës, duke me dhënë nëpërmjet shembullit te saj hartën e daljes me sukses në bregun e qytetarisë e të dijes!

FALENDERIME

Falënderoj pa përjashtim të gjithë, familjare miq e kolege të cilët me nxiten për të filluar e përfunduar këtë punim, pa këtë shtyqe mbase kjo do ishte një ëndërr e porealizuar. Falënderoj Prof.Asoc.Dr.Nevila Xhindi e cila me ka asistuar e udhëhequr në këtë punim jo vetëm si tutore dhe udhëheqëse akademike por edhe si një mike e mire. Gjithashtu një falënderim të veçantë profesorëve dhe stafit të UET të cilët bënë të ndjehem komod në ambientin e tyre akademik dhe jo vetëm.

Ju jam mirënjohës!

PERMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE

- 1.1.** Identifikimi i problemit
- 1.2.** Objektivat e temës
- 1.3.** Pyetjet kërkimore
- 1.4.** Ndërtimi i hipotezës
- 1.5.** Qasjet Metodologjike
 - 1.5.1.** Rishikimi i literaturës
 - 1.5.2.** Mbledhja e të dhënave
 - 1.5.3.** Hartimi i pyetësorëve, mbledhja dhe përpunimi i gjetjeve
- 1.6.** Kufizime

KAPITULLI II: BAZAT TEORIKE DHE INSTRUMENTAT E ZHVILLIMIT METODOLOGJIK TË TEMËS

- 2.1.** Koncepte bazë
 - 2.1.1.** Decentralizimi fiskal si instrument i zhvillimit ekonomik vendor
 - 2.1.2.** Zhvillimi ekonomik
 - 2.1.2.1.** Zhvillimi ekonomik vendor/rajonar
- 2.2.** Zhvillimi ekonomik vendor dhe planifikimi strategjik
- 2.3.** Matja e zhvillimit ekonomik vendor
 - 2.3.1.** Indikatorët e zhvillimit ekonomik vendor
 - 2.3.2.** Indikatorët e decentralizmit fiskal

KAPITULLI III: PROCESET DECENTRALIZUESE NE EUROPEN QENDRORE DHE LINDORE

3.1 NDRYSHIMET NE EVROPEN LINDORE

3.1.1 Ndryshimet në Evropën Qendrore dhe Lindore

3.1.2 Ndryshimet në Evropën Juglindore

3.1.3 Ndryshimet në vendet e Ballkanit Perëndimor

3.1.3.1 Zhvillimi Ekonomik Vendor ne Vendet e Ballkanit Perëndimor

3.1.3.2 Zhvillimi Ekonomik Vendor, Roli i Qeverisjes Vendore në
Vendet SEE

3.2 PROCESI I DECENTRALIZIMIT NE SHQIPËRI

3.2.1 Trashëgimia Vetëqeverisëse Vendore në Shqipëri (Qasje e Shkurtër
Historike)

3.2.2 Reformat Decentralizuese Post Komuniste

3.2.3 Strategjia e Decentralizimit (1999)

3.2.4 Zhvillimi i Bazës Ligjore dhe Institucionet

3.2.4.1 Ligji Organik (Strukturat, Funksionet, Financat)

3.2.4.2 Ligje të tjera bazë që afektojnë qeverisjen vendore

3.2.4.3 Kuadri ligjor për Decentralizimin Fiskal

3.3 DECENTRALIZIMI FISKAL NË SHQIPËRI

3.3.1 Instrumentet financiar të qeverisjes vendore

3.3.1.1. Të ardhurat nga burimet e veta (Taksa dhe Tarifa Vendore)

3.3.1.2. Transfertat ndërqeveritare

3.3.1.3. Taksat e ndara

3.3.1.4. Huamarrja vendore

3.3.2. Indikatorët e Decentralizimit Fiskal SEE /Shqipëria

KAPITULLI IV: ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR NE SHQIPERI

4.1. ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR DHE PABARAZITE RAJONALE

4.1.1. Treguesit demografik

4.1.2. PBB sipas Rajoneve

4.1.3. Punësimi/Papunësia

4.1.4. Treguesit Rajonal për Biznesin

4.2. DECENTRALIZIMI FISKAL NDIKIMI NË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR (NJËSITË VENDORE LEZHË)

4.2.1. Përse zgjidhet Lezha si një kampion studimor?

4.2.2. Situata dhe treguesit ekonomik bazë të qarkut Lezhë

4.2.3. Treguesit fiskal të njësive vendore të Qarkut Lezhë (2002-2014)

4.3. ANALIZA E TREGUESVE EKONOMIK DHE FISKAL (2002-2014)

KAPITULLI V: MATJA E NDIKIMIT TË DECENTRALIZIMIT FISKAL NË ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR

5.1. Zgjedhja e Modelit Ekonometrik

5.2. Regresi i shumëfishtë (trajtesë e shkurtër teorike)

5.3. Përzgjedhja e indikatorëve (variabileve të pavarura dhe të varura)

5.4. Regresi i shumëfishtë në matje të ndikimeve fiskale në Zhvillimin Ekonomik Vendor

5.5. Gjetje dhe konkluzione

KAPITULLI VI: HUAMARRJA, INSTRUMENT I FINANCIMIT TË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR

- 6.1.** Elementet e financimit të zhvillimit vendor
- 6.2.** Financimi i zhvillimit ekonomik vendor
- 6.3.** Financimi i zhvillimit ekonomik vendor rasti i Shqipërisë
- 6.4.** Huamarrja, si një instrument i zhvillimit ekonomik vendor.
 - 6.4.1.** Huamarrja vendore, rasti i Shqipërisë.
 - 6.4.2.** Marrëveshja me FMN dhe kufizimet që sjell në huamarrjen vendore.
- 6.5.** Konkluzione dhe Rekomandime
 - 6.5.1.** Konkluzione
 - 6.5.2.** Rekomandime

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME (GJETJE, KONKLUZIONE, REKOMANDIME)

- 7.1.** Gjetjet e punimit
- 7.2.** Konkluzione për decentralizimin fiskal dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik vendor
- 7.3.** Rekomandime

PËRSHKRIM I KAPITUJVE TË PUNIMIT

Punimi i doktoratës në Ekonomi dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, me temë: Decentralizimi Fiskal – Ndikimi në Zhvillimin Ekonomik Vendor-Rasti i Lezhës (2002-2014) është ndarë në 6 kapituj plus kapitulli i gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimet.

Ndarja në këtë formë, struktura e saj është imponuar nga trajtesa në Vend dhe në Kohë.

Punimi fillon e zhvillohet në qasje teorike, vëzhgime dhe analiza krahasuese në Evropën Lindore, Juglindore, në vendin tonë nga viti 2002 deri në vitin 2014.

Kjo trajtesë dhe analizë krahasuese më ka shërbyer si bazë për të vëzhguar se çfarë ndodh dhe si influencohet zhvillimi vendor nga financat vendore të cilat në rolin e variabëlve të pavarura ndikojnë dhe paraqesin zhvillimin vendor në mënyrë empirike nëpërmjet indikatorëve të tij bazuar në analizën empirike të regresit linear të shumëfishtë.

Më poshtë po japim një prezantim të shkurtër të përmbajtjes së Pjesëve dhe Kapitujve.

KAPITULLI I: HYRJE

Kapitulli i parë flet për pikënisjen dhe identifikimin e problemit, objektivat që ka ky punim apo kjo temë, prezantimit dhe shtrimit të pyetjeve kërkimore, ngritjes së hipotezës në, qasjen metodologjike si dhe kufizimet në lidhje me resurset apo të dhënat primare dhe sekondare me të cilat kam menduar se do ballafaqohem dhe që realisht jam ballafaquar gjatë punës sime.

KAPITULLI II: BAZAT TEORIKE DHE INSTRUMENTAT E ZHVILLIMIT METODOLOGJIK TË TEMËS

Në këtë kapitull janë parashtruar dhe trajtuar konceptet bazë teorike të decentralizimit, zhvillimit ekonomik vendor (ZHEV) dhe veçanërisht decentralizimit fiskal (DF) si një instrument i ZHEV. Po kështu në këtë kapitull prezantohet instrumenti planifikues i ZHEV, i cili bën së bashku elementet zhvillues dhe i organizon ato në mënyrë strategjike. Po kështu në këtë kapitull do sqarohen se kush janë indikatorët e ZHEV dhe DF do krijojnë parashtrësën për trajtimet e mëtejshme të analizës empirike.

KAPITULLI III: PROCESET DECENTRALIZUESE NË EUROPËN QENDRORE DHE LINDORE

Në këtë kapitull do trajtohen në mënyrë Kronologjike kohore dhe hapësirë proceset e reformave decentralizuese e ish vendeve të Lindjes, të Evropës Qendrore dhe Lindore, të vendeve të Evropës Juglindore dhe të Ballkanit Perëndimor. Analiza nuk do jetë shteruese por një analizë kronologjike dhe krahasuese. Temat që do trajtohen në këto grupe vendesh janë ato të lidhura me pyetjet kërkimore për vërtetimin e hipotezës, pra ZHEV dhe DF.

Pas analizave të vendeve të ish bllokut në rrugën drejt proceseve të decentralizimit dhe të autonomisë vendore në këtë kapitull do të analizohet procesi i decentralizimit të qeverisjes në Shqipëri, do trajtohen elementet financiar të qeverisjes vendore si trajektorja, efektshmëria dhe rendimenti tyre në vitet e ndryshimeve të konsolidimit të institucioneve vendore. Në fillim për qasje historike ka një trajtesë të shkurtër të trashëgimisë sonë të qeverisjes vendore. Në fund të këtij kapitulli do kemi një analizë

krahasuese të indikatorëve fiskal dhe të autonomisë vendore në mes të vendeve të SEE-së si dhe konkluzionet nga kjo analizë që shpjegon parashtrësën e kapitujve më pas.

Po kështu në këtë kapitull është dhe pjesa që prezanton edhe punë kërkimore pas ndërtimit të bazamentit rajonal dhe teorik nën kontekst decentralizues dhe zhvillimor. Në Kapitullin e katërt do trajtohen indikatorët zhvillimor jo vetëm të rajoneve të Shqipërisë, por ato do përshkruhen edhe në një analizë krahasuese që do të përgjithësohen me gjetjet të cilat dhe do i ballafaqojmë me treguesit e ngjashëm të Njësive Vendore të Qarkut Lezhë .

KAPITULLI IV: ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR NE SHQIPERI (Rasti i njësive vendore të qarkut Lezhë)

Ky kapitull paraqet një punë kërkimore me bazë treguesit zhvillimor dhe fiskal vendor të njësive vendore të Qarkut të Lezhës, pasi bëhet një panoramë e treguesve dhe indikatorëve të ZHEV dhe të FD të Qarkut Lezhë. Këtu trajtohet arsyeja e përzgjedhjes të Lezhës si një rast studimor dhe se çfarë e bën të veçantë nga rajonet e tjera. Në këtë kapitull sqarohen të gjithë dinamikat e indikatorëve të ZHEV dhe FD të Qarkut Lezhë.

KAPITULLI V: MATJA E NDIKIMIT TË DECENTRALIZIMIT FISKAL NË ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR

Kapitulli 5-të është edhe një nga më kryesorët pasi kurorëzon pothuajse plotësisht punën kërkimore nëpërmjet një analizë empirike në bazë të metodës ekonometrike të regresit linear të shumëfishtë. Po kështu në bazë të këtyre analizave empirike del edhe ekuacioni linear i cili na tregon peshën specifike të indikatorëve fiskal dhe ndikimin e tyre në indikatorët e zhvillimit ekonomik vendor si: PBB/frymë, numri i bizneseve apo edhe punësimi.

**KAPITULLI VI: HUAMARRJA VENDORE, RAST I HUMBUR PËR
FINANCIMIN E ZHVILLIMIT EKONOMIK
VENDOR**

Huamarrja vendore, si element i financimit të zhvillimit vendor trajtohet veçmas në këtë kapitull pasi ajo nuk është aplikuar pothuajse fare nga njësitë vendore në Shqipëri. Një analizë krahasuese, kronologjike dhe financiare që do sjellë konkluzionet dhe rekomandimet që plotësojnë edhe kuadrin e analizës së indikatorëve të DF në Shqipëri.

**KAPITULLI VII: PËRFUNDIME (GJETJE, KONKLUZIONE,
REKOMANDIME)**

Kapitulli i 7-të, përmbledh punën e bërë në një numër gjetjesh, konkluzionesh dhe rekomandimesh. Bazuar në atë që analizat në këtë punim nuk janë shteruese por në mënyrë modeste sjellin në vëmendje ndikimin e ndryshoreve apo indikatorëve të varur apo zhvillimor në raport nga ndikimi i ndryshoreve të pavarura apo decentralizuese fiskale.

BIBLIOGRAFIA

Bibliografia e përdorur, cituar apo e konsultuar do përmbyll edhe pasqyrën e punimit që do ndiqni më poshtë dhe do e vlerësoni.

LISTA E TABELAVE

KAPITULLI II

Tabela II.1: Nivelet e decentralizimit.....	25
--	-----------

KAPITULLI III

Tabela III.1: Stoku i Borxhit Publik.....	82
--	-----------

Tabela III.2: Rritja në të Ardhura nga TBV-ja në periudhën (2007 – 2008).....	87
--	-----------

KAPITULLI V

Tabele IV.1: Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve- Dhjetor 2014.....	110
---	------------

Tabela IV.2: Numri popullsisë - Qarku Lezhë.....	115
---	------------

Tabela IV.3: Dendësisë së popullsisë viti 2014.....	116
--	------------

Tabela IV.4: PBB/frymë Qarku Lezhë (2002-2014).....	120
--	------------

Tabela IV.5: Punësimi dhe treguesit e lidhur me të në Shqipëri, 2001-2008.....	121
---	------------

Tabela IV.6: Punësimi sipas Qarkut, 2010 dhe 2014.....	124
---	------------

Tabela IV.7: Punëkërkues të papunë afatgjatë sipas qarqeve.....	125
--	------------

Tabela IV.8: Rritja e PBB sipas qarqeve dhe rajoneve NUTS-2.....	126
---	------------

Tabela IV.9: PBB për çmime korente/frymë sipas rajoneve statistikore.....	127
--	------------

Tabele IV.10: Numri i ndërmarrjeve sipas klasifikimit në BE (2012).....	129
--	------------

Tabela IV.11: Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe pronësisë (2013-2014).....	130
--	------------

Tabela IV.12: Ndërmarrje aktive sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik (2014).....	131
---	------------

Tabela IV.13: Klasifikimi ndërmarrjeve sipas numrit të punonjësve.....	131
---	------------

Tabela IV.14: Densiteti i popullsisë/km² Qarku Lezhë (2010-2014).....	135
---	------------

Tabele IV.15: Dinamika e demografisë së Qarkut Lezhë.....	136
--	------------

Tabela IV.16: Rritja reale e PBB % sipas Qarqeve.....	139
--	------------

Tabela IV.17: PBB/frymë, Qarku Lezhë.....	139
--	------------

Tabela IV.18: Krahasimi i granteve të Fondit të Zhvillimit Rajonal me NJQV-të	
--	--

sipas përkatësisë politike.....	140
Tabela IV.19: Mandatet sipas bashkive	141
Tabela IV.20: Mandatet sipas komunave.....	141
Tabela IV.21: Ndërmarrje aktive sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik 2014.....	144
Tabela IV.22: Bizneset Bashkia Lezhë.....	145
Tabela IV.23: Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor.....	147
Tabela IV.24: Njësite vendore sipas qarqeve/aktiviteti ekonomik dhe pesha specifike. % sipas aktivitetit ekonomik në total.....	149
Tabela IV.25: Numri i punonjësve sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe qarqeve.....	151
Tabela IV.26: Të ardhurave të veta, taks ndërtese dhe tokë bujqësore (Qarku Lezhë).....	152
Tabela IV.27: Te dhëna statistikore finaciare te NJQV qarkut LEZHE (2013)....	153

KAPITULLI V

Tabela V.1: Indikatorët e Zhvillimit dhe Indikatorët Fiskal.....	166
Tabela V.2: Të dhënat e indikatorëve Zhvillimor dhe Fiskal të Njësite vendore Qarku Lezhë. (2002-2014).....	174
Tabela V.3: Tabelë e Ekuacioneve.....	199

KAPITULLI VI

Tabela VI.1: Përbërja e të ardhurave të qeverisjes vendore në %.....	215
Tabela VI.2: Struktura e Shpenzimeve e Qeverisjes Vendore	216
Tabela VI.3: Huatë e nënshkruara nga pushteti vendor	221
Tabela VI.4: Stoku i borxhit vendor sipas NJQV.....	223
Tabela VI.5: Ecuria e disbursimeve (2010 - 2014).....	223

GRAFIKET

KAPITULLI I

Grafiku I.1: Transferta e Kushtëzuar (FZHR).....	4
---	----------

KAPITULLI III

Grafiku III.1: Përbërja bazë e të ardhurave vendore (pa qarqe) në miliardë lekë.....	83
Grafiku III.2: Përbërja bazë e të ardhurave vendore (pa qarqe) në %	83
Grafiku III.3: Të ardhurat e pushtetit vendor si % e PBB-së dhe totalit e të ardhurave publike në 2013: Shqipëria në krahasim me vendet e tjera në rajon.....	85
Grafiku III.4: Përbërja e të ardhurave të veta të QV-ve në miliardë lekë	88
Grafiku III.5: Përbërja e të ardhurave të veta të QV-ve në si %	88
Grafiku III.6: Tax se BV (2010-2014).....	90
Grafiku III.7: Taksa e pasurisë si % e PBB-së në Evropën Juglindore – 2012.....	91
Grafiku III.8: Transferrat qeveritare (2010-2014).....	93
Grafiku III.9: Të ardhurat e NJQV-ve si % e të ardhurave kombëtare nga tatimet dhe doganat dhe PBB-së.....	94
Grafiku III.10: Borxhi (Total dhe vendor ne % te PBB) në vendet e SEE.....	96
Grafiku III.11: PBB në vendet e rajonit për frymë (Euro)	98
Grafiku III.12: Të ardhurat e NJQV-ve si % e PBB dhe totalit të ardhurave publike në 2014.....	99
Grafiku III.13: Përbërja e të ardhurave vendore në Evropën Juglindore 2014....	100
Grafiku III.14: Të ardhurat Rajonit te Evropës Jug-Perëndimore (2006-2009-2014)	101
Grafiku III.15: Të ardhurat e konsoliduara publike dhe vendore për frymë	103
Grafiku III.16: Investime te qeverisjes vendore 2006-2009-2014.....	104
Grafiku III.18: Investime Lokale vs Qendrore si % e PBB (Euro).....	105

KAPITULLI IV

Grafiku IV.1: Shpërndarja e financimeve të FZHR (2009-2014).....	106
Grafiku IV.2: Raportit të shpenzimeve QQ/QV në vendet e BE-së (2013).....	107
Grafiku IV.3: Shpenzime Vendore të Sektorit Publik (2009).....	108
Grafiku IV.4: Ndarja e grantit të pakushtëzuar sipas sektorëve.....	110
Grafiku IV.5: Pësia e çdo qarku në PBB (2013).....	112
Grafiku IV.6: Dendësia e Popullsisë si Përqindje (%) e Mesatares Kombëtare.....	116
Grafiku IV.7: Indeksi i PBB-së për frymë vlerësuar për qark (2013)	119
Grafiku IV.8: Kontributi i rritjes 2013.....	120
Grafiku IV.9: % e Punëkërkesve (15-24) në raport me totalin e punëkërkesve (2010-2014).....	122
Grafiku IV.10: Investime të FSHZH 2011-2015.....	123
Grafiku IV.11: Investime FZHR (2009-2014).....	124
Grafiku IV.12: Treguesit Rajonal të Biznesit.....	130
Grafiku IV.13: koeficienti i ndryshimit të popullsisë sipas rajoneve(2010-2014)..	134
Grafiku IV.14: Ndryshimet demografike rajonale (2010-2014).....	135
Grafiku IV.15: Migracioni, Qarku Lezhë (2010-2014).....	136
Grafiku IV.16: Dinamika demografike Qarku Lezhë.....	137
Grafiku IV.17: PBB për frymë sipas qarqeve (2013).....	143
Grafiku IV.18: Ndërmarrjet jo Bujqësore Qarku Lezhë.....	145
Grafiku IV.19: Ndryshimi i punësimit 2013 -2014.....	146
Grafiku IV.20: Ndërmarrjet e reja sipas qarqeve grafik.....	147
Grafiku IV.21: Ndërmarrje aktive krijuar (shkallë lindshmërie).....	149
Grafiku IV.22: Grant i Pakushtëzuar Qarku Lezhë (2002-2014).....	155
Grafiku IV.23: Të ardhurat e veta Qarku Lezhë (2002-2014).....	155
Grafiku IV.24: Granti i Kushtëzuar - Qarku Lezhë (2002-2014).....	156
Grafiku IV.25: Investime FZHS Qarku Lezhë (2002-2014).....	157
Grafiku IV.26: Shpërndarja e financimeve të FZHR (2009-2014).....	157
Grafiku IV.27: Numri total i bizneseve - Qarku Lezhë(2002-2014).....	159
Grafiku IV.28: Ralizimi i të ardhurave nga bizneset Qarku Lezhë (2002-2014)..	159
Grafiku IV.29: Të punësuar- Qarku Lezhë (2002-2014).....	160

Grafiku IV.30: Autonomia fiskale- Qarku Lezhë (2002-2014).....	161
---	------------

KAPITULLI VI

Grafiku VI.1: Numri i NVM, Punësuar dhe Vlere Shtuar e NVM.....	208
Grafiku VI.2: Ecuria e borxhit publik/PBB ne vendet e rajonit.....	211
Grafiku VI.3: Të ardhurat e NJQV-ve si % e PBB dhe totalit të shpenzimeve publike (2014).....	214
Grafiku VI.4: Tendenca e shpenzimeve te qeverisjes vendore. (2002-2013).....	216
Grafiku VI.5: Investimet e qeverisjes vendore si pjesë e GDP (2006-2014).....	217
Grafiku VI.6: Investime te QV Euro/fryme (2006-2009-2014).....	217
Grafiku VI.7: Shpenzimet e qeverisjes vendore(% PBB) EEA 2012, Alb 2011....	218

LISTA E SHKURTIMEVE

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
DF	Decentralizimi Fiskal
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FZHR	Fondi i Zhvillimit Rural
GK	Granti i Kushtëzuar
GPk	Granti i Pakushtëzuar
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISD	Projekti “Mbështetje e Integruar për Decentralizimin”
KEVV	Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave
MF	Ministria e Financave
NALAS	Rrjeti i Shoqatave për Autonomi Vendore të Evropës Juglindore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla e të Mesme
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PBB	Prodhimi Brendshëm Bruto
PLGP/USAID	Projekti i planifikimit dhe qeverisjes vendore i USAID

SD	Strategjia e Decentralizimit
SDC	Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim
SHBSH	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
TAV	Të Ardhurat Vendore
TAVV	Të Ardhurat e Veta Vendore
TBV	Taksa e Biznesit të Vogël
TNQ	Transferta Ndërqeveritare
VEL	Vendet e Evropës Lindore

KAPITULLI: I HYRJE

1.1. Identifikimi i problemit

Njësitë vendore në Shqipëri me Ligjin Nr. 8653/2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” u ndanin në 374 njësi vendore të nivelit të parë bashki/komuna si dhe në 12 qarqe. Njësitë vendore, të ngarkuara nga Kushtetuta dhe Ligji 8652/2000, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" janë përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave që iu janë dhënë, sidomos sa i përket funksioneve të veta.

Sipas nenit 10 të Ligjit No.8652/2000 bashkitë/komunat kanë kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatorë për funksionet e veta të përcaktuara në këtë nen. Kompetencat për kryerjen e funksioneve të veta, komunat dhe bashkitë i ushtrojnë duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Në këtë nen, përcaktohen dhe kompetenca të tjera në përmbushjen e standardeve të vendosura kombëtare dhe mënyrën e financimit të tyre, por për punimin tim po mjaftohem të sjell në vëmendje vetëm kompetencën e cila ushtrohet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për pasojë, zhvillimi ekonomik vendor përcaktohet në këtë ligj si funksion i veti, i cili është njëkohësisht si derivat i politikave kombëtare dhe rajonale të zhvillimit ekonomik. Në kuadër të zhvillimit ekonomik vendor sipas ligjit të mësipërm përfshihen këto shërbime:

- a) Përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor;
- b) Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë;
- c) Zhvillimi i biznesit të vogël, si dhe zhvillimi i veprimtarive nxitëse si panairë e reklama në vende publike;
- ç) Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si: informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme;

d) Shërbimi veterinar;

dh) Ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave e burimeve natyrore me karakter vendor¹.

Siç shikohet, gama dhe fusha e shërbimeve që bashkia ka në kompetencën e vet sa i përket zhvillimit ekonomik vendor, është mjaft e gjerë dhe përfshin tregjet, pronat dhe shërbimet bazë për ekonominë vendore.

Me një fjalë, në funksionet e veta të njësive vendore nuk janë vetëm shërbimet publike utilitare vendore, por edhe zhvillimi ekonomik vendor. Në Shqipëri, dhënia e këtij funksioni qeverisë vendore nga Ligji Organik, nuk është pasuar edhe me ligje sektoriale apo dhe akte nënligjore, por ka ngelur si një e drejtë e cila nga njësitë e qeverisjes vendore (më pas NJQV) është ushtruar mbi baza vullnetarizmi dhe me nxitjen e donatorëve të huaj, në ato njësi vendore ku kanë ofruar asistencë. Pavarësisht kësaj, Planet Strategjike të Zhvillimit Ekonomik Vendor të njësive që arrinin ta kishin një të tillë në mungesë të financave dhe të instrumenteve financiarë për të financuar projektet e identifikuara, ngelnin ëndrra apo listë dëshirash. Në këto situata ka ndodhur implementimi i Planit Strategjik Rajonal të Mijëvjeçarit financiar nga PNUD, planet strategjike të zhvillimit ekonomik vendor për 5 bashkitë (Durrës, Shkodër, Korçë, Lezhë dhe Berat), të financuara nga Banka Botërore dhe OSI – Hungari dhe të menaxhuara nga Fondacioni FLAG, planet strategjike të qarqeve Shkodër, Lezhë, Tiranë, Elbasan, etj. Po kështu, me dhjetëra plane strategjike komunash e bashkish të financuara nga SCD, GIZ, SNV, etj.

Nga ana tjetër, vëzhguar fakti i mungesës financiare, njësitë vendore aktualisht kanë një raport të theksuar varësie nga financat qendrore. Vetëm 45-50% (2014) e shpenzimeve aktuale të njësive vendore mbulohen nga të ardhurat e veta, si dhe shpenzimet totale të njësive vendore në dy nivelet, bashki/komunë dhe qark, zunë jo më shumë se 2.3% të

PBB (2014), që është edhe më e ulëta në të gjithë vendet e rajonit dhe më e ulëta (përveç vitit 2012) që nga viti 2002, vit që ka filluar edhe monitorimi i decentralizimit fiskal në Shqipëri.²

Pavarësisht kësaj situate, por krahasuar me trashëgiminë sa i përket decentralizimit, hapa janë bërë në adresimin e problemeve që ka qeverisja vendore, në ofrimin e shërbimeve, në luajtjen e një roli modest në zhvillimin ekonomik, në menaxhimin e çështjeve të infrastrukturës urbane dhe jo vetëm. Por gjithsesi, përpjekje të tjera duhen bërë për të qartësuar funksionet dhe financat relevante dhe të mjaftueshme për kryerjen e funksioneve.


Kjo situatë e mungesës së financave vendore nuk është e vetmja që rëndon qeverisjen vendore për të luajtur rolin e saj në mbështetje të planeve për zhvillimin ekonomik vendor, por për më shumë edhe transfertat ndërqeveritare bëjnë të pamundur para shikueshmërinë e financave për të mbështetur dhe për të mbuluar funksionet dhe misionin e qeverisjes vendore.¹

Mënyra e financimit të qeverisjes vendore paraqet një strukturë të transfertave ndërqeveritare. Transfertat ndërqeveritare janë dy llojesh: Të pakushtëzuara dhe të kushtëzuara. Ndërsa të parat ndahen me një formulë e cila modifikohet pothuaj çdo vit dhe përfshihet në ligjin për buxhetin e shtetit, e dyta është një transfertë e cila mbulon kryesisht investimet e funksioneve të përbashkëta dhe jepet sipas një grupi kriteresh. Ky grant është quajtur nga viti 2006-2010 Grant Konkurrues (GK) dhe që në këtë vit e deri tani Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR). Nga shumë raporte të ndërkombëtarëve dhe të agjencive që kanë mbështetur këto procese si: USAID, PNUD, SDC etj., këto kritere janë quajtur jo transparente dhe të orientuara politikisht.³ Së fundmi, ka një

¹ "White Paper on Fiscal Decentralization" PLGP/USAID, OCT , 2012

tendencë për rritjen e Grantit të Kushtëzuar (Fondit të Zhvillimit të Rajoneve) në raport me atë të pakushtëzuar, tendencë kjo që shkon në kontrovers me autonominë vendore me konsolidimin e saj. Granti i Kushtëzuar ose Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nënkupton transferta direkte të kushtëzuara për shpenzime, investimet kapitale të ministrive të linjës në bazë të projekteve të qeverisjes vendore.

Grafiku I.1: Granti i Kushtëzuar (FZHR) *milion*



Burimi: Ministria e Financave,

Transformimi i kriterëve të këtij granti (Fondi për Zhvillimin e Rajoneve) ka qenë edhe një nga objektivat e projektit ISD të financuar nga EU dhe PNUD. “*Raporti i PNUD-it rekomandon përmirësimin e kriterëve për përzgjedhjen e projekteve, ruajtjen e nivelit të financimit në një nivel konstant të PBB-së apo të buxhetit kombëtar të investimeve dhe shpërndarjen e fondeve sipas qarqeve dhe jo sipas prioriteteve kombëtare apo vendore. Këto rekomandime duhet të vihen në zbatim*” (PLGP/USAID 2012:15).

Shumëllojshmëria e të ardhurave dhe i natyrës së financimit të qeverisjes vendore është pjesë e parimeve bazë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore dhe Ligjit Organik No.8652/2000. Nisur nga ky parim, nga synimi për zgjerimin e autonomisë

vendore si dhe nga qasja e një politike për thellimin e decentralizimit fiskal në vitin 2008, Parlamenti miratoi Ligjin No.9869 “Për Huamarrjen Vendore”.

Praktikisht kjo mundësi, pra huamarrja vendore, si një instrument financimi për njësitë vendore nuk është përdorur ose është përdorur në sasi tepër të limituar, të papërfillshme, situatë kjo nga kufizimet ligjore dhe aktet administrative të emetuara nga Qeveria Qendrore. Për pasojë, njësive vendore i mungon një rol domethënës në Zhvillimin Ekonomik Vendor, i cili një nga instrumentet e financimit të projekteve madhore të tij ka huamarrjen vendore. Kjo situatë vihet re nga borxhi për frymë i njësive vendore në Shqipëri, i cili është më i ulëti në Evropë me afërsisht 1.36 USD/frymë (2014), kur në një kohë që stoku i borxhit nga Qeveria qendrore është ndër më të lartit 2,270 USD/frymë (1USD=100 L).

E gjithë sa thashë më sipër, e bën të qartë nevojën për të ri konsideruar rolin e njësive vendore në zhvillimin ekonomik vendor, si dhe për të ri konsideruar volumin dhe instrumentet financues të njësive vendore për planet e zhvillimit ekonomik vendor.

Në Shqipëri, njësitë vendore konsiderohen kryesisht si ndërmarrje komunale dhe agjenci ofrimi shërbimesh duke u mbajtur larg rolit si një aktor domethënës dhe i pazëvendësueshëm për zhvillimin e komunitetit, rol ky që komprometohet dukshëm nga autonomia e dobët fiskale që kanë njësitë vendore.

Kjo qasje apo ky projeksion është evidentuar edhe nga J.K.Gallbraith që shprehet:

“Unë besoj në një shtet demokratik, por unë jam i ndërgjegjshëm që edhe një shtet i tillë mund të maskojë dobësinë e institucioneve publike apo edhe vetë mungesën e shtetit”⁴

Gjatë dy dekadave të fundit, decentralizimi demokratik ka qenë një element kryesor i rendit të ditës "qeverisjes së mirë" dhe ka patur një qëllim të përbashkët në listën e gjatë

të reformave të lidhura me parime të ngjashme që i japin formë një rendi dite apo programi të tillë të bashkësisë ndërkombëtare (EC Commission, 2001; PNUD, 1997; PNUD 2002; World Bank and IMF 2006; see also Hyden et al., 2004; Graham et al., 2003).

Po këtu: Relativisht pak theks i është dhënë decentralizimit si pjesë stimuluese e një programi ri nxitës të një “Shteti apo Njësie të Zhvilluar”.

Për këtë arsye, unë argumentoj se një diskutim i reformave të decentralizimit duhet të fillojë me njohjen e decentralizimit si një instrument në lidhje me zhvillimin ekonomik. Kjo mund të ndihmojë të kuptohet më mirë qëllimi dhe modalitetet për ndihmë të jashtme dhe për reforma decentralizuese me qëllim jo vetëm ofrimin e shërbimeve utilitare, por edhe luajtjen e një roli domethënës në zhvillimin ekonomik dhe vendor.

1.2. Objektivat e temës

Në vendet perëndimore, decentralizimi është një mjet efektiv për riorganizimin e qeverisjes, për të ofruar shërbime publike me efektive në “shtetet e post-mirëqenies”²⁵, të kohës. (Bennett, 1990; Wildasin, 1997, The World Bank Institute, 2004)

Autorë të ndryshëm i referohen instrumentalizimit të decentralizimit fiskal në funksion të zhvillimit ekonomik vendor. Në fakt, një fokusim i mprehtë tek instrumentet e decentralizimit për zhvillimin ekonomik është i ngjashëm me miratimin e “qeverisjes mjaftueshmërisht të mirë përkundrejt një trajtese gjithëpërfshirëse dhe normative”

² Një koncept i qeverisë në të cilat shteti luan një rol kyç në mbrojtjen dhe promovimin e ekonomik dhe mirëqenies sociale të qytetarëve të saj. Një shtet i mirëqenies është i bazuar në parimet e barazisë së mundësive, shpërndarjen e barabartë të pasurisë dhe përgjegjësisë publike për ata që nuk mund të përfitojnë nga dispozitat minimale të një jetë të mirë. Sipas këtij sistemi, mirëqenia e qytetarëve të saj është përgjegjësi e shtetit.

(Grindle, 2004). Këto trajtesa bëhen specifiku për nevojat për decentralizim në vendet në zhvillim.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe dhe në Shqipëri. Reformat e ndërmarra menjëherë pas zgjedhjeve të para pluraliste i dhanë jetë fillimit të reformave decentralizuese me fokus decentralizimin politik dhe duke prekur pak ose aspak atë administrativ dhe fiskal deri në vitin 2000. Më parë, në vitin 1999, Karta Evropiane e Autonomisë Lokale ishte miratuar nga Parlamenti dhe parimet e saj ishin futur në Kushtetutë në vitin 1998. Pas këtij viti përpjekjet i ngjajnë një sinusoide me ulje ngritje sipas një programi politik të aktorëve të shumicave qeverisëse dhe jo vetëm. Me nxitje të komunitetit ndërkombëtar, USAID, CoE, KE , BB, etj., në lidhje me këtë çështje, më pas, u ndërmorën hapa domethënës.

Por pavarësisht arritjeve në dekadën e fundit, Shqipëria ndodhet shumë më poshtë vendeve të tjera të Evropës Qendrore, Lindore, por edhe Juglindore, duke ju referuar kjo indikatorëve të decentralizimit fiskal. Aktualisht, në qeverisjen vendore kemi një situatë mjaft të rënduar financiare. Shumë bashki, pa llogaritur këtu komunat (308), ku vetëm një pjesë e tyre kanë arritur të mbulojnë një pjesë shumë të vogël të funksioneve të deleguara nga ligji, janë në vështirësi financiare.

Nisur nga ky këndvështrim, objektivat e kërkimit do të jenë identifikimi i faktorëve dhe indikatorëve bazë që matin decentralizimin fiskal dhe krahasimi i tyre e matja e ndikimit të tyre tek indikatorët që matin zhvillimin ekonomik vendor. Trajtesa e këtij problemi, duke u nisur nga një bazë teorike në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe vendor, do bëjë të mundur trajtimin e temës në mënyrë krahasuese dhe të matshme. Analiza nuk do jetë shteruese.

1.3. Pyetjet kërkimore

Vendet në zhvillim janë kthyer tek decentralizimi për të shpëtuar nga kurthet e qeverisjes joefektive dhe joefikase, paqëndrueshmërisë makroekonomike dhe rritjes joadekuate ekonomike (Bird dhe Vaillancourt 1999)⁶. Gjatë gjithë post komunizmit të Evropës Qendrore dhe Lindore, decentralizimi i shtetit është rezultat i drejtpërdrejtë i ndryshimeve nga sistemi socialist në ekonominë e tregut dhe në demokraci (Bird, Ebel, dhe Wallich 1995)⁷.

Pra, për sa cituar më sipër, decentralizimi nuk është qëllim në vetvete apo thjeshtë një etapë demokratizimi e periudhës post komuniste, decentralizimi duhet të japë instrumente për zhvillim, si dhe duhet që nëpërmjet efikasitetit dhe eficensës që ofron të ndihmojë në qëndrueshmërinë ekonomike. Si e tillë, edhe situata në Shqipëri duhet të tentojë drejt një qeverisje efikase dhe eficiente, nga një jo e tillë.

Në një raport të Bankës Botërore “Decentralizimi në Tranzicion”, rasti i Shqipërisë (2004)⁸ pavarësisht se është i këtij viti, situata deri në fund të viti 2014 (vit që edhe shtrihet studimi) ka mbetur e njëjtë, thuhet se:” Kjo nuk do të thotë se këto burime të transferuara janë të mjaftueshme për autoritetet vendore për të përmbushur përgjegjësitë e tyre të reja. Së pari, për shkak se sasia aktuale dhe cilësia e shërbimeve (transferuar nën një sistem të dekoncentruar) janë fort të kënaqshme. Së dyti, pasi standardi i shërbimeve që do të ofrohet nga autoritetet vendore ende nuk është përcaktuar, kostoja nuk është e mundur të llogaritet. Po kështu, në lidhje me vërejtje nga ana e qeverisjes vendore për mos avancim të procesit të decentralizimit dhe të transferimit të funksioneve nëpërmjet një kontrolli makroekonomik, në po këtë raport të Bankës Botërore, thuhet dhe teksti vetëm i referohet faktit se: sasia e burimeve financiare

zhvendosur për qeveritë vendore, korresponдон me të njëjtën sasi që kishte qeverisja qendrore, pra që do të ishte nën kontrollin e ministrisë së linjës. Në këtë mënyrë, decentralizimi nuk është duke rritur shpenzimet e përgjithshme publike.

Pas 10 viteve është e njëjta situatë. Në strategjinë e decentralizimit të miratuar nga Qeveria Shqiptare në gusht 2015, në pjesën përshkruese të situatës aktuale thuhet: “Nga gjetje të aktorëve të ndryshëm që kanë kryer studime dhe kanë emetuar raporte, duket qartë se situata është në amulli sa i përket decentralizimit fiskal, dhe për rrjedhojë, në mungesë të resurseve edhe qeverisja vendore nuk ka mundur të luajë rolin e saj ku në disa raste ajo edhe është diskredituar”.

Duke u nisur nga këto të dhëna paraprake dhe këto vëzhgime të kryera dhe raportet e institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtare, si BB dhe USAID jam i bindur që të fokusohem në hipotezën time duke përcaktuar dhe pyetjet kërkimore.

Pyetjet kërkimore:

- **A ndikon decentralizimi fiskal në zhvillimin ekonomik vendor?**
- **Cilët janë faktorët e decentralizimit fiskal dhe si ndikojnë ato në përmirësimin e indikatorëve të zhvillimit ekonomik vendor?**
- **A mund të bëhet një matje e tillë në mënyrë empirike ekonometrike?**

Përpjekja për t’i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve do e bëjë të mundur nxitjen e kërkimit shkencor në lidhje me hipotezën e prezantuar. Kam besim se një gjë e tillë është e mundur.

Përpjekje të tilla janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen në botë dhe konkluzionet janë të ndryshme. Natyrisht, faktor bazë për një konkluzion që e mbështet këtë hipotezë apo e

rrëzon atë nuk është një, por janë një sërë faktorësh relevant. Stadi ekonomiko-social i një vendi është faktor vendimtar, por edhe situata dhe kompozimi apo trashëgimia politike institucionale në raport me demokracinë dhe shtetin e së drejtës janë faktor kyç.

Ne kushtet e sotme, shprehet Civici ne librin e tij ‘Dilemat e Zhvillimit’, “Niveli i demokracisë vlerësohet me filtrin e qeverisjes së mirë, d.m.th. se sa kjo demokraci krijon mundë për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe marrjen e vendimeve të duhura politike ne favor të zhvillimit”. (Civici, A. 2007:81)

Një gjë e tillë e forcon akoma më shumë bindjen time se, meqë çdo vend ka tiparet e veta dalluese, atëherë duhet të bëhet e mundur identifikimi dhe vendosja e tyre në një bazë teorike, në mënyrë që konkluzionet t’ia vëmë në dispozicion jo vetëm stafëve dhe ambienteve akademike, por kryesisht politike bërësve dhe vendimmarrësve, në mënyrë që të projektojnë strategjitë sektoriale dhe jo vetëm.

1.4. Ndërtimi i hipotezës

Ka një përpjekje domethënëse për të trajtuar çështje të financave vendore si një dhuratë apo vullnet thjeshtë politik të maxhorancave qeverisëse. Shumë pak i është kushtuar vëmendje arsyes ekonomike të këtij instrumenti financiar, parë kjo edhe në raport me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore. Çështjet e financimeve të qeverisjes vendore, përtej elementeve dhe këndvështrimit apo arsyeve politike që kanë shoqëruar decentralizimin në ish-vendet komuniste janë çështje edhe të ekonomisë dhe të zhvillimit në përgjithësi. Këtu studiuesit ndahen në atë që, thellimi i decentralizimit fiskal ka ndikim pozitiv apo negativ në zhvillimin ekonomik vendor. Po të shohësh studiues, akademikë apo ekspertë të ndryshëm në ligjërimet apo botimet të tyre, kupton që në fakt këndvështrimi i tyre ndikohet jo vetëm nga vëzhgime teorike apo empirike të asaj që ato e quajnë decentralizim fiskal, por kryesisht nga vendi dhe konteksti

ekonomiko-politiko-social i këtij vendi. (Bahl, Wallich, 1992; World Bank, 1990, 1992).⁹

Nisur nga një përvojë e theksuar centralizimi që trashëgon struktura e qeverisjes në Shqipëri, si dhe nga një demokraci vendore jo e konsoliduar, mendoj që është me vend dhe mbase edhe frytdhënëse që të bëhet një punim i tillë. Ky punim do shërbejë të shpërndajë një mjegull në rropatjen dhe në lëkundjen periodike të këtyre viteve, që i ngjan një lavjerrësi, sa i përket financimit të njësive vendore, dhënies së lirisë së veprimit financiar njësive vendore apo edhe kryesisht rritjes së financave vendore me fokus jo vetëm në kryerjen e shërbimeve me efikasitet dhe efikasitet, por edhe ndikimit të tij në zhvillimin ekonomik vendor. Kjo tendence shprehet edhe nga Oates (1994), Bruno dhe Pleskovic (1996), “në dekadat e fundit ka patur një interes të shtuar ndërmjet specialistëve që merren me çështje të zhvillimit, agjencive multilaterale të zhvillimit, agjencive ekonomike dhe qeverive për decentralizimin fiskal si një instrument primar në rritjen ekonomike”.

Hipoteza ime është optimiste, ajo e sheh dhe pret nga studimi të vërtetohet që:

- Thellimi i decentralizimit fiskal bën që zhvillimi ekonomik vendor të ketë kaheje pozitive.
- Rritja e koeficientit të Autonomia fiskale është nxitës në rritjen e treguesve të zhvillimit ekonomik vendor.

Kjo hipotezë, në gjithë përfshirjen e trajtesës së saj, do bëhet duke analizuar një sërë faktorësh dhe elementesh që përvijojnë “shkakun” fiskal dhe decentralizues, si dhe “pasojnë” që është zhvillimi ekonomik vendor. Ajo do të përfshijë:

- Prezantim, përshkrim të qasjeve teorike, duke analizuar dhe sjellë si konkluzione të mëparshme studime, ese, botime, raporte, statistika, etj. në rrafsh

ndërkombëtar në raport me decentralizimin, atë fiskal dhe zhvillimin ekonomik vendor.

- Një përshkrim të situatës në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore si dhe atë Juglindore (vendet e Ballkanit) dhe këndvështrimet e tyre në lidhje me atë sa u tha në hipotezë.
- Një përshkrim të situatës në Shqipëri në 12 viteve të fundit.
- Analiza të njësive vendore të qarkut Lezhë në tërësi si dhe në vitet e fundit;
- Ndërtimi i një modeli ekonometrik (ndryshoret e pavarura fiskale dhe të varurat zhvillimore).
- Analiza e huamarrjes vendore si një instrument domethënës i zhvillimit ekonomik dhe i përmirësimeve kapitale në qeverisjen vendore.
- Intervista me kryetarë të bashkive me të rëndësishme në vend për të ballafaquar këndvështrimet e tyre për ndryshime të nevojshme me konkluzionet nga analizat ekonometrike.

1.5. Qasjet Metodologjike

Raportet narrative nuk mungojnë për të përcaktuar situatën në financat vendore të Shqipërisë, por natyrisht ka edhe informacione për qasje dhe këndvështrime teorike në nivel evropian dhe më pak rajonal. Jo në sasinë e duhur prezantohen edhe të dhënat për zhvillimin ekonomik vendor. Mungesa e trajtesave në rrafshin teorik dhe studime apo dokumente politikash sa i përket zhvillimit vendor, siç duket ka ardhur edhe nga një mungesë orientimi bazë për të përcaktuar modelin apo strategjitë kombëtare, si dhe instrumentet nxitës të përfshirjes së qarqeve akademike, studiuesve dhe jo vetëm. Një pjesë e tyre ekzistojnë vetëm në nivel raportesh të agjencive të huaja financiare apo

partnerësh ndërkombëtarë që monitorojnë ecjen tonë drejt BE-së.¹⁰ Nevoja e punimit tim do jetë së pari, identifikimi i indikatorëve për decentralizimin fiskal si dhe atyre në matjen e zhvillimit ekonomik vendor. Në punime të ndryshme këto variojnë duke përfshirë në mënyrë më të detajuar të dhëna të ndara apo agregate për zhvillimin ekonomik vendor. Gjatë punës do mbështetem në përvojën e vendeve apo autorëve të tjerë si dhe duke u përshtatur me mundësinë e gjetjes së të dhënave në vendin tonë. Shtrirja e këtyre të dhënave për një periudhë 10 vjeçare do të jetë si parakusht për të matur me saktësi lëkundjet, si dhe për të identifikuar faktorët që e shkaktojnë atë. Po kështu, krahasimi i këtyre të dhënave me vende të tjera të rajonit do të jetë një nga instrumentet për të bërë më të qartë panoramën, statusin e vendit tonë, relativisht vendeve të tjera me të njëjtën bazë nisjeje, si dhe synimeve të punimit.

Në fund, ndërtimi i një modeli ekonometrik është dhe synimi bazë i punimit tim. Me anë të këtij modeli do bëhet analizë empirike e ndikimit të faktorëve të decentralizimit fiskal dhe shkallës së tyre në zhvillimin ekonomik vendor. Kjo analizë e kombinuar, mbështetur në studime të ngjashme apo të përafërta në vende të ndryshme apo në rajon, analiza me shtrirje në kohë, krahasimi i të dhënave dhe konkluzioneve, si dhe ndërtimi i modelit ekonometrik do të përmbyllin gjithë kuadrin e punës shkencore në mbështetje të hipotezës sime.

Analiza nuk do jetë shteruese, por do sjellë të dhëna krahasuese ndër vite dhe me vendet e tjera të rajonit, sipas një analize sasiore, si dhe duke u bazuar në përvoja ndërkombëtare mbi bazë të së cilave do të dalin konkluzione dhe rekomandime për përmirësimin e situatës.

1.5.1. Rishikimi i Literaturës

Literatura për këtë temë nuk është shumë e gjerë, por edhe jo fare e pa përpunuar. Çështje të tilla si kjo dhe të ngjashme kanë preokupuar studiues të ndryshëm në shumë vende, institucione akademike dhe kërkimore si dhe politologë apo sociologë.

Vlen të theksohet se literatura ndahet në dy këndvështrime, optimiste dhe pesimiste në lidhje me nevojat dhe thellësinë e proceseve decentralizuese, me ndikimin e decentralizimit fiskal në zhvillimin ekonomik vendor. Këndvështrimet apo konkluzionet e autorëve kanë të bëjnë me origjinën e vendit, trashëgiminë, mundësitë financiare apo kapacitetet fiskale, me burimet njerëzore dhe dinamikat demografike, etj. Literatura fokusohet në dokumente politikash, studime e raporte të ndryshme në lidhje me decentralizimin fiskal dhe zhvillimin ekonomik vendor në veçanti, si dhe me studime që i marrin në konsideratë të lidhura në tema të rritjes ekonomike. Po kështu, si literaturë për këtë punim janë marrë në konsideratë botime të ndryshme, statistika, etj. Literatura do të jetë e përshkallëzuar, do të ketë literaturë të bazuar në përvojat dhe hulumtimet ndërkombëtare, në ato rajonale, përkatësisht të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, si dhe të Ballkanit. Kryesisht në punim do përfshihen raporte të bëra në vendin tonë gjatë dekadave.

1.5.2. Mbledhja e të dhënave

Përgjithësisht është një fakt i pranuar që të dhënat primare për tema të tilla dhe të ngjashme mungojnë, janë të cunguara ose në rastin më të mirë paraqesin një vështirësi të madhe për tu qasur apo për ti patur. Pavarësisht vështirësive, kontaktet me institucionet vendore që do analizohen në këtë punim kanë qenë kyçi i punës në mbledhjen e të dhënave. Gjithsesi, të dhënat janë marrë nga Banka Botërore, Fondi

Monetar Ndërkombëtar, CoE, ISTAT, EuroStat, Drejtoria e Tatim Taksave Lezhë, Ministria e Financave, NALAS, Drejtoria Rajonale e Punësimit Lezhë, Qarku Lezhë, Bashkia e Lezhës, Kurbinit, Mamurrasit, Rrëshenit, Rubikut, etj. Gjithashtu, ato janë konsultuar edhe me të dhëna dhe vëzhgimet e programeve si: dldp, PLGP/USAID, GiZ, nga faqe të ndryshme informacioni në internet, etj.

Të dhënat përfshijnë një periudhë mbi 13 vjeçare (2002-2014) në mënyrë që gabimi në analizën krahasuese e të dhënave të jetë sa më i vogël dhe t'i afrohet shumë leximit të së vërtetës mbi hipotezën. Të dhënat janë marrë të shkëputura nga faktorë të tjerë relevant që ndikojnë në mënyrë direkte ose indirekte në zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, mund të themi se një gjë e tillë është bërë me vetëdije të plotë, si në pamundësinë e përfshirjes së tyre në punim, ashtu edhe në ndikimin e tyre jo thelbësor në hipotezën dhe sqarimin e pyetjeve shkencore të punimit. Të tilla të dhëna, si: numri i ndërmarrjeve bujqësore, investimet e ministrive të linjës, punësimi në sektorin publik, ndihma ekonomike apo shpenzime të donatorëve, nuk janë në konsiderate për dy arsye: 1) ato janë të shtrira në mënyrë konstante në gjithë vitet e studimit dhe 2) qeverisja vendore nuk ka ndonjë ndikim apo rol thelbësor dhe direkt në to.

1.5.3. Hartimi i pyetësorëve, mbledhja dhe përpunimi i gjetjeve.

Intervistat në këtë punim janë komplementare për të testuar situatën, rekomandimet si dhe për të krahasuar të dhënat dhe rezultatet empirike dhe ekonometrike.

Një temë e tillë është një qasje politikash të cilat ndërtohen, zbatohen dhe monitorohen nga aktorë relevant në terren, ndaj intervistat me kryetarët e bashkive, për sa unë dua të trajtoj në këtë punim, mendoj që janë thelbësore. Intervistat kanë përfshirë kryetar bashkish dhe zyrtarë vendorë në disa bashki në jug, veri apo edhe në Shqipërinë e

mesme. Një gjë e tillë është bërë duke patur parasysh trajtimin jo uniform dhe financimin e njësive vendore në bazë të përkatësisë politike ndër vite.

1.6. KUFIZIME

Rishikimi i dokumenteve në përgjithësi në lidhje me decentralizimin fiskal apo raporteve për zhvillimin ekonomik vendor lë të kuptohet se ka një boshllëk të madh sa i përket planeve të zhvillimit ekonomik vendor dhe hartimit të politikave. Problemi në fakt është disa përmasor. Së pari, mund të themi se në kulturën tonë të arkivimit, të mbajtjes apo të raportimit e të dhënave ka një boshllëk të madh në konsistencën dhe në uniformitetin e të dhënave të raportuara. Kjo u vu në dukje edhe në procesin e fundmë të amalgamimit të njësive vendore me Ligjin No.215/2014, ku ky procesi u parapri me studime dhe analiza në dy njësi vendore, atë të Urës Vajgurore dhe të Pogradecit nga kompania KPMG/STAR Program³. Kompania e pajtuar nga Programi STAR, në raportin e saj përmbledhës për analizën e këtyre njësive shprehet për të dhënat fiskale dhe financiare, si më poshtë:

- *Paqartësi në udhëzimet e Ministrisë së Financave në lidhje me raportimin dhe buxhetimin si proces.*
- *Pasqyrat financiare nuk janë të mbështetura nga të dhëna të plota gjithëpërfshirëse.*

Po kështu, një pengesë tjetër e madhe është edhe ndryshimi jo i vogël i të dhënave të njëjta sa i takon burimit të tyre kombëtar apo vendor e rajonal. Statistikat rajonale me të cilat jam i detyruar të punoj janë të llogaritura nga INSTAT në vite, jo në format të njëjtë. Një pjesë e tyre, si rezultat i matjes së zhvillimit ekonomik vendor, i referohen të

³ KPMG/STAR 2015 “Detailed guideline on LGU due diligence” f:29, Mars 2015

dhënave me qarqe pastaj pas viteve 2006 në të dhëna sipas rajoneve malore, kodrinore apo fushore/detare. Po kështu ka të dhëna që i referohen të dhënave rajonale të pabarazisë, e cila shprehet me indikatorë relevantë, por jo të ngjashëm në vite të ndryshme dhe kjo ka qenë e varur nga metodologjia e përdorur nga donatorë të ndryshëm si PNUD, BB, FMN, INSTAT etj.

Përveç kësaj, mund të themi se mirë informimi për ndikimin e politikave vendore nuk ka parasysh vetëm të dhënat statistikore, por edhe ekspertizë të gjerë me grupe interesi. Për këtë arsye, plotësimi i pyetësorëve nga përfaqësues të njësive vendore të cilët nuk mund të jenë jashtë subjektivizmit të tyre sa i përket këndvështrimeve politike dhe jo vetëm, është një vlerë e shtuar në metodologji dhe konkluzionet e tyre janë të vlefshme. Gjithsesi, përveç këtyre vështirësive të listuar me sipër, shpresoj që kërkimi shkencor në këtë punim do përpiket të sjellë një panoramë të qartë në lidhje logjike dhe të matshme mes decentralizmit fiskal, faktorëve të tjerë relevant të tij me zhvillimin ekonomik vendor në Shqipëri si një vend në zhvillim. Ajo që më jep shtysë dhe që më bën të mendoj se punimi im do jetë një vlerë modeste e shtuar në lidhje me këtë problem që afekton cilësinë e jetës në Shqipëri është thënia e Albert Einshtein:

“ Bota që ne kemi krijuar sot, si rezultat i mënyrës sonë e të menduarit, nuk mund të zgjidhë problemet duke menduar me të njëjtën mënyrë që i krijuam ato.” (Natraas and Altomare, 1999).¹¹

KAPITULLI: II BAZAT TEORIKE DHE INSTRUMENTËT E ZHVILLIMIT METODOLOGJIK TË TEMËS

Mandati i një qeverisjeje në përgjithësi dhe i asaj vendore në veçanti kanë të përbashkët objektivat e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Një qasje dhe një angazhim i tillë thuhet dhe në preambulën e Kushtetutës, që: “shteti, zotohet për prosperitet ekonomik në një shtet demokratik e social”¹².

Në programet qeverisëse instrumentet për t’ia arritur këtë janë të ndryshëm në bazë të këndvështrimeve dhe politikave të ndjekura nga qeveritë të cilat mbështeten në doktrinat e tyre ekonomike e sociale sipas krahëve politik. Po kështu, qeveritë si ato qendrore dhe vendore kanë në dispozicion, përveç planeve të tyre në përmbushje të mandateve edhe politikat financiare, instrumentet fiskal në shërbim të qëllimeve dhe objektivave qeverisëse. E gjithë kjo, në bazë ka një qasje teorike në të cilën përcaktohen bazat për të identifikuar jo vetëm programet dhe projektet për të arritur objektivat në funksion të rritjes ekonomike dhe përmirësimit të një ambienti social, por edhe instrumentet të mundshëm dhe rrugët për t’i arritur ato.

Një nga instrumentet që përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve nëpërmjet përmirësimit, zhvillimit të klimës së biznesit dhe rritjes së punësimit është dhe decentralizimi i qeverisjes, sidomos ai fiskal. “Konteksti institucional i decentralizimit fiskal nënkupton mbi të gjitha zhvillim ekonomik, natyrën e sistemit ligjor, procesin e vazhdueshëm të reformave ekonomike dhe politike, organizimin e institucioneve monetare dhe financiare, dhe tensionet që dalin nga dallimet etnike, fetare, apo ekonomike” (Wildasin, D. 1997), gjithashtu “Decentralizimi fiskal, pra caktimi i funksioneve shpenzuese dhe burimeve e të ardhurave ka një ndikim të dukshëm për

qeverisjen dhe cilësinë e qeverisjes” (Humplick, Frannie & Antonio Estache, 1995). Këto përcaktime tregojnë qartë rëndësinë që ka decentralizimi fiskal në konsolidimin e autonomisë vendore në përgjithësi dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik vendor në veçanti.

2.1. Koncepte bazë

Të trajtohet konceptet bazë për tema të decentralizimit dhe të zhvillimit ekonomik nuk arrin t’u shmangësh definicioneve krahasuese të këtyre koncepteve. “Që në vitet ‘80 Decentralizimi dhe Globalizimi janë çështje të politikave në shumë vende evropiane edhe në zhvillim”. (The World Bank Premnotes, 2001; BiZa, 1980)¹³

Ky kapitull bën fjalë për koncepte bazë të decentralizimit dhe të zhvillimit ekonomik vendor, duke i qëndruar larg çështjeve të globalizimit. Por, siç do ta shohim në trajtesë më vonë, sfida e decentralizimit nuk është as të kuptuarit teorik të tij, as mungesa e logjikës ekonomike e institucionale, por implementimi praktik i tij.

"Një nga përjasjet më kritike për të përkthyer decentralizimin nga teoria në praktikë është një kuptim i qartë i këtij koncepti. Pra, të jenë në gjendje të parashikojnë më mirë çfarë do të thotë decentralizim, sa mirë ai mund të planifikohet dhe të zbatohet, cilat janë implikimet e tij dhe si mund të tejkalohen sfidat që sjell. Praktikuesit e zhvillimit duhet të jenë të pajisur me mjetet e duhura të cilat mund të ofrojnë një njohuri analitike e decentralizimit nga një këndvështrim konceptual shoqëruar me shembuj të vërtetë dhe të testuarit në terren të konceptit në praktikë. "¹⁴(PNUD, 1989:6).

Për decentralizimin ka shumë definicione që natyrisht puqen me parimet në të cilat mbështetet dhe në objektivat për të cilën është dizajnuar, por më gjithëpërfshirëse janë definicionet e dhëna nga PNUD (1997)⁴ që e trajtojnë apo e definojnë si:

⁴ Pas rishikimit dhe konsultimit të literaturës në përgjithësi është gjetur me vend sjellja në këtë punim i citimeve të PNUD për asrye se kjo organizatë (Organizata e Kombeve të Bashkuara) ka në qendër të aktiviteteve të saj qasjen për projekte dhe programe zhvillimore. Një gjë e tillë i vjen për shtat dhe këtij

"...Decentralizimi, apo qeverisja e decentralizuar, i referohet ristrukturimit ose riorganizimit të autoritetit në mënyrë që të ketë një sistem të bashkë-përgjegjësisë ndërmjet institucioneve të qeverisjes në nivel qendror, rajonal dhe vendor në përputhje me parimin e subsidiaritetit, duke rritur cilësinë e përgjithshme dhe efektivitetin e sistemit të qeverisjes, duke rritur autoritetin dhe kapacitetet e nivelit nën-kombëtar. Decentralizimi gjithashtu mund të pritët të kontribuojë në elementet kyç të qeverisjes së mirë, të tilla si rritjen e mundësive të njerëzve për pjesëmarrje në vendimet ekonomike, sociale dhe politike, duke ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve të njerëzve dhe rritjen e përgjegjshmërisë së qeverisë, transparencën dhe llogaridhënien."¹⁵ (PNUD,1997:4)

Pra, siç shikohet edhe nga definicioni, decentralizimi është një ndërveprim i strukturave vendore qeverisëse me ato të qeverisjes qendrore, është ushtrim efektiv i sistemit të qeverisjes dhe implementim nëpërmjet komunikimit, informimit, transparencës dhe llogaridhënies me komunitetin vendor.

Pa marrë përsipër të ndalemi në tërësi në ndërtimin e strukturave të shtetit, vendi që zënë organet e qeverisjes vendore dhe roli i tyre në tërësi në qeverisje, ndryshon në funksion të sistemit politik, centralist apo demokratik të shtetit. Në sistemin centralist, qeverisja dhe në mënyrë të veçantë pushteti politik, është i përqendruar në një dorë, në pushtetin qendror, ndërsa në sistemin demokratik, në ushtrimin e pushtetit politik krahas pushtetit qendror veprojnë me attribute të caktuara edhe organet e qeverisjes vendore. Në një shtet centralizuar ushtrimi i pushtetit lidhet me mënyrën se si e realizon qeverisjen pushteti qendror, si i vë në lëvizje strukturat e veta nga lart- poshtë, cili është roli ekzekutiv i tyre dhe, më konkretisht, cili është vendi i tyre në marrjen e vendimeve, organizimin dhe kontrollin administrativ për zbatimin e tyre. Në rastin e qeverisjes demokratike shkalla e demokracisë përcaktohet, krahas të tjerave, nga përmasat që ka

punimi pasi sjell korelacionin mes decentralizimit dhe zhvillimit ekonomik vendor. Përveç kësaj, ndryshe nga definicione si nga studies dhe expert të pavarur apo institucione bankare si BB apo FMN, OKB ka një qasje më të balancuar nga ana sociale.

marrë shpërqendrimi i rolit qeverisës, sa janë transferuar funksionet dhe kompetencat nga pushteti qendror në pushtetin vendor, cili është roli i organeve të pushtetit vendor në qeverisje dhe si e ushtron ai këtë rol.

Decentralizimi i pushtetit nga niveli qendror në atë vendor bazohet në tre kolona:

a) Decentralizimin politik,

Nevoja për të i ka rrënjët tek mos motivimi, tek kontrolli i balancimit dhe i sigurimit të shpërndarjes së pushtetit me vendimmarrjen dhe sigurimin e strukturave zhvilluese. Në përcaktimin e mëposhtëm shikohet një definicion gjithëpërfshirës për sa i përket këtij koncepti. Në të shihet qartë se një nga arsyet është çlirimi i forcave, krijimi i sinergjive për zhvillim.

“...Jo vetëm që mbi përqendrimi i biznesit dhe pushtetit politik ka qenë një problem që e pengon zhvillimin ekonomik në mbarë botën, por ka ndihmuar edhe në nxitjen e korrupsionit dhe diktaturës. Një shekull më parë, një komentues politik britanik, Lordi Acton, vuri në dukje se pushteti absolut të korrupton absolutisht. Ky parim është demonstruar shumë shpesh. Në të vërtetë, shumë raste, e vetmja arsye racionale për të fuqizuar sistemet e qeverisjes vendore është nevoja për të shpërndarë monopolizimin e fuqisë që mbahej nga qeveritë kombëtare...Ai është tepër i rëndësishëm për të siguruar ekzistencën e një sistemi të kontrolleve dhe balancave të shumta në ushtrimin e pushtetit politik. Në këtë drejtim, forma më e rëndësishme e kontrolleve dhe balancave në çdo shoqëri është shpërndarja, ose fragmentimi i pushtetit politik. Pa dyshim, krijimi i qeverive të forta rajonale dhe vendore është kusht i rëndësishëm për këtë zhvillim.”¹⁶(PNUD, 1996:11)

b) Decentralizimin administrativ

Decentralizmi administrativ është transferim autoriteti institucional në ngritjen dhe funksionimin e institucioneve për kryerjen e funksioneve vendore dhe ofrimin e shërbimeve.

"...transferimi i përgjegjësisë për planifikimin, menaxhimin, si dhe ngritjen dhe shpërndarjen e burimeve nga qeveria qendrore dhe agjencive të saj në terren, njësisë të agjencive qeveritare, njësisë vartëse ose niveleve qeverisëse, autoriteteve publike gjysmë-autonome apo korporatave, autoriteteve funksionale apo në një zonë të gjerë rajonale, ose organizatave private ose vullnetare joqeveritare."¹⁷ (Rondinelli, D & Nellis, J, 1986:5)

A janë trajektoret e decentralizimit administrativ të njëjta në vende të ndryshme? Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim jep një përgjigje gjithëpërfshirëse nëpërmjet këtij definicioni.

"...Qeveritë në vendet në zhvillim janë përpjekur të zbatojnë një shumëllojshmëri të politikave të decentralizimit administrativ. Këto kanë ndryshuar apo kanë qenë të larmishëm nga ato që janë më gjithëpërfshirëse në fushëveprimet dhe projektimin e ideve për të transferuar planifikimin e zhvillimit dhe përgjegjësitë e menaxhimit tek njësitë vendore të qeverisjes. Të tjerë kanë qenë më të ngushtë në të konceptuarin, dekoncentrimin ose ndarjen e detyrave administrative midis njësisë të qeverisjes qendrore. Por në një shkallë të paparë, qeveritë qendrore kanë ndarë pjesët më të konsiderueshme të buxhetit kombëtar autoriteteve vendore, me shumë autoritet administrativ, me shumë përgjegjësi ekonomike dhe me shumë autonomi politike."¹⁸ (PNUD, 1997:p5)

c) Decentralizimin fiskal.

Pavarësisht qartësimit dhe përcaktimit të koncepteve të mësipërme që përvijojnë decentralizimin politik dhe atë administrativ, është shumë domethënëse vëmendja që i është kushtuar përshkrimit të konceptit të decentralizimit fiskal dhe financiar.

Decentralizimi fiskal lidhet para së gjithash me krijimin e mundësive, për financimin e funksioneve të mbështetura apo të ashtuquajtura “subsidy” apo të subvencionuara.

“...Vendosja e menaxhimit financiar efektiv dhe transparent është në thelbin e çdo përpjekjeje për të reformuar sektorin publik.. Qenia përkrahës i vërtetë i procesit të decentralizimit, duhet të bësh që karakteristikat themelore të një sistemi për menaxhimin e decentralizuar financiar të përfshijnë: **(a)** transparencën e dhënies së fondeve **(b)** shumave e fondeve në dispozicion të institucioneve vendore të jenë të parashikueshme dhe **(c)** autonomi vendore të vendimmarrjes në shfrytëzimin e burimeve. Në kontrast me praktikën e përhapur të granteve “ad hoc” drejtuar nga politika, shpërndarja e burimeve, duhet të bazohet në formula transparente. Gjithashtu, ndryshe nga pa para shikueshmëria tipike e shumicës së mekanizmave qendrore për tek ato vendore, që janë transfertë mbizotëruese në vendet në zhvillim, procesi duhet t’i japë institucioneve vendore me një tregues të qartë, se sa para do të jenë në dispozicion në ciklin e ardhshëm të planifikimit shumëvjeçar. Kjo e bën planifikimin strategjik vendor të jetë i mundur dhe siguron një tavan financiar që e bën të tillë duke planifikuar një ushtrim kuptimplotë dhe një mundësi për komunitetet vendore për të marrë vendime autonome në përdorimin e burimeve të kufizuara.”¹⁹ (DDSMS, PNUD, 1996:p.48)

Pra, decentralizimi fiskal, na kërkon jo vetëm transferim burimesh financiare dhe autoritet fiskal tek njësitë vendore, por ato duhet të jenë të parashikueshme në mënyrë që ta bëjnë të mundur planifikimin të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat, transparent dhe shpenzimet në mënyrë autonome. Siç do e shohim në vazhdim, në vendet e Evropës Juglindore dhe në vendin tonë këto parime janë të përealizuara sipas këtij koncepti të PNUD-së.

“... decentralizimi demokratik, përfshirë transferimin e pushtetit administrativ, fiskal dhe politik, është i nevojshëm që vetë decentralizimi të jetë i suksesshëm dhe të jetë një realitet i qëndrueshëm. Decentralizimi demokratik është konsoliduar në mënyrë të konsiderueshme kur krijohen mekanizma në nivel vendor për të lehtësuar procesin e planifikimit në nivel

vendor, që lidh stafin e qeverisë me shoqërinë civile. Partneriteti i tillë shpesh kërkon një ndryshim në mendësinë e anëtarëve të saj, si dhe burimet e përshtatshme për forcimin e kapaciteteve dhe aftësitë e nevojshme për lehtësimin efektiv të proceseve të tilla.”²⁰
(PNUD, 1998:p3)⁵

Decentralizimi i pushtetit nuk është qëllim në vetvete. Para së gjithash ai është demokratizim, pasi qeverisja është më afër qytetarëve, është transparencë, llogaridhënie, komunikim, efikasitet dhe efikasitet. Janë këto elemente të qeverisjes së mirë që decentralizimin e kthejnë në një instrument për të rritur besimin e qytetarëve të qeverisja, si dhe për të rritur sinergjitë në proceset e ndërtimit të së ardhmes së komunitetit. Elementet përbërës të decentralizimit të prezantuar më sipër nuk janë definicionet e vetme, por të gjithë konvergjojnë në disa pika të përbashkëta të cilat ndahen dhe përvijojnë implementimin e parimit të subsidiaritetit, si dhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitet apo rendimentit të shërbimeve publike dhe jo vetëm. Por, decentralizimi sipas tabelës së mëposhtme prezanton disa nivele autonomie. Pozicioni i vendit tonë duke analizuar Ligjin Organik dhe elementet e financimit të qeverisjes vendore si dhe të % që luajnë transfertat qeveritare në shpenzimet e qeverisjes vendore ndodhet në mes të autonomisë dhe gjysmë autonomisë.

⁵ Një nga dimensionet më domethënëse të decentralizimit është ai i zbatimit dhe zhvillimit të demokracisë vendore nëpërmjet përfshirjes së qytetarëve në politikbërje dhe vendimarrje. Kjo është demokracia në veprim.

Tabele II.1: Nivelet e decentralizimit

Lloji i njësisë ku është transferuar autoriteti	Aspekt i qeverisjes transferuar apo të përbashkët			Emri në përgjithësi
	Politik (politika apo vendim-marrja)	Ekonomik ose financiar (Menaxhimi i burimeve)	Administrativ (ose ofrimit të shërbimi)	
Autonom Njësi në nivel bazë	Transferim	Transferim	Transferim	Transferim
Gjysmë autonom Njësi në nivel bazë	Delegim	Delegim	Delegim	Delegim
Vartësi njësie bazë dhe nën njësi	Drejtim	Caktim	Detyrim	Shpërqendrim
Njësi e jashtme (joqeveritare) tek secili nivel	Liberalizim/ Derregullim	Privatizim	Kontraktim	Shpronësim

Burimi: PNUD

Decentralizimi nuk është një stad, ai është një trajektore për të arritur një qëllim të caktuar, atë të rritjes dhe të konsolidimit të autonomisë vendore.

Qeveritë qendrore nuk kanë qenë të interesuara të heqin dorë nga funksionet e tyre dhe t'i decentralizojnë ato për t'i dhënë më shumë kompetencë dhe resurse qeverisjes vendore dhe ky është edhe një nga paradokset që i ndodh procesit në çuarjen përpara të reformave decentralizuese dhe se ato janë të nxitura nga sipër më shumë se sa duhej të ishin të nxitura nga poshtë. (Boussuyt, J. & Gould, J. 2000).²¹ Në fakt, kjo reflekton më së miri orientimin nga politika dhe kufizimet burokratike të ushqyera nga qendra. Por kjo është më se e kuptueshme në vendet postkomuniste, si rezultat i një trashëgimie të

fortë centriste. Programet politike të reformave kanë qenë programe të mirë koordinuara nga institucionet dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët e kanë orientuar politik bërjen dhe vendimmarrjen drejt ndërtimit të institucioneve sipas standardeve evropiane.

Duke përdorur definicionin e autonomisë si një kombinim të fuqisë për nisma dhe një imuniteti për kontrole nga lart (Clark, 1984: p195-208)²², ne mund të shikojmë më thellë, brenda kushteve për zhvillim vendor dhe vlerësimit të shkallës, se cilat reforma decentralizuese janë drejtuar nga ose përcuar tek zhvillimi vendor.

Shumë autorë përpiqen të gjejnë dhe të evidentojnë një mungesë lidhje mes decentralizimit si një parim i ndërtimit të qeverisjes vendore, i delegimit të kompetencave dhe fuqive në planifikimin dhe në ekzekutimin e zhvillimit ekonomik vendor si një objektivë e qeverisjes.

“...Decentralizimi apo qeverisja e decentralizuar nuk duhet të shihet si një qëllim në vetvete, ajo mund të jetë një mjet për krijimin e qeverisjes vendore më të hapur, të përgjegjshme dhe efektive, si dhe për rritjen e sistemeve përfaqësuese në nivel komuniteti për vendimmarrje. Decentralizimi lejon komunitetet vendore dhe subjektet rajonale për të menaxhuar punët e tyre dhe me anë të lehtësimit kontakteve më të ngushta ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore, sisteme efektive të qeverisjes vendore të mundësuar të përgjigjen në nevojat dhe prioritetet e njerëzve për t'u dëgjuar, duke siguruar se ndërhyrja e qeverisë të përmbushë një shumëllojshmëri të nevojave sociale.”²³(PNUD, 1998:p6)

Çfarë nuk është decentralizimi?

Decentralizimi i pushtetit nuk është “...një alternativë për centralizim”. Të dyja janë të nevojshme. Rolet plotësuese të aktorëve kombëtarë dhe vendorë duhet të përcaktohen duke analizuar mënyrat më efektive dhe mjetet e arritjes së një objektivit të dëshiruar.

Për shembull, një sistem kombëtar i rrugëve duhet të jetë të dizajnuara me të dy të dhënat relevante, ato vendore dhe në koordinim kombëtar. Politika e jashtme duhet të jetë një funksion kombëtar bazuar në pikëpamjet e qytetarëve. Menaxhimi i mbeturinave të ngurta duhet, së pari të trajtohet me mekanizmat e brendshme vendore, dhe kështu me radhë. Në hartimin e një strategjie të decentralizimit është e domosdoshme që një analizë e tillë të bëhet. (PNUD,1999)

Është e natyrshme që në lidhje me këtë temë përveç parimeve të përgjithshme dhe bazat teorike ku mbështetet decentralizimi fiskal me interes është edhe të cekën qasje të tilla edhe në Evropën Juglindore, pasi si trashëgimia dhe si trajektorja e ndërtimit të së ardhmes së komuniteteve tona është pothuaj e njëjtë.

Pas rënies së komunizmit në këto vende në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90 ka një trajektore të lëvizjes së këtyre vendeve, nga ekonomi e planifikuar nga qendra në ekonomi të orientuar nga kërkesat e tregut dhe më e decentralizuar. Këto vende janë përballur me shumë sfida në përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të siguruar një zbatim të suksesshëm të reformave të decentralizimit fiskal (Prud'homme, R. 1995:p201-220)²⁴.

Pas rënies së këtyre regjimeve, vende të ndryshme, sidomos ato të ish bllokut komunist, kanë patur programe dhe kanë adaptuar strategji për të zbatuar programe decentralizuese në mënyre për t'i dhënë kompetenca më të gjera qeverisjes vendore duke respektuar parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, atë të ndërtimit të qeverisjes në bazë të parimit të decentralizimit dhe të ushtrimit të qeverisjes në bazë të parimit të autonomisë vendore²⁵.

Por reformat në këto vende u fokusuan së tepërmi në decentralizimin politik, duke vënë jo tërësisht në vëmendje mbase edhe duke lënë mënjanë decentralizimin administrativ e sidomos atë fiskal. Nga të dhënat, kjo është më e theksuar në vendin tonë, gjë të cilën do e shtjellojmë më poshtë.

Gjatë dy dekadave të fundit, decentralizimi demokratik ka qenë një element kryesor i rendit të ditës të "qeverisjes së mirë" dhe ka pasur një qëllim të përbashkët në listën e gjatë të reformave të lidhura me parime të ngjashme që i japin formë një programi të tillë të bashkësisë ndërkombëtare. (EC Commission, 2001; PNUD, 1997; PNUD 2002; World Bank and IMF 2006; see also Hyden et al., 2004; Graham et al., 2003;).

Mund të themi që pas rënies së komunizmit ambienti akademik dhe politik ka diskutuar rreth decentralizimit fiskal në mënyrë dinamike duke parë dhe duke analizuar mundësitë për sukses. Janë të rrallë ato vende që në programet e tyre nuk e kanë patur qeverisjen vendore si një ide për ta fuqizuar në mënyrë që te jete një instrument domethënës zhvillimi. Përpjekjet e bëra në fakt nuk tregojnë në këtë fushë ndonjë rekord për përshpejtime të bëra. Kjo gjendje amullie apo mungesë vullneti mund të ketë ardhur nga kushtet ekonomike të papërshtatshme. Vendet e ndryshme nuk kanë qenë të përgatitura për të aprovuar skema të plota të decentralizimit, sepse kushtet ekonomiko-politike apo edhe psikologjia që mbartnin në periudhat post centralizëm ishin të pa konsoliduara apo të reja.

Pavarësisht kësaj, mund të themi se tani pas kaq vitesh hapa përpara janë bërë, dhe vende të ndryshme kanë patur arritje dhe një pjesë tjetër janë të gatshëm të ndërmarrin sfida.

Aktualisht ka shumë analiza që decentralizimin fiskal e prezantojnë si një strategji të politikës. Më shumë përqendrohen në vlerësimin e përvojës së decentralizimit në mbarë

botën, dhe duke kërkuar për një qasje mes teorisë dhe praktikës. Por shumë më pak vëmendje i është kushtuar strategjive apo programeve zbatuese. (Bahl, R. 1999)²⁶

Në dekadat e fundit i është kushtuar një vëmendje të madhe specialistëve të zhvillimit të agjencive zhvillimore multilaterale si dhe qeverisjes me fokus decentralizimin fiskal si një instrument primar për të promovuar rritjen ekonomike (UN, 1991; Oates, 1994; Bruno and Pleskoviç, 1996).

Zhvillimi ekonomik vendor është një objektivi që arrihet nëpërmjet një strategjie, që është një plan pune për përmirësimin dhe rritjen e klimës së hapjes së vendeve të reja të punës nëpërmjet zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës në përgjithësi. Përcaktimi apo përkufizimi më i përshtatshëm dhe më i pranuar sot në botë për “shkallën e zhvillimit” i referohet propozimit të ekonomistit francez Francois Perroux të vitit 1966. Ai është autori kryesor i teorisë së poleve të rritjes, e krijuar në vitin 1950. Ishte Francois Perroux (1903-1987) çelësi dhe themeli më i rëndësishëm teorik i gjithë konceptit. Ishte argumenti i tij i cili shpjegon mënyrën dhe formën e rritjes ekonomike në mënyrën e mëposhtme:

"Është një fakt i hapur dhe i padiskutueshëm se rritja nuk është uniforme në vende të ndryshme, por rritja ka shkallë të ndryshme intensiteti në pika të ndryshme, apo në pole, dhe pastaj ajo përhapet nëpërmjet kanaleve dhe rezultati i tij përfundimtar për ekonominë shtetërore është i ndryshëm në rajone të ndryshme".(Vystouple, 2003).

2.1.1. Decentralizimi fiskal si instrument i zhvillimit ekonomik vendor

Analistë të ndryshëm e agjenci të zhvillimit gjatë këtyre dekadave që pasuan rënien e sistemeve të centralizuara dhe burokratike kanë patur një interes të rritur për ta

prezantuar decentralizimin fiskal si një instrument primar në promovimin e rritjes ekonomike. (United Nations, 1991; Oates, 1994; Bruno and Pleskovic, 1996).^{27 28 29}

Çështjet e decentralizimit janë diskutuar që me fillimin e reformave post komuniste. Zgjedhjet e para për qeverisjen vendore në Shqipëri bëhen në vitin 1992 (korrik) dhe qeverisja vendore funksionon deri në vitin korrik 2000/sipas ligjit No.7275/1992 “Për Pushtetin Vendor”. Pas ratifikimit të “Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore” nga Parlamenti në vitin 1999, miratimit të Kushtetutës dhe Ligjit Organik “Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore në Shqipëri” procesi ishte i orientuar në mënyrë strategjike dhe jo spontan. Dukshëm, siç e thashë në kapitullin e mësipërm, në vendet e tjera post komuniste dhe në Shqipëri reformat ishin të orientuara më shumë politikisht se sa ekonomikisht (arsyetimet do bëhen në kapitujt në vazhdim).

Siç dhe parashtruam me sipër, argumentet bazë në favor të decentralizmit fiskal kanë të bëjnë me dy supozime, (1) decentralizimi mund të ngrejë efikasitetin ekonomik sepse qeverisjet vendore janë të afta të ofrojnë shërbime më të mira e për pasojë kanë avantazhet e afërsisë dhe të informimit, dhe (2) konkurrenca dhe lëvizshmëria e popullsisë nëpër qeveritë vendore për ofrimin e shërbimeve publike do të sigurojë përputhjen e duhur të preferencave mes komuniteteve vendore dhe qeverive vendore. (Tiebout,1956, p:416-424).³⁰

Traktati i Maastricht-it përshkruan një parim udhëzues “Parimin e Subsidiaritetit” për përcaktimin e përgjegjësiave ndërmjet anëtarëve të BE-së. Ky është edhe si parim bazë për qeverisjen vendore në themel të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore , Kushtetutës dhe Ligjit “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Sipas këtij parimi taksimi, shpenzimet dhe funksionet rregullatorë duhet të ushtrohen

nga niveli më i ulët i qeverisjes, derisa një rast i arsyeshëm mund të caktojë një të tillë në nivelet më të larta të qeverisjes.³¹

Karta Evropiane e Autonomisë Vendore i parasheh këto kondita në preambulën e saj dhe në Nenin 6, Paragrafi 1 që thotë: “Pa paragjykuar dispozitat më të përgjithshme statutore, autoritetet vendore duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë strukturat e tyre të brendshme administrative në mënyrë që ato të përshtaten për nevojat vendore dhe të sigurojnë një menaxhim efektiv”. Kjo Kartë i konsideron autoritetet vendore si themelet të çdo rendi demokratik, ku e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në çështje publike është një nga parimet demokratike e të gjitha vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, e drejtë kjo që mund të ushtrohet në mënyrën më të drejtpërdrejtë në nivel vendor. Nëpërmjet Kartës Evropiane e Autonomisë Vendore është shprehur bindja se ekzistenca e autoriteteve vendore me përgjegjësi reale mund të sigurojë një administratë, e cila është jo vetëm efektive, por edhe pranë qytetarit. Në të thuhet se, përgjegjësitë publike duhet të ushtrohen mundësisht nga autoritetet, që janë më pranë qytetarëve, ndërsa ofrimi i tyre në një nivel më të lartë administrativ duhet të merret në konsideratë vetëm kur koordinimi ose realizimi i përgjegjësisë është i pamundur ose më pak efikas në nivelin më të ulët.

Kjo Kartë shërben për rritjen e vetëdijes, që ruajtja dhe zbatimi i vetëqeverisjes vendore në vende të ndryshme të Evropës është një kontribut i rëndësishëm për ndërtimin e një Evrope të përbashkët. Kjo kartë ka qenë burim ligjor me vlerë për autoritetet vendore në Shqipëri, pasi ofron klauzola që do të mbështesnin çdo nismë ligjore nga ana e autoriteteve vendore shqiptare për të mbrojtur autonominë, të drejtat ligjore dhe ushtrimin e pushtetit të tyre.

Karta parashtrohet parimet lidhur me:

1. Mbrojtjen e kufijve të autoritetit vendor;
2. Ekzistencën e strukturave dhe burimeve administrative të përshtatshme për detyrat e autoriteteve vendore;
3. Kushtet në të cilat ushtrohen përgjegjësitë në nivel vendor;
4. Mbikëqyrjen administrative të veprimtarisë së autoriteteve vendore;
5. Burimet financiare të autoriteteve vendore;
6. Mbrojtjen ligjore të vetëqeverisjes vendore.³²

Karta nuk ofron një sistem të institucionalizuar për kontrollin e zbatimit të saj, përveç kërkesës ndaj çdo vendi për të paraqitur të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me masa ligjvënëse ose të tjera, të cilat ndërmerren për të arritur përputhshmëri me të. Aktualisht në mënyrë formale parimet e kartës janë të përfshira në legjislacionin që afekton qeverisjen vendore. Me të njëjtën logjikë strukturore u përshkrua edhe ndarja administrativo-territoriale me Ligjin Nr.8653/2000, që së bashku me Ligjin Organik për qeverisjen vendore 8652/2000 konfiguruan territorin mbi bazën e trashëgimisë kulturore, vlerave historike, vazhdueshmërisë gjeografike, si dhe deleguan kompetenca institucionale, financiare dhe fiskale për njësitë e reja në përmbushje të detyrimeve të mësipërme për komunitetin.

Por a kanë efekt këto politika decentralizuese dhe sidomos decentralizuese fiskale sa i përket vendeve që ekonomitë e tyre i përkasin grupit të ekonomive në zhvillim apo në ndryshim? Mund të themi se në përgjithësi politikat e parimet e Bashkimit Evropian sa i përket subsidiaritetit, pra vendimmarrjes sa më afër përfituesit të shërbimit, harmonizimit

fiskal dhe kontrolleve stabilizuese, janë duke demonstruar gjithashtu efekte në politikat e ekonomive në zhvillim dhe në ato në ndryshim. (Shah, A. 2004).³³

Si një ekonomi në zhvillim edhe vendi ynë ka përqafuar për rreth dy dekadat e fundit reformat decentralizuese të cilat kanë pasur ulje-ngritjet e veta në vite, por gjithsesi krahasuar me pikën e nisjes është bërë progres. Që nga viti 2000 dhe në vazhdim, në mënyrë strategjike vendi ka marrë vendimin politik për t'i decentralizuar vendimet fiskale dhe administrative në nivel vendor duke i dhënë njësive vendore bashki/komuna dhe më pak qarqeve kompetenca në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve. Indikatorët bazë që matin edhe decentralizimin fiskal ashtu si dhe në vendet e Evropës lindore dhe asaj Juglindore pra edhe në vendin tonë, kanë qenë pjesë e monitorimit të vazhdueshëm nga institucione dhe partnerë ndërkombëtar. Treguesit e performancës së decentralizimit fiskal si: shpenzimet vendore si % e PBB, të ardhurat vendore si % e PPB, shpenzimet dhe të ardhurat vendore si % e të ardhurave kombëtare janë monitoruar dhe raportuar nga institucione dhe partnerë ndërkombëtar si WB, USAID, PNUD, KE, etj. Për këto indikatorë flitet dhe në studimet ndërkombëtare të cilët përpiqen të matin autonominë apo decentralizimin fiskal.³⁴

2.1.2. Zhvillimi ekonomik vendor

Po të shikosh dhe të studiosh literaturën për zhvillimin ekonomik vendor nuk gjen një qasje apo përkufizim teorik konsekuent të mirë apo të gjithë pranuar se çfarë është ky zhvillim. Zhvillimi ekonomik vendor në përgjithësi përfaqëson një qasje strategjike, gjithëpërfshirëse, ku grupet e interesit dhe institucionet vendore përpiqen në mënyrë të planifikuar dhe strategjike të përdorin apo mirë përdorin burimet e veta me qëllim që të

rrisin apo të promovojnë biznesin dhe të rrisin vendet e punës (Swinburn, G. Goga, S. Murphy, F. 2001).

Këto sjellje apo përpjekjet për të koordinuar veprimet kanë si qëllim që të përmirësojnë ambientin e të bërit biznes, të përmirësojnë dhe të ofrojnë informacione dhe mbështetje nëpërmjet enteve në varësi vendore dhe jo vetëm, brenda një politike vendore apo një strategjie të tillë. Ato gjithashtu përpiqen të ndikojnë në sjelljen dhe vendimet e brendshme të firmave, pasi në një biznes të ekonomisë së tregut është forca lëvizëse për të gjithë procesin e rritjes ekonomike.³⁵(Capkova, S. 2009)

Gwen Swinburn, me të cilën kam pasur fatin të punoj për një kohe të caktuar në kuadër të një projekti të Bankës Botërore në pesë qytete të vendit, ka një definicion pak a shumë siç u tha më sipër:

“Zhvillimi ekonomik vendor është një qasje e planifikuar në mënyrë strategjike e nxitur nga partneritete vendore për të bërë të mundur rritjen e punësimit, uljen e varfërisë dhe rritjen e cilësisë së jetës nëpërmjet përmirësimit të qeverisjes ekonomike vendore” (Swinburn, 2006).

Pas viteve '70, në vendet perëndimore në Evropë qeverisja vendore mori një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik vendor. Njësitë vendore filluan të luanin një rol substancial me programet e zhvillimit vendor, në krijimin e planeve të përmirësimeve kapitale, për pasojë duke luajtur një rol bazë në zhvillimin e biznesit, kryesisht atij të vogël e të mesëm. Kjo bëri të mundur që NJQV-të të ndikonin dukshëm në hapjen e vendeve të reja të punës.

Siç edhe është prezantuar më sipër, konteksti institucional i decentralizimit fiskal nënkupton mbi të gjitha zhvillim ekonomik, por dhe këtu ka këndvështrime të ndryshme. Ndërsa disa autor kanë një qasje optimiste dhe prezantojnë e mbështesin një raport pozitiv lidhjeje mes decentralizimit fiskal dhe zhvillimit ekonomik vendor

(Oates, 1993; Yilmaz 1999; Iimi, 2005), autor të tjerë si (Xie, Zou. 1999) kanë gjetur evidenca të ndryshme.³⁶(Bodman, P; Heaton K.A and Hodge, A. 2009)

Si hap i parë, për të pasur këtë qasje dhe këtë rol, u bë e mundur që nëpërmjet legjislacionit duke i dhënë jo vetëm kompetenca vendimmarrëse dhe administrative, por nëpërmjet decentralizimit fiskal, kryesisht nëpërmjet mundësisë për të aplikuar në tregjet financiare për të financuar planet e tyre të zhvillimit ekonomik vendor.

Zhvillimit ekonomik vendor ka evoluar si një qasje e politikave në fillim të viteve '70 në përgjigje të qeverive vendore për kuptuar se bizneset dhe kapitali po lëviznin midis vendeve për një avantazh konkurrues. Duke shqyrtuar në mënyrë aktive bazën e tyre ekonomike, komunitetet fituan një kuptim të mundësive dhe pengesave për rritjen e investimeve. Me këtë botëkuptim të ri, komunitetet vendore u përpoqën për të zgjeruar bazën e tyre ekonomike dhe të punësimit me hartimin dhe financimin e programeve strategjike për të hequr pengesat dhe për të lehtësuar investimet. Në këtë nivel autonomie dhe rrethanash financiare, njësitë vendore mund të luajnë rol modest në zhvillimin ekonomik vendor pasi kushtet financiare i kanë të limituara.

Autonomia është zgjerim i lirisë së veprimit të njësive vendore në terma të funksioneve vendore, i veprimeve në vetvete, ai është produkt i dy faktorëve: 1) fuqia për të marrë nisma, dhe 2) imunitet nga autoriteti i niveleve më të larta (Clark, 1984). Ne mund të shikojmë thellë brenda kushteve për zhvillim ekonomik dhe të vlerësojmë masën se cilat nga reformat decentralizuese janë udhëhequr apo drejtuar pikërisht tek zhvillimi vendor.³⁷

Neni 9 i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore përcakton tre lloje funksionesh për NJQV-të: funksionet e veta, të përbashkëta dhe të deleguara.

Në funksionet e veta ligji përcakton kategoritë kryesore të funksioneve të veta, të cilat përfshijnë **(i)** infrastrukturën dhe shërbimet publike **(ii)** zhvillimin ekonomik vendor **(iii)** funksionet sociale, kulturore dhe argëtuese si dhe sigurinë civile.

Zbatimi i funksioneve të veta është përmirësuar, ballafaquar edhe me disa mangësi të tilla si mungesa e kapaciteteve të administratës vendore për të hartuar e zbatuar strategji dhe programe të mira të zhvillimit ekonomik vendor, vështirësi në menaxhimin e disa shërbimeve të tilla si ujësjellës-kanalizime dhe menaxhimin e mbetjeve për shkak të mungesës së një qasjeje të qartë në lidhje me rajonalizimin apo decentralizimin e disa shërbimeve dhe gjendjes kritike të stokut të trashëguar të investimeve të munguara, e shoqëruar nga mungesa e burimeve financiare për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës vendore.

2.1.2.1. Zhvillimi Ekonomik Vendor/Rajonal

Sipas eksperteve dhe autorëve që trajtojnë tema të zhvillimit ekonomik vendor bizneset e mëdha e të vogla, shpesh zgjedhin për të gjetur shërbime në zonat urbane për shkak të ekonomive aglomerate (p.sh., përfitimet që rrjedhin nga ndarja e tregjeve, infrastruktura, ndarja e punës dhe informacionit me firma të tjera).

Avantazhi ekonomik i zonave urbane varet në mënyrë të konsiderueshme nga cilësia e qeverisjes urbane dhe menaxhimit, nga politikat që ndikojnë në gatishmërinë, për pasje ose mungesa e energjisë, transporti, telekomunikacioni, kanalizime dhe toka urbane me potenciale zhvillimi.

Faktorët që ndikojnë në produktivitetin e punës në ekonominë vendore përfshijnë ekzistencën dhe cilësinë e shërbimeve të strehimit, shëndetësisë dhe arsimit, të aftësive, të sigurisë, mundësitë e trajnimit dhe transportit publik.

Këto infrastruktura të zhvillimit ekonomik vendor përbëhet nga dy komponentë kryesorë: 1) Infrastruktura e inkorporuar e rrugëve, hekurudhave, të ujit, kanalizimit dhe sistemet e kullimit, si dhe të energjisë dhe rrjeteve të telekomunikacionit 'hard' fizike. 2) Infrastrukturë "soft" e objekte shoqërore dhe kulturore të komunitetit dhe kapacitetet që rrisin cilësinë e jetës dhe të inkurajojnë industrinë dhe zhvillimin e biznesit. Cilësia dhe sigurimi i infrastrukturës 'hard' dhe 'soft' formon themelin e një ekonomie të suksesshme vendore (Swinburn, G; 2006).

Pra, bizneset janë të lidhura me gjendjen e infrastrukturës, ambientit, të aktiviteteve rekreative, të shërbimeve shëndetësore e të tjera të ngjashme. Sa u tha më sipër për bizneset, kryesisht ato të vogla e të mesme të cilat kanë një lidhje të fortë me komunitetin, është përgjegjëse sipas Ligjit Organik qeverisja vendore. Në të gjithë përcaktimet e qeverisjes vendore sa i përket nevojave të biznesit për rritje dhe zhvillim në përcaktimin e Swinburn, pothuajse të gjitha janë funksione të qeverisjes vendore, si dhe një pjesë e tyre aktualisht janë nën autoritetin e qeverisjes qendrore, por janë të dekoncentruara në nivel vendor. Por sërish zhvillimi i qëndrueshëm i tyre projektohet në nivel vendor dhe rajonal.

Për sa më sipër, edhe përmirësimi i ambientit për biznes nëpërmjet rritjes të cilësisë së punës së qeverisjes vendore e cila e ushtron pushtetin e vetë qeverisës mbështetur në instrumente politikë, administrative dhe fiskale të decentralizuar ndikon në zhvillimin ekonomik dhe vendor, gjë që do përpiqemi ta vërtetojmë më poshtë.

2.2. Zhvillimi Ekonomik Vendor dhe Planifikimi Strategjik

Jeta në komunitet është pasqyrim i një stadi të caktuar zhvillimi i cili përcaktohet nga kompleksi i faktorëve ekonomiko-social përkatës. Në këtë mënyrë, çdo komunitet ka

një gjendje të caktuar zhvillimi, i cili është pjesë e zhvillimit ekonomiko-social të vendit në tërësi. Natyrshëm, zhvillimi i një komuniteti ecën në kushtet dhe në harmoni me zhvillimin e mbarë vendit.

Megjithatë, qeverisja vendore dhe jeta në çdo komunitet merr vlera të diferencuara, pozitive apo negative, në varësi me mënyrën se si përdoren potencialet zhvilluese brenda komunitetit. Në mënyrë të veçantë krijimi i kushteve për vetëqeverisje dhe autonomi vendore, bëhet faktor mjaft i rëndësishëm në këtë drejtim, si për të shfrytëzuar resurset e ndryshme natyrore e njerëzore brenda komunitetit, ashtu edhe për të ofruar bashkëpunim me faktorin e jashtëm. Po ashtu zhvillimi më i avancuar në një komunitet vendor, bëhet pjesë e rëndësishme për të stimuluar zhvillimin në shkallë vendi. Kjo përbën thelbin e avantazheve që sjell rritja e autonomisë vendore dhe qeverisja vendore efektive. Këtij qëllimi i shërben decentralizimi si reformë dhe proces në përgjithësi, e ai fiskal në veçanti, duke krijuar mundësi për një përdorim më racional të resurseve dhe për të rritur efektivitetin e punës në komunitet në dobi të zhvillimit.

Për zhvillimin ekonomik vendor nuk ka një definicion të vetëm, ashtu siç nuk kishte edhe një definicion për decentralizimin. Sipas (Çapkova, S. 2005) ai mund të përmblihet në këtë fjali:

”Përgjithësisht, zhvillimi ekonomik vendor prezanton një strategji të gjerë në të cilën aktorët dhe institucionet vendore përpiqen të përdorin në mënyrën më të mirë, resurset vendore, për ruajtjen dhe krijimin e vendeve të punës si dhe forcimin dhe promovimin e aktiviteteve të bizneseve”³⁸.

Vendi i ynë, për arsye të shumta që nuk janë objekt i kësaj teme, klasifikohet si një vend me ekonomi në ndryshim³⁹. Në mënyrë të veçantë, në nivele të ulëta është gjendja ekonomiko-sociale në disa zona më pak të zhvilluara të vendit dhe në mënyrë më të

dukshme kjo evidentohet në zonat rurale apo edhe në disa degë të ekonomisë që kanë mjaft ndikim në nivelin e ulët ekonomiko-social në shkallë vendi⁴⁰. Kjo e bën shumë të domosdoshme nevojën që në një mënyrë sa më të organizuar, të vëmë në lëvizje të gjitha organizmat dhe strukturat e mundshme, me qëllim që të përshpejtohet procesi i zhvillimit ekonomik.

Angazhimi i të gjithë instrumenteve të shtetit për zhvillimin dhe integrimin, vlerësimi objektiv i drejtimeve themelore dhe përparësitë në të cilat do të zhvillohet vendi, si dhe mbështetja me objektiva të tjera që nevojiten për këtë zhvillim, janë traseja bazë e cila përcaktohet dhe ndiqet për zbatim në shkallë të gjerë nga pushteti qendror. Për këtë kërkohet një rol aktiv i të gjithë aktorëve pa përjashtuar edhe komunitetet e veçanta dhe organet e qeverisjes vendore që veprojnë ligjërisht në emër të tyre.

Në funksion të mënyrës së organizimit të këtij procesi, të nivelit të mobilizimit e të gjithë potencialeve intelektuale, por edhe financiare e social-ekonomike brenda komunitetit, nga puna që bëhet nga organet e qeverisjes vendore, të cilat kanë autoritetin e nevojshëm ligjor për të marrë përsipër detyra konkrete, varet shumë nëse ky zhvillim do të ecë me ritmet e duhura.

Ka shumë rëndësi të kuptohet dhe vlerësohet në mënyrë të gjerë zhvillimi ekonomik vendor i cili në vetvete përfshinë të gjithë përpjekjet dhe veprimet që bën komuniteti si dhe komponentët e veçantë të tij për të përmirësuar kushtet ekonomike-shoqërore dhe cilësinë e jetesës së banorëve përkatës. Sipas Akai dhe Sakata (2002) por edhe Stansel (2005)⁴¹, të cilët në studimin e tyre janë bazuar në veçimin dhe ndarjen e të dhënave në shtetet dhe në zonat metropolitane të SHBA-ve, nxjerrin konkluzion që decentralizimi fiskal kontribuon pozitivisht në rritjen ekonomike.⁴²

Për zhvillimin ekonomik janë bërë dhe po bëhen hapa të rëndësishëm në shkallë vendi. Këtij qëllimi i shërbejnë strategjitë dhe programet e zhvillimit që janë hartuar, si në kuadër të zhvillimit në përgjithësi në shkallë vendi ashtu edhe strategjitë sektoriale të ministrive të linjës.⁴³ Nga ana tjetër është punuar jo pak për programe zhvillimi rajonale, si dhe për programe zhvillimi të veçanta vendore. Megjithatë, organet e qeverisjes vendore janë në fazën e konsolidimit të këtij funksioni pasi edhe baza ligjore sektoriale ka munguar. (PLGP/USAID. 2012).

Komponentët e zhvillimit ekonomik vendor

“Qytetet janë motorë të rritjes ekonomike. Qasjet tradicionale në zhvillimin ekonomik vendor janë të mbështetura edhe nga strategji të tjera, përfshirë edhe zhvillimin e grupeve, strategjive të konkurrencës dhe decentralizimit. Ekonomitë joformale në vendbanime të lagjeve të varfra janë një forcë e rëndësishme dhe e qëndrueshme ekonomike, siç janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).⁴⁴

Pra, siç jepet dhe në këtë definicion të USAID-it, zhvillimi ekonomik përmban shumë komponentë. Megjithatë, për efekt të kompleksitetit të ndikimit të tyre evidentojmë grupimin e tyre në kategoritë e mëposhtme:

- Komponentë që lidhen me tërheqjen e investimeve të reja,
- Komponentë që lidhen me ruajtjen e vendeve të punës,
- Komponentë që lidhen me zgjerimin e bazës së taksapaguesve,
- Komponentë që lidhen me përmirësimin e cilësisë së jetës.

Në analizën e këtyre komponentëve është e rëndësishme të orientohemi drejt në krijimin e mundësive për të rritur efektin pozitiv të secilit prej tyre në këtë zhvillim.

Në këndvështrim të përdorimit racional të komponentëve, vlera të veçanta mund të marrin kur çdo strukturë e shtetit dhe e shoqërisë arrin të ndikojë drejtpërdrejtë pozitivisht mbi to. Prandaj, me të drejtë shtrohet pyetja se si ndikojnë organet e qeverisjes vendore mbi këta komponentë. Përgjigja është pozitive në rastet kur përgjegjësia dhe roli i organeve të qeverisjes vendore janë të përcaktuara me ligj, gjë që i vë ato përpara detyrimeve dhe dispozitave për të ndërmarrë veprime konkrete.

Në vijim të atyre që u thanë më sipër, përpara organeve të qeverisjes vendore në bashki e këshilla të qarqeve shtrohen disa probleme të cilat duhet të mbahen parasysh gjatë hartimit të planit të zhvillimit. Ato lidhen me:

- Vlerësimin e drejtë të rolit që ka qeverisja vendore në zhvillim dhe hapësirat që kanë organet përkatëse për ushtrimin e këtij roli.

- Nevojën për hartimin e planit të zhvillimit ekonomiko-social të njësisë vendore, duke u argumentuar qartë me arsyetimet për prioritetet, drejtimet e zhvillimit, faktorët mbështetës, etj.
- Përcaktimit sa më të qartë të aktorëve që përfshihen në hartimin por edhe më pas në zbatimin e planeve të zhvillimit.
- Vlerësimin e mundësive që krijohen për të siguruar dinamikën e hartimit dhe të zbatimit të planit, i cili do të jetë mekanizmi i brendshëm që mundëson progresin.
- Nevojën për reklamimin e punës në proces, prezantimin, sensibilizimi i opinionit të brendshëm e të jashtëm në mbështetje të zhvillimit sipas programit.
- Vlerësimin dhe përcaktimin e objektivave konkrete që pritët të arrihen, në një farë mënyre të dalë sa më qartë cila do të jetë e nesërmja e programuar.

Roli konkret i qeverisjes vendore në zhvillimin ekonomik vendor

Politikat dhe parimet e Bashkimit Evropian, në lidhje me subsidiaritetin, harmonizimin fiskal dhe kontrollet e stabilizuara gjithashtu kanë demonstruar efekte në politikat e ekonomive në zhvillim dhe në ndryshim. (Shah, A 2004)⁴⁵

Kompleksiteti i mjedisit urban kërkon një strategji me një grup të instrumenteve të përshtatura për sfidat vendore. Qeverisjet vendore kanë njohur këtë realitet dhe janë në mënyrë aktive duke marrë më shumë iniciativa në menaxhimin e qyteteve të tyre. Menaxhimi i decentralizuar i qyteteve po bëhet gjithnjë e më shumë se sa një zgjidhje praktike, ai është duke u zyrtarizuar përmes politikave kombëtare që janë duke kaluar fuqinë apo vendimmarrjen tek qeverisja vendore⁴⁶.

Shqipëria, si një vend i një ekonomie në ndryshim, ka adaptuar legjislacionin për të luajtur një rol domethënës në zhvillimin ekonomik. Organet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik vendor në raport me funksionet dhe kompetencat që i jepen ligjërisht⁴⁷. Në kuadër të përcaktimit dhe stabilizimit ligjor të përgjegjësive që ato kanë mbi bazën e legjislacionit, janë krijuar kushtet që të përcaktohet më qartë edhe roli i qeverisjes vendore në këtë zhvillim ekonomik.

Duke u bazuar në funksionet dhe kompetencat ligjërisht aktuale, që janë të niveleve e standardeve evropiane, roli i vetëqeverisjes vendore në kushtet tona aktuale përmbledhet në drejtimit e mëposhtme:

- ***Qeverisja vendore kryen shërbime.*** Kjo nënkupton realizimin e kompetencave të përhershme shërbimi, kryerjen e kompetencave administrative, si dhe të investimeve kapitale në fushën e shërbimeve publike të zakonshme me karakter vendor.

Njësive të qeverisjes vendore u janë besuar funksionet bazë të shërbimeve ku, siç është cituar më lart, përfshihen shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve, pastrimi i qendrave të banimit, transporti publik vendor dhe administrimi i rrugëve vendore, hapësirat e gjelbëruara dhe ambientet çlodhëse e social-kulturore vendore, si dhe mjaft të tjera të kësaj natyre. Në funksion të këtyre shërbimeve, ato kanë të drejta të plota mbi objektet e infrastrukturës përkatëse si ujësjellës, kanalizime, rrugë, trotuare, banesa publike etj., si mbi institucionet që u shërbejnë atyre për ushtrimin e funksioneve. (Ligji No.8652/2000)

Të gjitha këto janë funksione mjaft të rëndësishme e përcaktuese për rolin e bashkisë apo komunës në zhvillimin e komunitetit përkatës. Shkalla dhe niveli i zhvillimit të këtyre shërbimeve kanë ndikim të madh në jetën e komunitetit në tërësi dhe, në varësi të mënyrës se si vepron pushteti vendor në këto sektor, bëhet mjaft përcaktuese edhe për zhvillimin ekonomik në tërësi.

“Decentralizimi i autoritetit fuqizon qeverisjen vendore për më shumë kontroll për të menaxhuar burimet. Kontributi i qeverive vendore në zhvillimin ekonomik mbështetet në aftësinë e tij për të mbështetur, stimuluar dhe rregullimin e mjedisit të biznesit vendor”.

(USAID/2006:12)

- ***Qeverisja vendore luan rolin rregullator në fushën e zhvillimit.*** Kjo nënkupton aftësitë e organeve të qeverisjes vendore për krijimin dhe vendosjen e rregullave brenda standardeve ligjore të vlefshme për një veprimtari funksionale, por edhe në përputhje me nivelin ekonomik-shoqëror në rritje.

Organet e qeverisjes vendore dhe administrata përkatëse hartojnë:

- ***Rregulla për përdorimin e tokës*** në zbatim të kompetencave për menaxhimin e tokës urbane dhe asaj bujqësore. Pavarësisht nëse toka është publike apo private, interesi për

një jetë normale në komunitete, bën të domosdoshme aplikimin e skemave dhe normave që t'i shërbejnë zhvillimit dhe për të harmonizuar faktorët për një qetësi publike optimale apo për një jetë normale të secilit banor në komunitet.

- *Rregullore për normalizimin e së drejtës në ambientet publike* që përfshinë vendosjen e raporteve e normave të qetësisë e komunikimit.

- *Rregullore në fushën e ndërtimeve për objekte të ndryshme.* Jeta në komunitet është shumë e ndjeshme. Ajo duhet të zhvillohet duke u harmonizuar, në përputhje me zhvillimin historik e shoqëror të komunitetit si dhe të garantojë qëndrueshmëri për një kohë të gjatë.

Prandaj, hartimi i planeve për zhvillimin e territorit me konsensusin e banorëve, është një nga drejtimet e rëndësishme për plotësimin e rolit që ka qeverisja vendore për një komunitet dhe që, aktualisht ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme tek ne, sidomos po të kemi parasysh që në vitet që kaluam si faze ndryshimesh rrënjësore, ka patur një intensitet ndërtimesh pa leje. Mos ushtrimi si duhet i këtij roli me ndërtimet pa leje në 10-vjeçarin e fundit përbën një plagë që duhet riparuar sa më parë dhe që paraqet shumë vështirësi e probleme.

- *Rregullore për cilësinë e jetës.* Kjo nënkupton hartimin e rregullave për një jetë sa më të kulturuar, për pastërti, për zhvillimin e aktiviteteve social-kulturore për një regjim të pranueshëm në komunitet. Këtij qëllimi i shërbejnë të gjithë rregulloret e pastrimit, vendosja e orarit të shërbimeve të brendshme dhe të funksionimit të institucioneve social-kulturore e sportive, etj. Nëpërmjet këtyre rregulloreve organizohet dhe disiplinohet veprimtaria publike në fushën e shërbimit shëndetësor, arsimit, zhvillimit të veprimtarive publike e private me ndikim në komunitet, etj.

Strategjitë e zhvillimit ekonomik me theks në qeverisjen vendore varen shumë nga mjedisi i komuniteteve të tyre. Një numër i strategjive janë miratuar, por në strategjitë e përgjithshme të ndjekura nga komunat dhe rajonet e Evropës Qendrore dhe Lindore përpiqen të përmirësojnë ekonomitë e tyre vendore duke përmirësuar burimet vendore nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, trajnimin dhe përmirësimin e burimeve njerëzore, dhe përmirësimin e klimës sipërmarrëse. (Dallago, B -2013:29)

Edhe në legjislacionin shqiptar, kjo klimë dhe ky rol është patur parasysht.

- ***Qeverisja vendore ushtron rol katalizator.*** Kjo nënkupton ushtrimin e funksioneve mbështetëse për të gjithë aktorët që përfshihen drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomiko-social të komunitetit dhe ndikon në krijimin e një atmosfere që lejon rritjen ekonomike dhe zhvillimin social. Ky rol realizohet nëpërmjet përdorimit të rrugëve të mëposhtme:

Shumë njësi vendore në vendet e SEE-së vuajnë nga mungesat financiare dhe nga kapacitetet e ulëta zbatuese. Ato janë të varura shumë nga transfertat ndërqeveritare dhe për pasojë ato nuk arrijnë që të gjejnë fondet e mjaftueshme dhe implementimin e planeve strategjike për zhvillimin ekonomik vendor. (Dallago, B -2013:32)

- ***Pushteti vendor bëhet ndërmjetës i interesave.*** Këtij qëllimi i shërben organizimi dhe mbështetja e ekspozitave, panairëve, reklamës apo publikimeve të ndryshme për shanset që ofrojnë potencialet brenda komunitetit.

Në Evropën Lindore dhe kryesisht në atë Jugperëndimore, qeverisja vendore në temat e zhvillimit ekonomik futet edhe me role si i mirëkuptimit etnik, uljes së tensioneve sociale duke ushtruar një rol aktiv me qëllim zhvillimin ekonomik për të sjellë paqe sociale. (Dallago, B and Uvalić 1998; Kostova 2007; Lazić, 2007)

Plani i Njësive Vendore për Zhvillimin Ekonomik

Mënyra dhe ritmet e zhvillimit ekonomik të një komuniteti vendor varen shumë dhe nxiten pozitivisht kur ecin me një proces planifikimi dhe drejtimi të harmonizuar e perspektiv.

Çdo komunitet ka mundësitë, atributet dhe potencialet e veçanta për të rritur apo ulur shanset për një sukses të zhvillimit ekonomik. Një gjë e tillë arrihet në bazë të formës mënyrës, qasjeve në proces nëpërmjet bashkëpunimit gjithëpërfshirës (Swinburn, G. 2006:9). Organet e qeverisjes vendore duhet të vendosen në epiqendër të këtij procesi. Është kjo arsyeja që programet sektoriale zhvilluese, programet e bizneseve të veçanta etj., duhet të arrihen të përfshihen, në një mënyrë apo në një tjetër në atë plan të përbashkët që bën të mundur bashkërendimin e kontributeve të veçanta në zhvillimin e përgjithshëm të komunitetit. Po ashtu është kjo arsyeja që hartimi i një plani për zhvillimin e komunitetit është tepër i nevojshëm dhe pa të nuk i shërbehet perspektivës. (Swinburn, G. 2006:9)

Në kontekstin e mësipërm: “Plani strategjik është proces sistematik, me anë e të cilit komuniteti mund të parashikojë të ardhmen e tij, si dhe të përcaktojë hapat që do të ndërmerren për t’i arritur ato”. Ai konceptohet si një proces krijues për identifikimin e problemeve kryesore, të qëllimit e objektivave, ashtu edhe si përcaktues i mënyrave për të realizuar ato objektiva. Në këtë mënyrë plani strategjik i zhvillimit ekonomik vendor është një program, një udhëheqje për veprim, për të gjithë komunitetin, e aq më tepër për veprimtarinë vendimmarrëse dhe ekzekutive të organeve të qeverisjes vendore. Në një konceptim të drejtë, plani strategjik fokusohet kryesisht në vlerësimin e problemeve dhe masave për drejtimin e procesit dhe më pak për kontrollin apo monitorimin e tij. Ai

më shumë i shërben të ardhmes dhe më pak të shkuarës dhe të tashmes, duke i konsideruar këto të fundit si bazë në përcaktimin e objektivave të zhvillimit perspektiv të njësisë në tërësi. Ndërkohë plani ofron mundësi për të përfshirë komunitetin në një proces planifikimi nga poshtë-lart. Në këtë mënyrë ai krijon terrenin e nevojshëm, për të përfshirë të gjitha energjitë potenciale që ka komuniteti, në zbatim të tij.

- *Plani i zhvillimit ekonomik vendor, që të jetë i suksesshëm duhet të konceptohet e të hartohet në mënyrë të integruar me të gjithë sistemin e dokumenteve që janë hartuar në shkallë vendi. Kështu duhet të harmonizohen analizat dhe objektivat e hartuara në kuadër të:*

- Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim - e hartuar më parë.
- Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, të cilat përbëjnë objektiva në nivel global, sidomos në fusha të tilla si varfëria, edukimi, shërbimi shëndetësor etj.
- Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit e cila shënon hapat dhe fushat me përparësi në kuadër të integritetit të vendit tonë në Evropë.
- Strategjive sektoriale, të cilat japin zgjidhje për shumë probleme dhe ecurinë e tyre për fusha të ndryshme të cilat, padyshim, përbëjnë pjesë të veçanta të zhvillimit vendor;
- Krahas planeve kombëtare të zhvillimit, planet e zhvillimit ekonomik vendor hartohen si në nivel qarku ashtu edhe në çdo bashki. Pra kuptohet që plane zhvillimi hartohen në:
 - Në nivel kombëtar,
 - Në nivel qarku (roli i tij shumë i zbehur tashmë)
 - Në nivel bashkie

Respektimi i autonomisë vendore kërkon që të sigurohen raporte të drejta në mes planeve të zhvillimit në të tre këto nivele. Për nga vlera dhe mundësitë që krijojnë për zhvillimin, nuk mund të bëhen krahasime në mënyrë të përgjithshme. Ka shumë probleme që presin zgjidhje në kuadër të planeve kombëtare ashtu siç ka edhe mjaft probleme të tjera të cilat kërkojnë zgjidhje nëpërmjet planeve vendore në bashki.

Po ashtu planet ekonomike vendore të zhvillimit, ndonëse do të trajtojnë me vëmendje dhe synojnë t'i japin zgjidhje problemeve të kompetencës së organeve të qeverisjes vendore dhe institucioneve vendore përkatëse, nuk mund të mos marrin në konsiderate zgjidhjet në shkallë vendi. Në qoftë se p.sh. plani vendor trajton problemin e rrugëve, kjo është plotësisht e lidhur me planin e zhvillimit të sistemit nacional të rrugëve i cili, jo vetëm duhet të njihet, por edhe të shërbejë për të funksionuar në mënyrë sa më cilësore i gjithë sistemi rrugor në shërbim të komunitetit⁴⁸.

Të gjitha këto nxjerrin në pah nevojën e bashkëpunimit, por edhe atë të integritetit të planeve tek njëri- tjetri. Nuk mund të bëhet fjalë për integritet të njërit plan në kurriz të planit tjetër e anasjelltas. Është më se e evidente që në këtë drejtim, në kushtet e një qeverisje të decentralizuar, nuk mund të ketë tutelë vertikale në fushën e zhvillimit, prandaj edhe planet nuk mund të mendohet që t'i imponohen njëri-tjetrit në mënyrë subjektive.

Këtu ka vend për ekuilibër në dy drejtime:

- *Plani strategjik i zhvillimit ekonomik vendor duhet të plotësojë avantazhet relative të tij.* Në dallim nga plani në shkallë vendi, në planin vendor gjejnë hapësirat e nevojshme vlerat e komunitetit, specifikat relative të resurseve por edhe të atyre që influencojnë në përcaktimin e rrugëve që do të përdoren për arritjen e objektivave. Në këtë kuptim

avantazhi relativ përbëhet nga ato karakteristika të veçanta apo kombinime të vlerave, të cilat dallojnë një komunitet nga një tjetër, sidomos në fushat ku konkurrohet.

- Njëpërmjet aktiviteteve kërkimore. Plani strategjik në vetvete është një punë krijuese bazuar në një situatë me një prejardhje, me qëllime, objektiva e prioritetë të seleksionuara mirë.

- Njëpërmjet studimeve. Plani nuk mund të jetë produkt i një intuete abstrakte por rezultat i studimeve për gjendjen si dhe të alternativave më efektive në kushtet konkrete të komunitetit.

- Njëpërmjet mirëkuptimit më të plotë më komunitetin, në analizën e faktorëve përcaktues ashtu edhe në vlerësimin e objektivave dhe procesit të realizimit të tyre. Duke qenë se planet nuk mund të kenë vlera universale, ato duhet të jenë të kuptueshëm dhe të gjejnë mbështetjen e banorëve.

Plani Rajonal/Qarkut dhe Plani Vendor

Bazuar në faktin se njësitë vendore janë të ndërtuara në dy nivele, nënkuptohet që edhe planet e zhvillimit do hartohen në të dy nivelet. Problemi del më evident po të kemi parasysh që peshën më të madhe të shërbimeve dhe më pranë banorëve, bizneseve dhe faktorëve të tjerë zhvillues janë bashkitë, ndërkohë që në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore, në këshillin e qarkut hartohen programe rajonale zhvillimi⁴⁹.

Në aspektin e koordinimit dhe realizimit të bashkëpunimit e të gjithë veprimeve zhvilluese, detyrë që synon të realizojë çdo plan perspektiv dhe të qëndrueshëm, plani në nivelin e qarkut do të shërbejë më së miri për të harmonizuar faktorët e përbashkët zhvillues, për bashkëveprim ndërmjet njësisë vendore që përfshihen në qarkun e dhënë,

por edhe për një bashkërendim më të mirë në mes planeve të zhvillimit në shkallë vendi me planet e zhvillimit të njësive të veçanta

2.3. Matja e Zhvillimit Ekonomik Vendor

Shpesh, efektshmëria ose jo e institucioneve është në themel të debateve dhe të retorikes politike. Që të jemi objektiv për punën e tyre do ishte me vend matja e performancës. Kjo kërkon që së pari të identifikohen indikatorët dhe pastaj të maten ato. Në lidhje me hipotezën, në këtë punim kërkohet së pari të identifikohen indikatorët që matin zhvillimin ekonomik dhe decentralizimin fiskal dhe pastaj të matim ndikimin e tyre.

Nisur nga përkufizimet e dhëna më sipër cituar autorë të ndryshëm, si (Swinbur G. 2006), apo Akai N, dhe Sakata M. 2002) dhe (Thornton, J 2007:64-70)⁵⁰, që përvijojnë indikatorët e zhvillimit ekonomik vendor mund të marrim shumë ndryshore, por nisur nga situata me të dhënat si dhe të kushtëzuar nga pamundësia e gjetjes së informacionit relevant, këto indikatorë identifikohen nisur kryesisht në konsultim me literaturën cituar më sipër.

2.3.1. Indikatorët e Zhvillimit Ekonomik Vendor

Nisur nga literatura e konsultuar, zhvillimi ekonomik vendor ka indikatorët e vet të matjes së rezultatit apo të përmbushjes së qëllimeve, të cilët na japin një pasqyrë domethënëse nëpërmjet vlerave të tyre. Këto janë:

- **Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë (PBB/f)**

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB): Prodhimi i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. Ai llogaritet me dy mënyra:

- **PBB me mënyrën e prodhimit** është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektorëve apo degëve të aktivitetit);

- **PBB sipas mënyrës së shpenzimeve** është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi).

PBB rajonal për frymë është sasia e këtij produkti pjesëtuar me numrin e banorëve të këtij rajoni bazuar në regjistrin e gjendjes civile.

Llogaritjet e PBB-së përfshijnë të gjitha prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara për treg si dhe ato të prodhuara për konsum vetjak nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin të cilësuar "ekonomik" të Shqipërisë. PBB-ja me metodën e prodhimit shpreh shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ekonomisë duke shtuar taksat e tatimet dhe duke zbritur subvencionet mbi produktet.

- **Numri i bizneseve të vogla dhe të mesme (NBV+M)**

Në Shqipëri bizneset e vogla dhe të mesme janë të ndara sipas Ligjit No.8957/2002.”Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të ndryshuar”. Por nga ana e kontabilitetit, si dhe për efekte tatimore sipas Ligjit “Për procedurat tatimore i ndryshuar” bizneset janë të ndara në dy kategori: 1) biznese të vogla që xhiron vjetore e kanë deri ne 8 milion/vit, si dhe 2) biznese subjekt i TVSH-së, të cilat pajisen dhe me numër identifikimi të personit të tatueshëm NIPT⁵¹.

Ndryshe nga vendet e tjera, në Shqipëri baza ligjore me të cilën identifikohet një biznes i vogël apo i madh, pra si subjekt i kontrolluar apo që tatohet nga qeverisja vendore apo

organet tatimore e qendrore, ka ndryshuar disa herë sipas politikave fiskale të qeverisë. Më poshtë në Tabelën V-2 shpjegohen me qartë dinamikat në vitet e fundit në qarkun Lezhë, qark në të cilin shtrihen dhe studimet e kësaj teme. Të dhënat për këtë indikator janë marrë nga INSTAT dhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë.

- **Volumi vjetor i të ardhurave nga bizneset - (shembull tabela Qarku Lezhë)**

Volumi vjetor i të ardhurave nga biznesi i vogël dhe i mesëm përfaqëson sasinë e të ardhurave të mbledhura nga qeveria vendore apo qendrore nga biznesi i vogël apo i mesëm si tatim i thjeshtuar mbi fitimin, ose kjo masë e llogaritur me regjistrat kontabël nga subjekti. Kjo masë, % e saj apo ajo fikse për tu paguar, ka ndryshuar gjatë periudhës së marrë në studim. Gjithsesi ky indikator ka parasysh rezultatin në fund të vitit si detyrime të paguara nga biznesi agjencive përkatëse vendore dhe qendrore.

- **Të punësuar gjithsej nga biznese jo bujqësore (PNBjB)**

Numri i vendeve të punës në këtë studim si indikator paraqet numrin e vendeve të punës të kontraktuar në biznesin e vogël dhe të mesëm në qarkun e studiuar. Numri është progresiv dhe paraqet numrin e punonjësve aktiv në çdo fund viti të marrë në studim.

2.3.2. Indikatorët e Decentralizimit Fiskal

Për të matur decentralizimin fiskal ka shumë këndvështrime dhe natyrisht edhe paqartësi relative në lidhje me indikatorët e decentralizimit fiskal. Decentralizimi fiskal, në shumë diskutime akademike dhe jo vetëm, është prezantuar si një çështje politike nga shumë vende. Termi që përdoret nuk është krejt i qartë, është një term i paqartë si në fushat e shkencave politike, ashtu edhe në ato të administrimit publik.⁵² Por për të hetuar në mënyre statistikore (gjë që edhe në këtë punim kam ndërmend ta bëj),

kontributin potencial të decentralizimit fiskal në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, duhet të bëjmë një strukturim që të mundësojmë matjen e ndikimit të decentralizimit fiskal në të. Siç e kemi thënë më sipër, përgjithësisht decentralizimi fiskal është një autoritet i dhënë nga lart-poshtë i shoqëruar me një fuqi vendimmarrëse tek niveli më i ulët i qeverisjes.

- ***Indikatori i të ardhurave të veta. (TAV)***

Të ardhurat e veta të njësisë vendore janë të ardhura që prodhohen nga njësia vendore, nga taksat dhe tarifat vendore, mbështetur kjo në Ligjin Organik 8652/2000, Neni 16, si dhe në Ligjin ‘Për Sistemin e Taksave Vendore në Shqipëri’ dhe në ‘Ligjin për Buxhetit Vjetor’.

Bashkia, krijon të ardhura nga:

- a) taksat dhe tatimet vendore mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
- b) taksat dhe tatimet vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël, të shërbimit hotelier, të restoranteve, bareve dhe të shërbimeve të tjera;
- c) taksat dhe tatimet vendore mbi të ardhurat vetjake të krijuara nga dhurata, trashëgimi, testamente ose lotari vendore;
- ç) taksa ose tatime të tjera të përcaktuara me ligj.

- ***Indikatori nga Grantet e Pakushtëzuara (GPK)***

Ky lloj indikatori përfaqëson dhe mat të ardhurat që njësive vendore i vijnë nga të ardhurat kombëtare. Përgjithësisht kjo shumë ndahet me formulë në bazë të së cilës është korrigjim apo barazim horizontal (në mes qeverisjeve vendore) dhe vertikal në

mes qeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore. Ky indikator përfaqëson apo shpreh mënyrë financimi që pavarësisht prejardhjes së tij, qeverisja vendore ka te drejte te plotë vendimmarrje për ta shpenzuar.

- ***Indikatori i Shpenzimeve te Veta Vendore (SHVV)***

Ky lloj indikator përfaqëson dhe mat shpenzimet e njësisë vendore që bëhen brenda një periudhe kohore të caktuar pavarësisht nga burimi i të ardhurave. Është një indikator shumë domethënës në të cilin shikohet edhe raporti me qeverisjen qendrore dhe mund të matet në vite apo në një periudhe të caktuar.

- ***Indikatori i shpenzimeve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH)***

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) është një agjenci publike e cila ka për mision nxitjen e një zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm dhe të balancuar në nivel rajonal dhe vendor. FSHZH-ja është krijuar në fillim të vitit 1993, mbi bazën e Marrëveshjes midis Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore. Me datë 11 maj 2009, Kuvendi i Shqipërisë në seancë plenare miratoi Ligjin Nr. 10130 dt.11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit" që i përcakton këtij institucioni një status të veçantë ligjor.

- ***Indikatori i Huamarrjes Vendore (HV)***

Huamarrja vendore e sanksionuar si e drejtë dhe instrument i financimit të njësive vendore në kuadër të konsolidimit të autonomisë u bë e mundur pas miratimit të Ligjit për huamarrjen vendore. Ligji Nr. 9869, datë 2008/04/02 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, rregullon kushtet mbi të cilat qeveritë vendore mund të marrin borxh dhe përcakton edhe çështjet e lidhura me to.

KAPITULLI III PROCESET DECENTRALIZUESE NE EUROPEN QENDRORE DHE LINDORE

3.1. NDRYSHIMET NE EVROPEN LINDORE

3.1.1. Ndryshimet në Evropën Qendrore dhe Lindore

Pas rënies së komunizmit një nga reformat më të rëndësishme që filluan të zbatohen në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në fillim të viteve '90 ishte krijimi i strukturave të reja të demokratike vendore (bashkiake) dhe raportet e reja ndërqeveritare pra mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Përveç vendeve të tjera të Ballkanit, të cilat do t'i paraqesim në kapitujt e mëposhtëm, me pak rreshta prezantohet qasja në reforma të vendeve të Evropës Qendrore, të vendeve të Baltikut dhe Sllovenisë. Arsyeja e këtij grupimi vendesh është një qasje për arsye praktike. (Horvath, 2000).

Arsyet e qasjes të këtyre vendeve në reforma decentralizuese dhe demokratike, përveçse politike dhe strukturore, janë edhe ekonomike, pra të zhvillimit ekonomik vendor. Siç shprehet në të njëjtin dokument Horvath: “Reforma e qeverisjes vendore është një pjesë esenciale e transformimit të sistemeve politike. Ajo është një element i ndryshimeve politike bazale, po ashtu një kontributor në zhvillimin ekonomik”. (Horvath, 2000). Siç shikohet, theksi në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore i vihet decentralizimit si një instrument në zhvillimin ekonomik.

Në këtë kontekst, decentralizimi i qeverisjes ka qenë shpesh i promovuar si një rrugë për të hequr pushtet nga qeverisja qendrore, për shkak të një interference të saj në funksionimin e ekonomisë së tregut, të lindura tashmë në ekonominë në ndryshim të

Evropës Qendrore dhe Lindore nëpërmjet privatizimit dhe të një liberalizimi të hyrjes së firmave të vogla në skenë. (Bird, R. M.; Ebel, R.D. dhe Wallich, C.I, 1995).

Prezantimi i modeleve të reja demokratike dhe pluraliste në nivel vendor ishte shumë i rëndësishëm në fillimet e ndryshimeve në këto vende. Çdo gjë u bë në harmoni të plotë me Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore. Të gjithë këto vende vendosen dhe zbatuan në legjislacionin e tyre parimet e Kartës në mes të viteve '90 duke afirmuar dëshirën për të ndjekur traditat e vendeve perëndimore evropiane sa i përket qeverisjes vendore. Procesi nuk ka qenë i thjeshtë, pasi dhe vetë Karta jep fleksibilitetet e veta për perspektivat e vendeve anëtare. (Horvath, 2000)

Reformat ishin në shumë drejtime legjislative, strukturore (sa i përket madhësisë së njësive vendore, pronave), institucionale (sa i përket shërbimeve vendore, transferimit të funksioneve, reformave elektorale), etj. Po për këtë punim me rëndësi është të prezantojmë në mënyrë të thjeshtë në këtë kapitull reformat financiare në këto vende, pasi reforma financiare prezanton më së miri edhe shkallën e autonomisë vendore. Sipas disa autorëve, indikator i autonomisë është indikator që mat shkallën e pavarësisë të qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore. (Nobuo Akai and Masayo Sakata, 2002).

Pavarësisht trashëgimisë institucionale vendore apo edhe kulturës së rajoneve të një pjese të vendeve, procesi i decentralizimit të financave apo i autonomisë fiskale ishte më domethënësi. Procesi i reformave të financave vendore në këto vende përfshin shumë më tepër se sa ndërtimin e institucioneve të reja. Gjithashtu ky proces është pjesë e përfshirjes së parashikimeve të shërbimeve dhe zhvillimeve vendore që i përgjigjet rrethanave ekonomike dhe sociale. Sipas të dhënave të prezantuara nga Horvath, në studimin prezantuar më sipër, si dhe duke e kalkuluar në raport me indeksin e autonomisë vendore sipas 'Nobuo Akai dhe Masayo Sakata', shihet se këto vende kanë

një indeks të lartë të autonomisë fiskale. Autonomia fiskale paraqet shkallën e lirisë të njësisve vendore në raport me atë qendrore dhe matet me % e të ardhurave të veta në raport me të ardhurat totale. Sa më sipër, që në vitin 1998 që i referohet studimi, shifrat e financimeve të qeverisjes vendore në këto vende janë: të ardhurat vendore si % e PBB në një interval nga 4.9% (Sllovenia) në 13.0% (Hungaria). Si dhe për sa i përket indikatorit tjetër, e të ardhurave vendore si % e shpenzimeve kombëtare, lëvizin nga 9.2% (Sllovenia) në 34% (Polonia). (Horvath, 2000).

Siç do ta shohim në kapitujt e mëposhtëm këto të dhëna në krahasim me vendet e Ballkanit apo të Evropës Juglindore janë më inkurajuese dhe tregojnë për një shkallë më të lartë të autonomisë vendore. Në kapitullin më pas do shohim këtë indikator në vite për Shqipërinë.

3.1.2. Ndryshimet në Evropën Juglindore

Vendet e Evropës Juglindore pas rënies së komunizmit hynë në periudhën e ndryshimeve në vitet '90 me trashëgimi të ndryshme si modele qeverisjeje. Shqipëria, Bulgaria dhe Rumania patën një eksperiencë të lartë centralizimi, ndërsa nga ish Jugosllavia u patën bërë më shumë transferime nga qeveria nëpërmjet sistemit socialist të vetë administrimit. (Dubey, 1975). Këto vende e përfshinë decentralizimin e shumë funksioneve qeverisëse, përveç diferencave në politika të mbrojtjes dhe ato monetare, të cilat qëndruan si pjesë e politikave federale.

Pas rënies së komunizmit në këto vende dhe fillimit të proceseve të ndryshimeve ekonomike dhe politike, evoluimi i sistemeve qeverisëse ndryshoi. Në ish vendet e centralizuara legjisllacioni për decentralizim ishte prezantuar në fillim të viteve 90 në Shqipëri (Sewelland Wallich, 1995), Bulgaria (Martinez Vasquez, 1995), and Romania

(Jakob,1995). Këto vende rezultojnë pas rënies së hekurt si vendet më të centralizuara të bllokut të lindjes.

Ndryshe u qasën reformat në ish Jugosllavinë (ka një trend të kundërt atje), duke filluar copëtimi në 1991, shtetet që pasuan centralizuan shumë funksione qeverisëse nën autoritetin e shteteve të reja. Pas mbarimit të luftës në këto vende interesi në decentralizim nuk ishte edhe aq në qendër të vëmendjes deri në konsolidimin e shteteve dhe të hequrit dorë nga disa funksione për t'ia kaluar qeverisjes vendore. Kjo ndodhi pas ndryshimeve demokratike në Kroaci dhe Serbi para viteve 2000 me rënien e regjimeve të Tuxhmanit dhe të Millosheviçit. (Will Bartlett, Sanja Malekovic, Vassilis Manastiriotis., 2013).

3.1.3. Ndryshimet në vendet e Ballkanit Perëndimor

Decentralizimi i qeverisjes tek niveli rajonal dhe vendor, në të dy format e tij, në atë administrative dhe fiskale, ka ndodhur në shkallë të ndryshme në vende të ndryshme. (Kandeva, 2001); (Sevic, 2008).

Në këto vende, me një vëzhgim standard mund të gjejmë forma të ndryshme decentralizimi. Decentralizimi ka tre forma të ndryshme: fuqitë e qeverisjes qendrore, thjeshtë vetëm mund të dekoncentrohen, që do thotë ofrimi i shërbimit bëhet nga zyrtarë vendorë por që financohen nga qeverisja qendrore. Një formë më e zgjeruar e decentralizimit është delegimi, ku sërish politikat vendosen nga qeverisja qendrore, e cila shpesh edhe e mbikëqyr ofrimin e shërbimit dhe ofron pjesën më të madhe të financave dhe ku qeverisja vendore ka autonomi se si duhet të ofrohet shërbimi, pra formën e organizimit si dhe mbase ka edhe një farë lirie në vendosjen e taksës. Të dy këto tipa decentralizimi mund të shihen në shumë vende në Evropën Juglindore. Në

Shqipëri dhe në Rumani institucioni i prefektit luan të njëjtin rol. Tipi më i gjerë i decentralizimit është transferimi i përgjegjësiave në përcaktimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve në nivelin më të ulët të qeverisjes. Rasti i Bosnjës, është një shembull, i një decentralizmi (transferimi) të gjerë në të cilin, fuqia e qeverisjes qendrore është e tkurrur vetëm në disa elementë esenciale, siç është mbrojtja kombëtare dhe rregullimet monetare. (Will Bartlett, Sanja Malekovic, Vassilis Manastiriotis., 2013).

3.1.3.1. Zhvillimi Ekonomik Vendor ne Vendet e Ballkanit Perëndimor

Qasja tradicionale tek zhvillimi ekonomik vendor i shteteve ka qenë ndërhyrja për të korrigjuar dështimet e tregut. Fondet e zhvillimeve rajonale si dhe një sërë agjencish të zhvillimit (krijuar edhe në Shqipëri) shpesh janë krijuar për të kundër reaguuar efektet jo favorizuese të forcave të tregut në rajone të pa balancuara ekonomikisht. Në kontrast me këtë sa më sipër, teori të reja të zhvillimit ekonomik vendor i vënë theksin roleve të institucioneve në mobilizimin e resurseve “indigjene”, si një ndërmarrje të tillë që prezanton aftësitë dhe risitë për të mbështetur rritjen e ekonomike vendore. (Pike, A. 2006; Barlett, W. 2013).

Por kundrejt pikëpamjeve optimiste për decentralizimin, si dhe për mundësinë që nëpërmjet tij si instrument e qasje mundemi të konsolidojmë demokracinë vendore dhe jo vetëm, të përmirësojmë shërbimet dhe të ndikojmë në zhvillimin ekonomik vendor, ka dhe këndvështrime pesimiste.

Shumë literaturë sa i përket decentralizimit i janë përkushtuar çështjes së deficiteve kombëtare dhe pamundësisë zbatuese apo administruese të njësive vendore si pasojë e mungesës së kapaciteteve. Është gjerësisht e njohur që një nga situatat e pafavorshme sa i përket decentralizimit është se qeverisja vendore mund të mos ketë kapacitete të

zbatojë programe në mënyrë efektive në raport me çfarë është në gjendje qeverisja qendrore meqë ato kanë burime të pakta menaxheriale së bashku me fuqitë e punës dhe lehtësitë e nevojshme. (Prud'homme, 1995). Kjo mbase ka më shumë kuptim për shumë vende ku copëzimi i qeverisjes e bën të pamundur plotësimin e gjithë strukturave me burime njerëzore të përshtatshme.

Por ky disavantazh nuk përshkruan dhe nuk përmbyll analizën e faktorëve pro dhe kundra rolit të qeverisjes vendore në zhvillimin ekonomik vendor. Mund të themi pavarësisht avantazhit të identifikuar në luajtjen e këtij roli, nga ana tjetër qeverisja qendrore mund të ketë më pak informacion rreth nevojave dhe resurseve vendore. Por, siç shprehet edhe Bardhan, asimetria është e dy anshme; qeverisja qendrore nuk di se çfarë duhet të bëjë, ndërsa qeverisja vendore nuk di se si duhet bërë (Bardhan, 2002). Pra, nëse për handikapi burimeve mund të merren masa siç është shkrirja, bashkimi apo ngritja e një sistemi identifikimi nevojash për rritje kapacitetesh apo edhe sistemeve nxitës për burimet njerëzore, nga ana tjetër handikapi i informacionit apo edhe fleksibiliteti për t'iu përgjigjur nevojave vendore dhe rajonale me efikasitet dhe efikasitet sidomos edhe në kohën e sasinë e duhur nga ana e qeverisjes qendrore është i “pashërueshëm”. Po kështu, lëvizjet migruese mjaft dinamike në fazat transitive, ndryshimi i nevojave dhe qasjeve mjaft eklektike në terren favorizojnë dukshëm qeverisjen vendore si faktor në zhvillimin ekonomik vendor.

Qëllimi kryesor i decentralizimit në fillimet e këtij procesi ka qenë që të ulë, të minimizojë autoritetin e qeverisjes qendrore të cilat u diskredituan në vendet të cilat punuan nën një qeverisje tepër të centralizuar nën regjimin komunist. Këto reforma u zbatuan në fillim në vende si Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania dhe më vonë në vendet

e ish Jugosllavisë pas viteve 2000. Por, ato kanë sjellë dhe probleme në strukturë, në mënyrën e funksionimit, si dhe në ndikimin e saj në çështjet vendore.

Decentralizimi në vendet e Ballkanit dhe qasjet zhvilluese të njësive vendore kanë pasur dhe aberracionet apo deformimet e tyre. Ka patur raste që shërbimet qendrore dhe sidomos ato vendore janë vënë në dispozicion për përmbushur kënaqësitë e elitave qendrore dhe vendore, në vend që të orientohen dhe të përmbushin nevojat dhe preferencat e popullsisë vendore dhe me gjerë. (Bardhan, P. dhe Mookherje, D. 2006).

Pra, secili nivel qeverisës ka anët e veta të forta e të dobëta në luajtjen e rolit institucional e rregullator në funksion të zhvillimit ekonomik vendor.

Entuziazmi për decentralizimin ka qenë i fokusuar kryesisht në rolin e tij potencial në nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor, ofrimit të shërbimeve në mënyrë të përshtatshme sipas nevojave vendore dhe në zgjidhjen e rivaliteteve dhe konflikteve etnike. (Will Bartlett, Sanja Malekovic, Vassilis Manastiriotis., 2013). Kjo e fundit, ka qenë si fjalëkalim i demokracive vendore dhe qëndrueshmërie të shteteve të krijuara pas konflikteve duke i dhënë një autonomi substanciale njësive të pakicave etnike dhe rajoneve me mbizotërime minoritare.

Siç dhe pamë më sipër në rastin e vendeve të Evropës Qendrore, po kështu dhe vendeve të Ballkanit apo Evropës Juglindore, decentralizimi si një instrument politik dhe i ndërtimit të bazave të një sistemi demokratik nuk ka mjaftuar si i tillë; ai është parë si një instrument për zhvillimin ekonomik vendor.

3.1.3.2. Zhvillimi Ekonomik Vendor, Roli i Qeverisjes Vendore në Vendet SEE

Qëllimi i përgjithshëm ekonomik i transformimeve në Evropën Juglindore, përgjatë mbi 20 viteve të fundit, ka qenë mbështetja e qëndrueshme për rritje ekonomike. Kjo kërkonte nga shtetet e këtij rajoni që të sigurojnë liri. Sa i përket kushteve për krijimin e institucioneve, organizatave dhe strukturave zhvillimore vendore duhet të ketë luajtur një rol qendror në këtë, sipas meritave të tij dhe kjo duke marrë në konsideratë natyrën e decentralizuar të sistemit ekonomik të para-transformimit. Qeverisja vendore është thellësisht e rëndësishme për sa i përket sukseseve të këtij transformimi për një sërë arsyes: ka mobilizuar burime të shpërndara, duke nxitur sipërmarrjen dhe shfrytëzimin ekonomik të kapitaleve njerëzore, ka lejuar politikat që të përgjigjen më mirë dhe të adaptohen ndaj goditjeve asimetrike që kanë ardhur nga integrimi në botën e ekonomisë së tregut, uljen e kostove të transaksioneve nëpërmjet forcimit të besimit dhe adaptimit të infrastrukturës sipas rrethanave vendore. (Dallago, B. and Uvalic, M., 1998).

Zhvillimi vendor

Sipas (Bartlet, W. 2013) disa elemente të zhvillimit ekonomik vendor kanë ekzistuar në Evropën Qendrore dhe Lindore para fillimit të proceseve demokratike atje. Siç thamë më sipër nuk ka një definicion për zhvillimi ekonomik vendor e kjo do thotë që autoritetet vendore do bëjnë e do trajtojnë tema të ndryshme. Për shumë njerëz në qeverisjen vendore, zhvillimi ekonomik është një mjet një plan strategjik për të rritur ekonominë në funksione të rritjes së punësimit dhe rritjen e të ardhurave të veta të qeverisjes vendore. Aktivitetet për të arritur këto qëllime përfshijnë ruajtjen e zhvillimin e bizneseve ekzistuese dhe krijimin e atyre të reja. Identifikimi i tregjeve dhe transferimin e teknologjive të reja. Zhvillimi ekonomik vendor si

term është përdorur shpesh në një kuptim më të gjerë për të përfshirë tokën dhe zhvillimin fizik të saj.

Në studimet e tija për planifikimin e zhvillimit ekonomik, Edward J. Blakely (1994) përshkruan zhvillimin ekonomik vendor si “një proces në të cilin qeverisja vendore dhe/ose gupet me bazë komuniteti menaxhojnë resurset e tyre dhe hyjnë në një partneritet të ri me sektorin privat, ose me njëri tjetrin, për të krijuar vende të reja pune dhe të stimulojnë aktivitete ekonomike në një zonë të mire përcaktuar ekonomike (Blakely, 1994)⁵³.

Një qasje standarde në analizën që i bëhet zhvillimit ekonomik vendor është që kjo rritje gjen vend kur institucionet qëndrojnë afër për të reduktuar pasigurinë, lehtësojnë ndërveprimin social, sigurojnë nxitje të fortë për aktivitet ekonomik dhe mban kostot efektive të zbatimit në nivel të ulët. (Sautet, 2005).

Kjo trajtesë apo kjo linjë prezanton në fakt tërë shkallën e sjelljes institucionale dhe jo vetëm të njësive vendore sa i përket zhvillimit ekonomik vendor. Pavarësisht kushteve e pikës së nisjes ndryshimeve në bazën ekonomike dhe sociale, nivelit të qeverisjes vendore, mënyrës së si i etiketojnë strukturat (rajone, provinca, komuna, bashki apo fshatra) me dy ose tre nivele është organizuar qeverisja vendore në këto vende, me qëllim që të kenë në konsideratë rrethanat vendore, si dhe institucionalizimin e tyre.

Përfshirja e qeverisë vendore në rritjen ekonomike është debatuar më tej.

Sipas Capkove.S, problemi nuk shtrohet nëse qeverisja vendore duhet të përfshihet në zhvillimin ekonomik vendor, por cili do të jetë roli dhe pozicioni i saj në mënyrë që të ndikojë pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë vendore. Qeverisja vendore ka kapacitetet të mbështesë projektet e zhvillimit ekonomik. Financat vendore mund të përmirësohen nëse qeveria vendore merr pjesë në programet e proceset e zhvillimit ekonomik.⁵⁴

Pra, pavarësisht divergjencave për rolin e qeverisjes vendore në zhvillimin ekonomik vendor, në rastin më të keq e me pesimist, debati është si dhe sa duhet përfshirë qeverisja vendore në tema të zhvillimit vendor. Po kështu arsyet se për çfarë e duan njësitë vendore zhvillimin vendor dhe planet strategjike janë të ndryshme; një pjesë për të rritur taksat vendore, të tjerët për punësim, të tjerët për rritje ekonomike, etj.

Por një gjë është e sigurt: njësitë vendore kanë rol dhe ato i shërbejnë shumëllojshmërisë së qëllimeve. Ato i shërbejnë dhe japin përgjigje pyetjes se përse duhet një plan i qëndrueshëm vendor dhe jo më a duhet, por ku dhe kur duhet një ndërhyrje e tillë. Ky avantazh që ato kanë është përcaktues.

Në vendet e Evropës Juglindore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një strukturë të ngjashme, fuqi dhe funksione, pavarësisht se mund të kenë numër të ndryshëm banorësh. Por, status special i është dhënë kryeqyteteve, nganjëherë dhe qytetit të dytë për nga madhësia. (Woelk, J. 2005)

Qeverisja vendore përveç të tjerash përfshin edhe autoritetin politik, si dhe përdor resurset institucionale për të menaxhuar dhe koordinuar të gjithë procesin, për të marrë vendime, akorduar fondet, si dhe për të ofruar shërbimet në nivel vendor. Ky ushtrim në qeverisjet vendore të Evropës Juglindore bëhet mes të tjerash për të krijuar një ambient të favorshëm në mënyrë domethënëse për zhvillimin ekonomik vendor.

Ky lloj korrelacioni mes autonomisë fiskale është i dukshëm dhe në grafikun e dytë në të cilin shihet qartë se vendet e Ballkanit dhe të Evropës Juglindore, me disa përjashtime, këtë koeficient e kanë më të ulët. N.q.s. do të shmanget viti 2009 për arsye të ndikimit të krizës ekonomike në rajon si dhe të reformave strukturore për vendet që hynë në BE pas një viti, korrelacioni është i qartë.

Por sërish ngrihet pyetja: Sa është e mundur që qeverisja vendore të luaj rolin e saj si financuese e planeve vendore për zhvillim ekonomik në këto kushte financiare?

Dhënia e përgjigjes kësaj pyetje të drejtë nuk është objekt i këtij punimi, por për rastin e Shqipërisë do ndalemi për ta analizuar hollësisht më poshtë.

3.2. PROCESI I DECENTRALIZIMIT NE SHQIPËRI

3.2.1. Trashëgimia Vetëqeverisëse Vendore në Shqipëri (Qasje e Shkurtër Historike)⁵⁵

Pyetja që të vjen në mendje është që: A ka Shqipëria një trashëgimi të qeverisjes vendore autonome (natyrisht duke projektuar problemet dhe stadin e kohës që i referohemi) që i brenda shkruhej një strukturë administrativo territoriale?

Vlen të bëhet një panoramë retrospektive e shpejte sa për të sqaruar këtë element trashëgimor.

Gjatë reformave të Tanzimatit⁶ (rreth viteve 1827), të dy pashallëqet e Shqipërisë u vendosën nën kontrollin e Portës së Lartë, e cila, megjithëse në kushte të vështira, ndërtoi një ndarje të re administrative dhe i gjithë territori u nda në katër vilajete (provinca): Shkodër, Kosovë, (me qendër në Shkup), Manastir dhe Janinë. Vilajetet më sipër u ndanë në Sanxhakët (prefektura) përkatëse dhe këto të fundit në Kaza (nënprefektura) dhe Nahije (komuna).⁷

⁶ Këto reforma bënë të pa kënaqur mjaft popullatën dhe nxitën një revoltë, e cila pati edhe ajo efektet e veta. Në një situatë të tillë e gjeti vendin kongresi i Berlinit i cili kishte qëllimin që ti jepte në një farë mënyre fund periudhës së dominimit të Perandorisë Osmane.

⁷ Tajar Zavalani “Historia e Shqipërisë”, Botim i 1957, Londër

Pas shpalljes së Pavarësisë, me gjithë vështirësitë me të cilat u ballafaqua, Qeveria e Vlorës veprroi në mënyrë shumë energjike dhe fillimisht rëndësi të veçantë ju kushtua organizimit të shtetit të ri shqiptar. Për këtë ajo hartoi një sërë ligjesh në mes të cilëve mund të dallojmë “Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile” dhe “Kanuni i Jurisë”. “Kanuni i Përshtatshëm i Administratës Civile” u publikua në nëntor 1913. Megjithëse nuk ishte një Kushtetutë ai ishte ligji themelor i shtetit. Me këtë ligj u krye edhe ndarja e re administrative, duke përmbysur traditën e vjetër të pushtimit Otoman.

Zonat ku shtrihej Qeveria u ndanë në prefektura, nënprefektura dhe krahina. Në ndarjen administrative, çdo krahinë duhej të kishte nga 3000 deri në 7000 banorë dhe fshatrat që përbënin krahinën të mos ishin shumë larg nga njëri-tjetri. Me gjithë vështirësitë e asaj kohe, qeveria e Vlorës u përpoq të organizonte shtetin Shqiptar.

Hapi më i rëndësishëm ishte hartimi dhe zbatimi i “Statutit Organik të Shqipërisë” që u bë ligji themelor i vendit dhe si i tillë, ishte i ngjashëm me kushtetutën⁸. Në bazë të këtij ligji, vendi ynë shpallej principatë kushtetuese, sovranë e trashëgueshme, duke sanksionuar formën monarkike të qeverisje. Gjatë kësaj kohe në Shqipëri u bë një ndarje e re administrative në shtatë sanxhakë (Shkodër, Elbasani, Dibra, Durrësi, Berati, Korça dhe Gjirokastra). Këto u ndanë në kaza dhe nahije, pra duke ruajtur formën e ndarjes administrative njësoj si gjatë pushtimit turk.

Nahija përbëhej nga një grup fshatrash të lidhur gjeografikisht dhe ekonomikisht dhe udhëhiqej nga mudiri, i cili ndihmohej nga një këshill komunal. Gjithashtu parashikohej që në kryeqendrat e sanxhaqeve dhe nahijeve të funksiononin bashkitë, kryetari i të

⁸ Ky ligj u hartua dhe u miratua në Vlorë më 10 Prill 1914 dhe mbështetej në vendimet kryesore të Konferencës së Londrës.

cilave emërohej nga Ministri i Brendshëm. E njëjta gjë bëhej edhe në qytetet me mbi 25000 banorë. *Duke qenë se gjendja ishte mjaft e rënduar⁹, ishte pothuajse e pamundur që të arrihet dhe të realizohet një qeverisje vendore normale dhe aq më pak të flitet për decentralizim ose autonomi të kësaj qeverisjeje.*

Në vitet 1920-24 shteti shqiptar hodhi hapat e parë të rëndësishëm drejt organizimit të tij mbi baza parlamentare, ligjore dhe me vizion demokratik. U kryen zgjedhjet e para dhe për arsyen se ishte me dy faza ky proces filloi në shkurt-mars dhe përfundoi me 5 prill 1921. Kjo ishte periudha kur u shfaqën edhe grupimet politike të cilat ishin në hapat e parë të eksperiencave të tyre. Rëndësi të madhe kishte edhe “Statuti i Zgjeruar i Lushnjës” i cili u miratua në dhjetor 1922. Ky status miratoi norma demokratike për kohën. Ai u bë bazë për një demokraci parlamentare në Shqipëri edhe pse për një kohë të shkurtër.

Më 11 maj 1925 pasi fitoi zgjedhjet e reja qeveria Zogiste mbështetur në Statutin Themelor, ndërmori një sërë masash për riorganizimin dhe krijimin e një administrate të rregullt shtetërore. Si edhe më parë, vendi u nda në prefektura, nënprefektura, bashki dhe komuna. Në strukturat e qeverisjes vendore pavarësia politike ishte në nivele mjaft të ultë. E kundërta ndodh me kompetencat, funksionet ekonomike dhe shoqërore të cilat ishin në nivel mjaft të lartë. Zgjedhjet e gushtit 1925 u fituan pa shumë problem nga forca politike dhe përkrahësit e A. Zogut. Asambleja Kushtetuese që filloi punimet më 25 gusht 1925 bëri ndryshimin përkatës që i linte rrugën hapur për ndërrimin e formës së regjimit. Sipas Statutit, Shqipëria u shpall “Mbretëri Demokratike Parlamentare dhe

⁹ - Nga të gjitha anët, Shqipëria ndodhej nën presionin e fqinjëve të saj si Greqia, Serbia dhe Mali i Zi, gjithashtu Bullgaria, Austro-Hungaria dhe Italia

Trashëgimtare.”¹⁰ Si në statutet e mëparshme, u ripohua parimi i ndarjes së tre pushteteve. Njihej liria e fjalës, e shtypit, e mbledhjeve, etj., parime këto të cilat i dhanë një ngjyrë moderne Statutit të ri. Ndarja territoriale e vendit u bë në prefektura, nënprefektura, qarqet, bashkitë dhe komunat.

Në qendër të çdo prefekturë dhe të disa nënprefekturave kryesore vepronte edhe bashkia, e cila kishte për detyrë të merrej me ndërtimin e mëtejshëm, zbukurimin, pastrimin dhe zbatimin e masave higjienë – sanitare e të mirëmbajtjes së qytetit. Pozitat juridike, kompetencat dhe të ardhurat e bashkive rregulloheshin sidomos nga Ligji i dt. 1 dhjetor 1928, “ **Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Bashkive** ” dhe ligji “ **Mbi të Drejtat e mbi Financat e Bashkive.**” Për kryerjen e detyrave të tyre, bashkitë kishin burime të veçanta të ardhurash, të parashikuara në dispozitat e ligjeve të përmendura më sipër. Mbi këtë bazë, çdo bashki konsiderohej person juridik më vete. Ajo drejtohej nga këshilli i përhershëm i saj, që në kryeqytet përbëhej nga katër vetë, ndërsa në prefekturat e tjera dhe në nënprefekturat përbëhej nga dy veta, të zgjedhur nga asambleja përkatëse dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kryetari i bashkisë emërohej me dekret mbretëror, mbi propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, por midis atyre që ishin zgjedhur nga asambleja përkatëse. Asambleja e bashkisë së kryeqytetit përbëhej nga njëzet e katër anëtarë, ajo e bashkisë së prefekturave nga tetë anëtarë dhe ajo e nënprefekturave nga gjashtë anëtarë që zgjidheshin për një periudhë trevjeçare. Votimi për zgjedhjen e asamblesë së çdo bashkie, ishte i drejtpërdrejtë dhe i hapur dhe kryhej nën kujdesin e një komisioni të posaçëm që kryesohej nga gjyqtari pajtues. Të drejtën e votimit e gëzonin gjithë

¹⁰ Kjo erdhi në një kohë kur monarkia ishte “vjetëruar” si sistem qeverisës në Evropë, por duhet pranuar që pati një hap të rëndësishëm në krijimin e shtetit të parë real shqiptar.

shtetasit shqiptarë meshkuj që kishin mbushur moshën 25 vjeç, dhe dinin të shkruanin dhe lexonin në gjuhën shqipe.

Niveli i autonomisë administrative ishte i moderuar. Autoriteti i shtetit nëpërmjet prefekturave ishte shumë i fortë. Struktura e qeverisë që kontrollonte aktivitetin e autoritetit vendor ishte Ministria e Brendshme.

Kompetencat me natyrë ekonomike dhe sociale ishin mjaft të gjera. Struktura vendore, veçanërisht bashkitë kryenin shërbime publike të ndryshme, administronin një buxhet të financuar kryesisht nga taksat vendore dhe të ardhurat nga zotërimi i pasurive vendore ose nga administrimi i pasurive natyrore¹¹. Administrata vendore kishte pak personel, avantazhi i së cilës ishte efektshmeria, e cila me kalimin e viteve u përmirësua si për angazhim, profesionalizëm dhe shpërblim.

Me gjithë kushtet kritike sociale ekonomike, u arrit një veprim pozitiv i shtetit dhe u krijuan njësi administrative në frymën e perëndimit. Funksionet që ushtronin organet e tyre ishin mjaft cilësore dhe administrata kishte rendiment.

4. Njësite vendore në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë periudhës 1944-90, centralizimi dhe qeverisja nga lart mbizotëroi plotësisht. Sistemi ligjor dhe kushtetues e konsideronte pushtetin vendor më tepër si “Struktura vendore të qeverisë” sesa si “Struktura të qeverisjes vendore”¹², duke i përfshirë ato në piramidën e mbyllur shtetërore.

¹¹ - Ligji dt: 1 Dhjetor 1928, “ Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkive “Fletore Zyrtare nr.57, viti 1928. Ligji dt: 1 Dhjetor 1928, “ Mbi të drejtat e mbi financat e bashkive.” Fletore Zyrtare nr.57, viti 1928.

¹² Artan Hoxha dhe Alma Gurraj “Vetqeverisja vendore dhe decentralizimi: Rasti i Shqiperise. Historia, Reforma dhe Sfidat” Viti 2000/ Tiranë

Struktura vendore e qeverisjes përbëhej nga këshilli i rrethit si nivel i parë dhe këshilli i qytetit/fshatit si nivel i dytë. Në qytete ekzistonin edhe njësi më të vogla, të njohura si këshilli i lagjes. Këshilli i autoriteteve vendore zgjidhej nga votime formale një herë në katër vjet, por gjithsesi ato nuk kishin autonomi politike apo administrative. Funksionet e ndryshme ekonomike dhe sociale të zbatuara nga këto struktura ishin pjesë të ndarjes vertikale të detyrave ekzekutive në një shtet të centralizuar, në lidhje me marrjen e vendimeve dhe për zgjedhjen e politikave. Buxheti i tyre transferohej kryesisht nga buxheti i shtetit i detajuar në mënyrë të sakte, si për shpërndarjen e artikujve, ashtu edhe për mënyrën e përdorimit të tyre. Institucionet vendore kishin në mes tyre lidhje varësie. Institucioni më i lartë i cili kishte më shumë funksione ishte Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit. Këshilli i Ministrave cakonte kryetarin e këtij këshilli. Këshilli i qytetit/fshatit konsiderohej si një institucion i një niveli më të ulët. Ndër detyrat kryesore të këshillit të rrethit ishin zbatimi i planeve prodhuese të ndërmarrjeve dhe kooperativave shtetërore në rrethin përkatës.

3.2.2. Reformat Decentralizuese Post Komuniste

Ndryshimet politike, të ndodhura në vitet 1990-91, sollën një sërë ndryshimesh rrënjësore në organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore si organe të administratës publike. Në fillim të dekadës së fundit (viti 1992) të shekullit të XX-të, pasi u realizuan zgjedhjet e para demokratike dhe të lira, i gjithë sistemi ndryshoi dhe njëkohësisht së bashku me ndryshimet e tjera erdhën edhe ndryshime në ndarjen e territoriale të vendit si dhe në organet e qeverisjes vendore.

Reformat e vitit 1992, ndërtuan për herë të parë autonominë politike të qeverive vendore, por në mënyrë të theksuar mungonte autonomia administrative dhe fiskale.

Ligji Nr. 7570 i miratuar më 3 qershor 1992 “Për Disa Shtesa në Ligjin Nr. 7491, dt. 29 prill 1991 “ Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese”, i shikonte parimet e **vetëqeverisjes, autonomisë vendore** dhe **decentralizimit**, si parime kryesore të organizimit dhe funksionimit të njësive të qeverisjes vendore. Në majin e vitit 1993 u miratua Ligji “Për Buxhetin e Pushtetit Vendor”, me anë të cilit shpresohet që të garantohej autonomia (administrative e financiare) dhe fuqizimi i qeverisjes vendore. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, kjo autonomi mbeti shumë e kufizuar për shkak të presioneve ekonomike, normale gjatë periudhave të ndryshimeve si dhe përpjekjeve për të ruajtur stabilitetin makro-ekonomik. Si arsye tjetër e këtij kufizimi të autonomisë së qeverive vendore, duhej të ketë qenë edhe përqendrimi i interesit të përgjithshëm në ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve bazë të shtetit.

Në Majin e vitit 1998 u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë “Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore”. Më 28 nëntor 1998 u miratua Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në nenet 108 deri në 115, që përbëjnë edhe pjesën e gjashtë të Kushtetutës, sanksionohet qeverisja vendore duke bërë pjesë të saj “Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore”. Në këto nene është sanksionuar organizimi dhe funksionimi këtij pushteti parimisht, duke ia lënë saktësimet dhe hollësitë dispozitave të mëpasshme. Kompletimi i kuadrit ligjor u përmirësua me Ligjin Nr. 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Pushtetit Vendor” dt.: 31 korrik 2000, me Ligjin Nr. 8653 “Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” datë 31 korrik 2000 dhe me Ligjin 8654 “Për Funksionimin e Bashkisë së Tiranës”.

3.2.3. Strategjia e Decentralizimit (1999)

Qeveria Shqiptare në objektivat e saj, menjëherë pas miratimit të Kushtetutës (1998) dhe hyrjes në fuqi të Ligjit “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore” (2000) filloi zbatimin e “Strategjisë Kombëtare të Decentralizimit”.¹³

Strategjia kishte tre faza për t’u zbatuar a) fazën e menjëhershme - që kishte ndërhyrje afatshkurtra; b) fazën njëvjeçare - ku do kishte nisma ligjore dhe përgatitorë për zgjedhjet që do vinin menjëherë c) faza e plotësimit të autoritetit dhe fushës së kompetencave. Përveç kësaj, në përputhje me parimet e Kartës Evropiane, do ndërmerreshin masa për heqjen e pengesave për procesin e decentralizimit që ishin të natyrës ligjore, administrative, financiare, pronësie, etj. Të gjithë këto kërkonin një bazë ligjore koherente në përputhje të plotë me objektivat e strategjisë për një qeverisjeje vendore autonome. I gjithë procesi do të ishte i matshëm dhe rezultatet e tij do monitoroheshin nëpërmjet indikatorëve të përshtatshëm nga mekanizma të specializuar dhe nga opinioni publik nëpërmjet vëzhgimeve dhe pyetësorëve. Vizioni i kësaj strategjie ishte: Kjo strategji është shprehje e vizionit, konsensusit dhe interesave të përbashkëta për prosperitetin ekonomik dhe social të vendit të afirmuar nga Qeveria, organet e qeverisjes vendore dhe organizmat e shoqërisë civile. Duke u bërë gjerësisht e njohur, ajo do të marrë mbështetjen edhe të qytetarëve në përgjithësi. Strategjia u përgatit, do të miratohet dhe mund të rishikohet për t’u përmirësuar, duke u bazuar gjithnjë në mirëkuptimin e gjerë të arritur mes këtyre aktorëve⁵⁶.

Kjo strategji u përgatit nga një konsultim i gjerë nën mbështetjen e USAID dhe u hartua nën mbështetjen e dy strukturave politike dhe teknike siç ishin: Komiteti Kombëtar i

¹³ Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore u nënshkrua nga Shqipëria më 27/05/1998, u ratifikua më 4/04/2000 dhe hyri në fuqi më 1/08/2000, Ligji Nr. 8548, datë 11/11/1999 “Për Ratifikimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore

Decentralizimit dhe Grupi i Ekspertëve të Decentralizimit. Hapi i parë i kësaj strategjie ishte ndërrimi i bazës ligjore që filloi me Ligjin Organik 8652/2000 “Për Organizimin dhe Funksionim e Qeverisjes Vendore”, po kështu u miratuar edhe Ligji Nr.8653 “Për ndarjen Administrativo-Territoriale”.

3.2.4. Zhvillimi i Bazës Ligjore dhe Institucionet

Menjëherë pas miratimit të Ligjit Organik i cili shërben si bazë për të vendosur ligjet sektoriale dhe paketën për të mbështetur të drejtat, funksionet, institucionet dhe financat vendore filloi plotësimi i kuadrit ligjor për qeverisjen vendore në Shqipëri. Zgjedhjet e para pas miratimit të ligjit u bënë në shtator 2000 dhe ligji hyri në fuqi me 1 janar 2001. Nga këto zgjedhje dolën njësitë vendore të nivelit të parë (bashkitë dhe komunat) si dhe ato të nivelit të dytë (qarqet). Ndonëse në ligj nuk kishte ndryshim në kompetencat e bashkive dhe komunave në vitet që pasuan, kjo simetri ligjore u kthye në asimetri zbatuese. Kryesisht për mungesë kapacitetesh dhe burimesh njerëzore atyre nuk ju transferuan apo deleguan funksione që me ligj quheshin funksione të veta. Roli i qarkut në gjithë trajektoren e tij, pavarësisht përpjekjes për të luajtur një rol institucional në koordinimin e planifikimit strategjik rajonal, përsëri ngeli modest. Ligji nuk përvijonte qartë as detyrat e funksionet as mënyrën e financimit të tij, për pasojë roli i tij i ngjan një “Kutie boshe”⁵⁷.

3.2.4.1. Ligji Organik (Strukturat, Funksionet, Financat)

Kushtetuta dhe parimet e Kartës Evropiane mbështeten nga Ligji Organik i Qeverisjes Vendore (8652/2000) dhe ligjet themelore që përcaktojnë më tej sistemin e qeverisjes vendore. Këto janë të theksuara në paragrafët e mëposhtëm.

Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore

Ligji nr. 8652/2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore" është baza ligjore ku mbështetet e gjithë veprimtaria kryesore për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcaktimin e kompetencave të funksioneve dhe shpenzimeve si dhe trupat përbërës së bashku me fuqinë apo dimensionin fiskal të këtij niveli qeverisës.

Parime themelore

Neni 4 i Ligjit Organik specifikon disa parime themelore për funksionimin e njësive të qeverisjes vendore (NJQV):

- a) Organet e njësive të qeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore.
- b) Marrëdhëniet ndërmjet organeve të njësive të qeverisjes vendore dhe marrëdhëniet e tyre me organet e pushtetit qendror bazohen në parimin e subsidiaritetit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Funksionet për shpenzime

Përgjegjësitë funksionale të NJQV-ve jepen në paragrafët e Nenit 12 të ligjit organik të pushtetit vendor në të cilat përcaktohet marrëdhënia mes dy niveleve të qeverisjes:

- a) Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë komunën, bashkinë ose qarkun të kryejnë funksione të caktuara të institucioneve qendrore, duke përcaktuar procedurat e kryerjes dhe të kontrollit për zbatimin e tyre.
- b) Institucionet qendrore mund të autorizojnë komunën, bashkinë dhe qarkun të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar
- c) Komunës, bashkisë ose qarkut, mund t'u delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së qeverisjes

vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.

- d) Në çdo rast institucionet qendrore u garantojnë njësive të qeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Sipas Ligjit Organik bashkitë/komunat ushtrojnë këto funksione:

- a. Funksionet ekskluzive janë funksionet e dhëna me ligj njësisë, për realizimin e të cilave ajo është përgjegjëse dhe ka autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për realizimin e tyre, brenda normave, kritereve dhe standardeve të pranuar përgjithësisht me ligj. NJQV-ja do të ushtrojë autoritet të plotë administrativ, shërbimi, investimi dhe rregullimi mbi këto funksione.
- b. Funksionet e përbashkëta janë funksione për të cilat njësia vendore ka pjesën e saj të përgjegjësisë, që dallohet nga pjesa e përgjegjësisë së dhënë pushtetit qendror. Këto funksione janë të shoqëruara përpjesëtimisht me kompetenca, të cilat ushtrohen në mënyrë të pavarur.
- c. Funksionet e deleguara janë funksione të pushtetit qendror ose institucioneve të saj, që me ligj ose me një marrëveshje kontraktuale në mes të qeverisë qendrore dhe NJQV-së i caktohen një njësie vendore.

Funksioni i të ardhurave

Autoriteti bazë për NJQV-të për të ushtruar kompetencat e tyre fiskale dhe financiare jepet në Kreun III, Neni 8/1/III, e drejta e mbledhjes së të ardhurave dhe e bërjes së shpenzimeve:

- a. Krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre.
- b. Vendosin taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë.
- c. Hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre

Tiparet kryesore të financave vendore jepen në Nenin 15, Parimet e financimit të njësive të qeverisjes vendore, të cilat janë:

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë funksionimin e njësive të qeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve e të ardhurave.
2. Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga pushteti qendror dhe fondet që u vijnë atyre drejtpërdrejtë nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare.
3. Njësive të qeverisjes vendore u garantohet me ligj autoritet i mjaftueshëm për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
4. Pushteti qendror u jep njësive të qeverisjes vendore fonde për përmbushjen e të gjitha standardeve dhe kërkesave që ai vendos për funksionet dhe kompetencat e deleguara.

3.2.4.2. Ligje të tjera bazë që afektojnë qeverisjen vendore

Përveç Kushtetutës dhe ligjit organik ka një numër ligjesh të tjera që mbështesin karakteristikat themelore të sistemit të qeverisjes vendore. Këto përfshijnë si më poshtë vijon:

Ligji për “*Ndarjen Administrative dhe Territoriale*”, Një ligj i rëndësishëm dhe mbështetës është Ligji Nr. 8653, datë 31.7.2000 “Për Ndarjen Territoriale dhe Administrative të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj nuk jep një përshkrim tregues, por ka futur njësitë administrative të tilla si rajone, bashki, komuna dhe fshatra, në të dy nivelet e qeverisjes në Shqipëri.

Ligji nr.8744, datë 22.02.2001 “*Për Transferimin e Pronave të Paluajtshme Publike të Shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*” i përditësuar me: *Ligjin Nr. 9561, datë 12.6.2006 dhe Ligjin Nr. 9797, datë 23.7.2007* është një ligj i rëndësishëm që i hap rrugën identifikimit, inventarizimit, transferimit dhe regjistrimit të pronave publike vendore që i kalojnë në administrim qeverisjes vendore. Ky proces ka qenë mjaft i ngadaltë.

Ligji nr.9663/2006 “Për Koncesionet” i përditësuar (2013). Bashkë me VKM nr.27 datë 19.01.2007 ai përcakton kuadrin e nevojshëm për promovimin dhe lehtësimin e projekteve me koncesione, të financuara nga sektori privat (Partneriteti i Sektorit Publik-Privat).

Ligji nr.8405 “Për Urbanistikën” (1998)

Ligji nr.10 137 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (2009)

Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Për këtë ligj, 107/2014, po ndalem në dy pikat e qëllimit të tij pasi kanë lidhje me rolin e qeverisjes vendore në zhvillimin ekonomik dhe të territorit.

1. të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
2. nxitjen e zhvillimit të balancuar rajonal, për të siguruar shpërndarje të qëndrueshme të popullsisë në vend në bazë të burimeve;

Kjo temë e trajtuar më sipër në pabarazitë e zhvillimit vendor e rajonal në Shqipëri tregoi më së miri se një qasje e tillë i ka munguar legjislacionit në Shqipëri. Kuadrit ligjor i mungon edhe një ligj për qarqet, apo një sqarim apo edhe rishikim i funksioneve dhe financimeve për to. Kjo mund të jetë e arsyeshme në mungesë të një konsensusi politik për të reformuar tërësisht këtë nivel qeverisës. Nevoja për një reforme më të thellë që do përfshijë dhe qarqet, është identifikuar si një nga zonat kryesore për përmirësimin e mëtejshëm të situatës së decentralizimit në Shqipëri.⁵⁸

Këto ligje dhe akte të tjera nënligjore përcaktojnë bazën ligjore të qeverisjes vendore dhe ishin pjesë e implementimit të planit të veprimit të strategjisë së decentralizimit (1999) me qëllim përmbushjen e kuadrit ligjor institucional dhe financiar të njësive vendore.

3.2.4.3. Kuadri Ligjor për Decentralizimin Fiskal

Temat e konsolidimit financiar të qeverisjes vendore kanë qenë shpesh pjesë e debateve politike mes krahëve të ndryshëm të saj ose e debateve mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Gjithsesi kuadri ligjor për burimet financiare të qeverisjes vendore ka ndjekur në vija të përgjithshme kuadrin ligjor bazë që është hartuar dhe miratuar gjatë dekadës së fundit dhe që përcaktonte transferimin e kompetencave dhe funksioneve tek njësitë vendore.⁵⁹ Pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim shpesh nga raportet e institucioneve ndërkombëtare mandatet e qeverisjeve vendore janë quajtur mandate të pa financuara. (në kapitujt më poshtë do ndalemi më hollësisht).

Ligji për Burimet Financiare. Ligji Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” është ligji vendimtar për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor. Ky ligj

përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor. Ligji për Sistemin Buxhetor në Republikën e Shqipërisë nr.9936, datë 26.06.2008 është një nga ligjet më të rëndësishme në kuadrin ligjor të çështjeve vendore financiare dhe administrative. Ky ligj rregullon sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë, strukturën, parimet dhe themelet e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare ndërqeveritare dhe përgjegjësitë për zbatimin e të gjithë legjislacionit buxhetor. Neni 6 siguron bazën për buxhetet vendore me dispozitat e mëposhtme:

Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e njësisë së qeverisjes vendore. Buxheti vendor është i balancuar, përveç rasteve kur merret hua për financimin e projekteve të investimeve. Buxheti vendor është i balancuar në termat e arkëtimit dhe të pagesave.

Ligji për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore. Ligji Nr. 9869, datë 2008/04/02 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, rregullon kushtet mbi të cilat qeveritë vendore mund të marrin borxh dhe përcakton edhe çështjet e lidhura me to. Ky ligj synon zgjerimin e autonomisë vendore përmes rregullimit të huamarrjes së qeverisjes vendore dhe krijimin e mundësive të përshtatshme si dhe ofron rregullat për të siguruar një proces transparent të huamarrjes në përputhje me politikat e zhvillimit të përgjithshëm dhe që siguron stabilitetin makroekonomik dhe besueshmërinë e institucioneve publike në tregjet financiare.

Edhe pse ligji i plotë për Financat e Qeverisjes Vendore është hartuar që në vitin 2008, ai nuk është miratuar apo marrë në konsideratë. Në Strategjinë e Decentralizimit (2015-2020) është parashikuar që ky ligj të miratohet në qershor 2016. Parimet që bëjnë të

mundur pasjen e një ligji të tillë me gjithë prerogativat janë parashikuar në ligjin e ri për vetëqeverisjen vendore Ligji Nr.139/2015 date 17.12.2015 ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’.

Ky kuadër ligjor për financat vendore ka ofruar si më poshtë:

- Përkufizimin e termave kryesore të buxhetit dhe të financave.
- Rregullat/metodat/mënyrat për sigurimin e transparencës dhe integritetit të financave publike vendore.
- Rregullat për taksat e veçanta kombëtare, përfshirë këtu taksat specifike që duhet të ndahen, përqindja që i kalon pushtetit vendor dhe procedurat për transferimin e fondeve në financat vendore.
- Rregullat për transfertat e pakushtëzuara, përfshirë këtu parimet dhe formulën për llogaritjen dhe ndarjen e tyre.
- Rregullat për huamarrjen e qeverisjes vendore.

Pronat publike vendore janë një instrument i fuqishëm në zhvillimin ekonomik. Një nga reformat më të rëndësishme në kuadër të procesit të decentralizimit ka qenë transferimi i pronave shtetërore tek qeverisja vendore. Pavarësisht që menjëherë pas Ligjit Organik u aprovua në shkurt 200 Ligji ‘Për Inventarizimin, Transferimin dhe Regjistrimin e Pronave Publike pranë Njësive Vendore’, procesi ka ecur shumë avash. Situata është e bllokuar aktualisht. Procesi i inventarizimit ka përfunduar për 373 njësi të qeverisjes vendore. Janë miratuar për 265 njësi të qeverisjes vendore listat paraprake të transferimit, dhe ka përfunduar miratimi përfundimtar i listave të transferuara në pronësi/përdorim njësive të qeverisjes vendore për 166 njësi të qeverisjes vendore.

Mangësi ky proces ka në lidhje me regjistrimin e pronave në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) për shkak të tarifave të regjistrimit, mungesës së

dokumentacionit hartografik, mungesës së pasqyrimin të përmasave reale të pronës, pasi shpesh here përmasat e pronave janë marrë nga çka ka figuruar në dokumentacione dhe jo nga çka konstatohet nga gjendja faktike. Mund të themi që procedurat e regjistrimit në ZRPP i ka përfunduar vetëm Bashkia Gramsh me mbështetjen e projekteve të USAID-it. Por njësitë e qeverisjes vendore kanë proceduar me regjistrimin për ato prona që ka interes vendor për investime. Gjendja e inventarizimit të tokës bujqësore nuk është reale siç është në terren. Ndërkohë nuk janë zbritur sipërfaqet e tokave bujqësore mbi të cilat ka vepruar Ligji 7501. Toka bujqësore është inventarizuar në përgjithësi si klasa në tërësi në nivel fshati dhe komune.

Procesi i transferimit të pyjeve kullotave u shkëput nga procesi në tërësi. Është transferuar përrreth 300 njësi të qeverisjes vendore, por regjistrimi i tyre megjithëse iu hoq tarifa me vendim të këshillit të ministrave, nuk ka përfunduar. Problematika tashmë s'kishte lidhje me tarifën e regjistrimit, por më paraqitjen hartografike. Gjithashtu mangësia e ndarjes territoriale administrative mes njësive të qeverisjes vendore e pashoqëruar me harta, në jo pak raste, ka sjell konfuzion dhe konflikte mes njësive të qeverisjes vendore, i theksuar sidomos në ato prona ku interesi dhe gjenerimi i të ardhurave vendore ka qenë i madh.

3.3. DECENTRALIZIMI FISKAL NË SHQIPËRI

Financat vendore në Shqipëri kanë patur një rritje domethënëse në krahasim me stadin ku është nisur në vitin 2001. Gjithsesi gjatë kësaj kohe ka patur dhe ulje e ngritje, ecje para por edhe ngelje në vend, në mos hapa mbrapa. Një arritje e rëndësishme është rritja e të ardhurave nga burimet e veta të qeverisjes vendore në vitet e para, por ndryshimet në kompetencat e pushtetit vendor për të përcaktuar nivelin e taksave për tatimin mbi

biznesin e vogël në prill 2009¹⁴ si dhe rënie e transfertave ndërqeveritare gjatë viteve 2012-2013 e kanë ndryshuar këtë tendencë të rritjes (*do i shohim me paraqitje grafike me vonë*). Përveç kësaj, miratimi i një ligji për huamarrjen vendore kishte potencialin për të përmirësuar mundësinë për investime kapitale të mëdha me qëllim përmirësimin e ambientit të biznesit, kryesisht atij të vogël e të mesëm dhe qeveritë vendore ishin të etura për ta shfrytëzuar këtë mundësi. Por urdhrat administrative që pasuan e kufizuan së tepërmi këtë mundësi, si dhe shumën e huamarrjes që qeveritë vendore do të kenë mundësi të marrin. Në gjithë vendin, që nga viti 2008 kur doli Ligji për Huamarrjen Vendore e deri sot, vetëm 6 njësi vendore nga 385 kanë marrë kredi dhe stoku i borxhit i qeverisjes vendore në vitin 2014 zë vetëm 0.06% e Borxhit Publik¹⁵. (*do trajtohet me vete*).

Tabela III.1:

Stoku i Borxhit Publik

Stoku i Borxhit të Qeverisë Qëndrore dhe Pushtetit Lokal Central and Local Government Debt Stock							
(miliona lekë)	2009	2010	2011	2012	2013	2014	(miliona ALL)
Borxhi Publik	682,547	715,517	772,735	828,268	885,083	977,957	Public Debt Stock
- Borxhi i Qeverisë Qëndrore	682,547	715,370	772,517	827,981	884,692	977,102	Central Government Debt Stock
- Borxhi i pushtetit lokal	-	147	218	288	391	855	Local Government Debt Stock
PBB*	1,143,936	1,239,645	1,300,624	1,335,488	1,364,782	1,413,931	GDP*
Stoku borxhit publik/PBB	59.67%	57.72%	59.41%	62.02%	64.85%	69.17%	Public Debt Stock/GDP
Stoku borxhit Qeverisë qendrore/PBB	59.67%	57.71%	59.40%	62.00%	64.82%	69.11%	Central Government Debt Stock/GDP
Stoku borxhit lokal/PBB	-	0.01%	0.02%	0.02%	0.03%	0.06%	Local Government Debt Stock/GDP

*PBB mbi baza vjetore/ Annual GDP

**Nuk përfshihen detyrimet e prapambetura të Qeverisë/Government arrears are not included

Burimi: Ministria e Financave

3.3.1. Instrumentet financiar të qeverisjes vendore

Të ardhurat vendore në Shqipëri përbëhen kryesisht nga i) të ardhurat e veta; ii) transfertat ndërqeveritare që ndahen në a) Granti i Pakushtëzuar dhe b) Granti i Kushtëzuar.


Të ardhurat e dhëna në grafikun III.1 prezantojnë strukturën e të ardhurave. Në këtë figurë dallohet qartë që këto të ardhura kanë qenë më të larta në vitin 2009 dhe më pas

¹⁴ Ligjin Nr. 10 117, datë 23.4.2009 “Për Sistemin e Taksave Vendore”

¹⁵ Faqja web e Minisrisë së Financave

ka filluar rënia e tyre, gjë që do ta shpjegojmë më poshtë. Rritja e financimeve në qeverisjen vendore në prag fushatash elektorale është e dukshme në grafik. Kjo situatë ka vazhduar në vitin 2014 ku të ardhurat e veta kanë qenë 14,6 miliard lek, Granti i pakushtëzuar 12,47 dhe Granti i kushtëzuar 5,57 miliardë lek.¹⁶


Grafiku III.1: Përbërja bazë e të ardhurave vendore (me qarqe) në miliardë lekë



Burimi: PLGP/USAID

Ajo që vihet re është që, vitet e fundit kemi një tendence në rritje të financimeve të qeverisjes vendore në total (pas vitit 2013), por kjo ka ardhur kryesisht nga rritja e Grantit të Kushtëzuar, Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR). Një situatë e tillë pavarësisht se në vlerë absolute prezanton rritje të të ardhurat vendore relativisht cenon shkallën e autonomisë fiskale. Paraqitja e kësaj situatë në % të tipit të financimeve në raport me totalin jepet në grafikun më poshtë (Grafiku III.2).

¹⁶ Të dhënat e Ministrisë së Financave në bazë të raportimeve në web.

Grafiku III.2: Përbërja bazë e të ardhurave vendore (me qarqe) në %

Burimi: PLGP/USAID


Është tejet e vështirë në vendet në zhvillim të përcaktohet me saktësi shuma e financimit që iu duhet NJQV-ve për të ofruar shërbimet e caktuara me ligj. Kjo ndodh për disa arsye, por më e rëndësishmja është se në shumë vende ne kemi shumë pak të dhëna mbi koston e tyre, e akoma më pak për kostot për njësi sipas disa standardeve të arsyeshme të shërbimit. Kjo bën tepër të vështirë sasinë e parave të nevojshme. Por në analiza krahasuese ne mund të përcaktojmë ide dhe indikator bazë¹⁷. (PLGP/USAID. 2015)⁶⁰.

Ndonëse matja e nevojave për shpenzime të NJQV-ve është e vështirë. Ajo që duket qartë është fakti se bashkitë në Shqipëri janë të keq financuara. Kjo evidentohet në Grafikon III.3, ku tregohen të ardhurat e qeverisjes vendore si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe ndaj totalit e të ardhurave publike për pjesën më të madhe të vendeve të rajonit. Siç mund të shihet edhe në figurë, të ardhurat e qeverisë vendore në Shqipëri janë rreth 2.2% e PBB-së ose diçka më shumë se 9% e totalit e të ardhurave publike. Këto shifra janë më të ulëtat për të gjitha vendet e paraqitura në figurë.

¹⁷ Në fakt, shumë nga këto vështirësi ende vazhdojnë në vendet e zhvilluara. Shih : J. Kim dhe J. Lotz, Measuring Local Government Needs (Matja e nevojave të pushtetit vendor), Instituti Korean i Financave Publike dhe Ministria e Mirëqenies Sociale e Danimarkës, 2007 (PLGP/USAID)

Sigurisht që shërbimet që ofrohen nga qeverisja vendore sipas dispozitave ligjore nuk janë të njëjta në të gjitha vendet. Për shembull, në vendet e shënuara me yll, bashkitë mbulojnë edhe pagat e mësuesve. Në vende të tjera, si Kosova, njësitë vendore janë përgjegjëse edhe për pagat e mjekëve të shërbimit shëndetësor parësor. Gjithsesi, njësitë vendore në Shqipëri marrin më pak fonde se homologet e tyre në Bosnje-Hercegovinë, Slloveni, Turqi, Serbi, Mali i Zi dhe Kroaci, pavarësisht faktit se kryejnë të njëjtat funksione bazë. Shqipëria në krahasim me vendet e Evropës Juglindore të rajonit ka të ardhurat më të vogla si % e PPB po ashtu edhe si % e të ardhurave kombëtare.

Grafik III.3: Të ardhurat e pushtetit vendor si % e PPB-së dhe totalit e të ardhurave publike në 2014: Shqipëria në krahasim me vendet e tjera në rajon



Burimi: NALAS, 2014, Treguesit e decentralizimit fiskal për Evropën Juglindore, 2006-2014 (që këtu e më poshtë do të referohet si NALAS 2014) MF, (PLGP/USAID)

Në Grafikun III.2, shikohet tendenca e rritjes së Grantit të Kushtëzuar në raport me dy burimet e tjera të financimit. Nuk është ndonjë gabim i madh financimi i njësive vendore me grante të kushtëzuara, por një gjë e tillë në eksperiencën ndërkombëtare është jashtëzakonisht e rrallë, përveçse në rastet kur transfertat e kushtëzuara përdoren për funksionet p.sh. si arsimi, që gjithsesi nuk është rasti i Shqipërisë. Një gjë e tillë konsiderohet si praktikë e keqe, pasi bën që zyrtarët vendor të bëhen vulnerabil ndaj atyre qendrorë.

Përveç kësaj ky lloj financimi bën që zyrtarët qendrorë të harxhojnë më shumë energji për t'u marrë me punë vendore e për të marrë vendime për infrastrukturë vendore se sa të merren me politika qendrore fiskale e zhvillimore. Tjetër është se një mënyrë e tillë financimi dhe sjelljeje i mohon të drejtën drejtuesve vendor të kenë burime të pavarura financimi në mënyrë që t'i përgjigjen pritshmërisë të elektoratit të tyre, pritshmëri që ato i dinë më mirë se zyrtarët qendrorë.

3.3.1.1. Të Ardhurat nga Burimet e Veta (Taksa dhe Tarifa Vendore)

Në të ardhurat e kësaj natyre futen të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, si dhe të ardhurat nga ato jo tatimore të njësive vendore. Mënyra për të rritur të ardhurat vendore është të rriten kompetencat e NJQV-ve për të siguruar të ardhura në mënyrë të pavarur. Në fakt, ky është një komponent i nevojshëm në çdo strategji afatgjate për përmirësimin e financave vendore. Nisur nga kjo strukturë qeverisja vendore ka bërë një punë të konsiderueshme përveç komunave të cilat, me pak përjashtime, kanë pasur efekt mjaft të dobët. Gjithsesi kjo analizë nuk është objekt i këtij punimi.

Një nga arritjet më të rëndësishme të qeverisjes vendore ka qenë rritja e të ardhurave të veta sidomos duke filluar nga viti 2002, vit që u transferuan kompetenca për vendosje të taksave dhe të tarifave në nivel vendor. Taksat dhe tatimet vendore vendosen me Ligjin “Për Sistemin e Taksave Vendore” në Republikën e Shqipërisë (2006) ku njësitë vendore (këshillat bashkiak) fituan dhe të drejtën e një lirie veprimi në vendosjen e taksave vendore në nivelin $\pm 30\%$ të vlerës bazë. Kjo e drejtë u cenua në vitin 2009 $(+10, -30\%)^{18}$ me ndryshimet e këtij ligji, por u rivendos me buxhetin e vitit 2014. Po

¹⁸ Në të njëjtën kohë, qeveria i bëri ndryshime mjaft problematike ligjit mbi taksat vendore i cili i caktoi një tavan prej 10% të taksës maksimale të lejueshme për bizneset e vogla të gjitha taksave dhe tarifave të tjera. Kjo do të thotë që nëse TBV-ja maksimale e lejueshme për një firmë të caktuar është 20,000 lekë, atëherë totali i shumës së të gjitha “taksave” – si ato për Ndërtimin, Tokën Bujqësore, Përdorimin e Hapësirës Publike, apo për Tabelat Reklamuese, si dhe për “tarifat” si Pastrimi, Gjelbërimi apo Ndriçimi

kështu, një hap domethënës ka qenë kalimi i administrimit të taksës së biznesit të vogël tek qeverisja vendore (2006). Në atë vit kemi rritje e të ardhurave nga biznesi i vogël si rezultat i një pune dhe mundësie informacioni më të saktë dhe të një interesi direkt, çka çoi edhe në ulje të informalitetit. Në tabelën III.2 (të dhënat e Ministrisë së Financave) kemi ndikim me rritje kur kjo taksë kaloi në qeverisjen vendore.

Tabela.III.2: Rritja në të Ardhura nga TBV-ja në periudhën 2007 - 2008

NJ.Q.V	Rritja
Durrës	43%
Elbasan	38%
Bushat*	35%
Berat	34%
Pogradec	31%
Lushnje	22%
Korçë	21%
Kamza	20%
Shkodër	17%
Fier	12%

Burimi: PLGP/USAID (Të dhënat e MF-së, përlllogaritjet nga vetë autori;

**rritja për Bushatin është përlllogaritur për periudhën 2007 – 2009)*

Të ardhurat e veta u rritën në mënyrë të qëndrueshme në vitet 2002-2008 dhe vazhdimisht kanë qenë burimi i vetëm më i madh i të ardhurave vendore. Gjithsesi, në 2008, vlera absolute e të ardhurave të veta vendore filloi të zbehej kur qeveria qendrore vendosi kufizime të ndryshme për taksën e biznesit të vogël si dhe për tarifa e taksa të tjera vendore duke bërë ndryshime ligjore në ligjin ‘Për Sistemin e Taksave Vendore’. Ajo uli numrin e kompetencave të NJQV-ve,¹⁹ një politikë që vazhdoi në 2014 me


Publik nuk mund të jenë më shumë se 2,000 lekë në vit. Nga një pikëpamje e sistemit, këto ndryshime e bënë edhe më të paqartë dallimin tashmë të turbullt mes tarifave dhe taksave në ligjin shqiptar. Ato gjithashtu kufizuan pavarësinë fiskale të njësive të qeverisjes vendore. Shiko Levitas (2010).

¹⁸ Ligji 10418/Prill 2011 aplikohet për tërë taksat e papaguara të TBV-së deri në 31 dhjetor të vitit 2010.

¹⁹ Shih Tony Levitas, *Taksat e qeverisjes vendore, Tarifat në Shqipëri: Sfidat aktuale dhe të ardhshme* (Raport për Shoqatën e Komunave të Shqipërisë dhe Shoqatës Suedeze të Autoriteteve Vendore) shtator, 2010, fq. 1-31


shndërrimin e taksës së biznesit të vogël (TBV) në taksë të thjeshtësuar mbi fitimin që mbledhë nga qeveria qendrore, e cila i kthen NJQV-ve tanimë një sasi mjaft të vogël nga kjo taksë si rezultat i mos përforsimit nga strukturat rajonale te drejtorisë së tatimeve. Me poshtë për ilustrim janë dy grafike që japin strukturën e të ardhurave vendore.

Grafik III.4: Përbërja e të ardhurave të veta të QV-ve (2003-2014) Në miliard lek



Burimi: PLGP/USAID

Grafik III.5: Përbërja e të ardhurave të veta të QV-ve si % (2003-2014)




Burimi: PLGP/USAID

Por më pas ndryshimet në kompetencat e pushtetit vendor për të administruar taksën e biznesit të vogël e kanë ndryshuar këtë tendencë të rritjes (Grafiku III.6). Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin (ose taksa e biznesit të vogël) me kalimin e viteve u bë nga 3% në 1.5% dhe aktualisht është zero.

Siç shikohet nga grafiku ndërhyrjet e qeverisë për të ndryshuar nivelin e taksimit të biznesit të vogël, si dhe për të vendosur kufij maksimal +10% mbi taksën nominale dhe kufij maksimal mbi tarifat dhe taksat e tjera që do i kalonin qeverisjes vendore, solli vështirësi financiare në qeverisjen vendore. Pavarësisht se mandatet vendore quheshin të pa financuara, ato sërish u goditën me politika fiskale të pakuptimta në kundërshtim me interesat e tyre. Pas vitit 2012 dhe më tej në vitin 2014 tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël u bë zero dhe boshllëku i saj u pranua nga qeveria se do kompensohej, por sipas treguesve një gjë e tillë nuk ndodhi në masën e duhur.

Grafiku III.6: Taksa e Biznesit të Vogël (2010-2014)

000 L



Burimi: Ministria e Financave; llogaritjet e veta.

Tarifa është një detyrim për një shërbim të marrë. Si e tillë ajo duhet të llogaritet për të mbuluar kostot. Në analizën e bërë nga Banka Botërore vite më parë (2004) situata është e njëjtë. Ekspertët e BB shprehen për shërbimet se është e pamundur të shihet nëse ato janë efikase dhe eficientë pasi nuk ka një standard për t'iu referuar. Për pasojë meqë nuk ka një standard nuk ka as kosto për njësi e për pasojë llogaritja e tarifave në Shqipëri bëhet mbi bazë të faktit të koston së shërbimit duke e ndarë detyrimin për familje apo për biznese si tarifë e shërbimit. (World Bank. 2004)

Pavarësisht, tarifat janë larg mbulimit të kostove për shumë arsye, por ato përmbledhen si mungesë e vullnetit politik për të njehsuar kostot me tarifat dhe për administrim të dobët të procesit të mbledhjes së saj. Taksa e pastrimit që është tarifa më madhe zë 11% e të ardhurave të veta në vitin 2013. Ndërsa janë edhe tarifa të tjera më të vogla, si e ndriçimit, e gjelbërimit, etj.


Një problem që vlen të theksohet është edhe taksa mbi pasurinë e cila në vendin tonë është mjaft e ulët në krahasim edhe me vendet e tjera të rajonit. Në vitin 2012 të ardhurat nga taksa e pasurisë zinin vetëm 0.18% e PBB.

Projekti i Bankës Botërore për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës (Projekti LAMP)⁶¹, që sipas planit origjinal do të përfundonte në qershor 2013, është shtyrë deri në një afat tjetër. Projekti ka pësuar një ristrukturim në janar 2011 dhe objektivi fillestar prej 500,000 pronave u reduktua në 400,000. Deri në dhjetor 2012 u dhanë vetëm

77.000 tituj pronësie në zonat urbane dhe rurale. Aktualisht janë të regjistruara 85% e tokës në fshat sipas ligjit 7501 dhe vetëm 23% e pronave në qytet.²⁰

Pavarësisht rezervave, Grafiku III.7 tregon se nuk duhet pritur shumë nga kjo taksë. Vetëm Mali i Zi, nga vendet e rajonit, i cili rrit të ardhurat si rezultat i infrastrukturës turistike ka rezultat të lartë në raport me vendet e tjera. Vendet e BE-së kanë të ardhura modeste nga kjo taksë, maksimumi 1.2% e PBB-së. Duke patur parasysh problematikën me regjistrimin e pronave, për një të ardhme jo të afërt, të ardhurat do jenë akoma modeste dhe nuk do përmbushin nevojën për financime të njësive vendore.

Grafiku III.7: Taksa e pasurisë si % e PBB dhe si % e te ardhurave në Evropën Juglindore Vendore (2006, 2014)



Burimi: PLGP/USAID


²⁰ Informacioni nga rakordimet e projektit te PLGP/USAID me Zyren Qendrore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme ne kuader te informatizimit te pasurive te paluajtshme te njësive partnere te projektit.

3.3.1.2. Transfertat Ndërqeveritare

Gjatë viteve 2007-2010, shuma e granteve të kushtëzuara në sistem u rrit me më shumë se dyfish, duke rritur raportin ndaj të ardhurave totale nga rreth 10% në rreth 15-20%. Gjithsesi, në vitin 2011 vlera e granteve të kushtëzuara u përgjysmua, duke ulur kështu raportin ndaj totalit e të ardhurave dhe duke rezultuar në një rënie të madhe e të ardhurave vendore nga rreth 30 në 25 miliardë lekë. Së fundi, vlera e Grantit të Pakushtëzuar arriti në 11.7 miliardë lekë në vitin 2009 para se të binte me rreth 10% në vitet e mëvonshme. Gjithsesi, Granti i Pakushtëzuar vazhdon ende të përbëjë rreth 35 dhe 40% të totalit e të ardhurave të qeverisë vendore. Siç shihet nga Grafiku.III.8 politikat e nivelit qendror që ndryshojnë vazhdimisht në lidhje me të tre kategoritë e mëdha e të ardhurave të qeverisjes vendore nuk kanë ndihmuar në përmirësimin e buxhetit vendor dhe kanë penguar në veçanti planifikim racional të investimeve.

Në intervalin e viteve 2010 – 2014 vërejmë një tendence uljeje që i përket viteve 2010-2012 dhe një ngritje 2013-2014 të grantit të pakushtëzuar dhe të kushtëzuar. Por ajo që bie në sy është tendenca për rritjen e grantit të kushtëzuar me një koeficient më të lartë se ai i pakushtëzuar; për pasojë kemi edhe cenimin e autonomisë fiskale sipas Indikatorit të Autonomisë (Akai & Sakata), të cilët këtë indikator e përcaktonin me raportin e të ardhurave të veta plus granteve të pakushtëzuara me ato të kushtëzuara apo me të ardhurat e konsoliduara publike.²¹

²¹ Indikatorit I Autonomise fiskale tregon shkallen e autonomise se vendimarrjes për shpenzime, % e parashikueshmerise se fondeve. Perqindja me e larte e ketij indikatorit tregon qe sasia e fondeve qe vijne nga te ardhurat e veta është me e larte ne raport me totalin e te ardhurave.

Grafiku III.8: Transfertat qeveritare (2010-2014)


	2010	2011	2012	2013	2014
Grant i Pakushtëzuar	10,214,692	9,762,712	8,756,561	10,453,171	11,474,557
Grant i Kushtëzuar	26,152,765	23,854,459	23,199,329	25,679,736	29,121,361

Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e Mia

Me sa shikohet më sipër, në Grafikon III.3, si me sasinë apo me % e totalit e të ardhurave vendore në raport me PBB-në, si dhe në % në raport me të ardhurat e konsoliduara publike, me transfertat e pakushtëzuara apo të kushtëzuara, po kështu edhe me nivelin e huamarrjes vendore që është e papërfillshme për vetëm 0.06% e borxhit të konsoliduar publik (Grafiku II.10) qeverisja vendore e ka tepër të vështirë, në mos të pamundur, të luaj një rol domethënës për të financuar funksionet e veta publike apo për të luajtur rol domethënës në zhvillimin vendor.

Kohet e fundit qeveria ka bërë një luftë kundër informalitetit dhe për pasojë ka një tendence rritje e të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat. Por, pavarësisht kësaj tendence rritjeje nga të ardhurat nga doganat e tatimet si % e PBB-së, serish transfertat vijnë duke rënë (Grafiku III.9).

Grafiku III.9: Të ardhurat e NJQV-ve si % e të ardhurave kombëtare nga tatimet dhe doganat dhe PBB-së



Burimi: Treguesit e konsoliduar fiskalë të MF, PLGP/USAID llogaritjet e mia²².

Fatkeqësisht, ndryshimet në politikën fiskale kombëtare janë shoqëruar me gërryerjen e dy burimeve më të rëndësishme e të ardhurave vendore: nga njëra anë, Qeveria qendrore në mënyrë progresive ka kufizuar bazën e taksës së biznesit të vogël para se të rimernte plotësisht nën kontroll administrimin e saj në vitin 2014. Nga ana tjetër, që nga 2006 deri në vitin 2014, Qeveria qendrore ka ulur fondin e transfertës së pakushtëzuar me rreth 17%.

Përveç kësaj situate, ndarjes së granteve nuk i shpëton ndarja e tyre nën influencën e përkatësisë politike gjë që e kemi prezantuar më sipër. Një gjë tillë përveç se e bën skemën jo transparente, të pabarabartë dhe të paparashikueshme, bën edhe që të humbte kuptimi i Formulës së Grantit të Pakushtëzuar e cila ka kritere pothuaj te sakta për të siguruar paanësinë e cila përmbysset me ndarjen e granteve të kushtëzuara. Pavarësisht se formula sesi ndahet granti i pakushtëzuar mes njësive vendore vërejmë që ka lidhje me balancimin horizontal, problem ngelet sasia e grantit në total, në raport me PBB-në

²² Në këtë figurë, transfertat e kushtëzuara për konviktet dhe qendrat e shërbimit social që janë kaluar te transfertat e pakushtëzuar në vitet e fundit janë përfshirë në total.

apo me të ardhurat e konsoliduara publike. Siç dhe treguam në Grafikon III.3, financat vendore Shqipëria i ka më të ulëta se gjithë vendet e SEE-së.

3.3.1.3. Taksat e Ndara


Përdorimi i taksave të përbashkëta, siç evidentohet në Dokumentin Studimor të PLGP/USAID⁶², është një prej mënyrave kryesore për rritjen e burimeve financiare të qeverisjes vendore. Kjo është e domosdoshme përderisa për arsye objektive dhe subjektive taksa e pasurisë është në nivele minimale krahasuar kjo edhe me vendet e rajonit dhe jo vetëm. Ndonëse ekziston dispozitë për ndarjen e tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) dhe tatimit mbi fitimin sipas kuadrit ligjor ekzistues (Ligjin Organik), kjo nuk është bërë.

Shqipëria, me Bullgarinë si dhe me Kosovën janë vendet në rajonin e Evropës Juglindore që nuk përdorin konceptin e ndarjes së tatimit mbi të ardhurat personale⁶³. Aktualisht si taksë e ndarë ekziston vetëm taksa e regjistrimit vjetor të automjeteve ku qeverisja vendore merr vetëm 18% të saj. Vendosja e taksave të ndara në skemën e financimit të njësive vendore do bënte të mundur rritjen e rolit dhe performancës së tyre për të ofruar shërbime më cilësore dhe për të ndërtuar e ekzekutuar plane të investimeve kapitale për pasojë për të luajtur rol në zhvillimin ekonomik vendor. Kjo mbitaksë do t'i mundësonte NJQV-ve të kenë autoritetin e tyre tatimor dhe të mos bëhen pre e ndryshimeve të shpeshta legislative të taksës e tatimeve. Kjo do të përmirësonte situatën aspak të kënaqshme të decentralizimit fiskal.

3.3.1.4. Huamarrja Vendore

Huamarrja vendore në shumë vende të BE-së përdoret gjerësisht si instrument për financime të infrastrukturës. Në ligjin organik ky instrument financiar parashikohet por pavarësisht kësaj, me akte nënligjore një gjë e tillë praktikisht është mohuar. Në grafikun më poshtë jepet një pamje e borxhit të konsoliduar publik dhe atë të qeverisjes vendore të vendeve të SEE-së.

Grafiku III.10: Borxhi publik (Q. Qendrore dhe Vendore si % te PBB në vendet e SEE)2014



Burimi: NALAS

Nga grafiku shikohet që Shqipëria e borxhin vendor e ka praktikisht zero. Vetëm 0,06 % të borxhit total, ndërsa borxhi i konsoliduar publik është mbi nivelin e 70% të PBB (shih Tabelën III.1). Me gjerësisht për këtë indikator do flasim në Kapitullin e VI^{të}.

3.3.2. Indikatorët e Decentralizimit Fiskal SEE /Shqipëria

Trajektorja në proceset decentralizuese dhe sidomos në ato fiskale ka qenë pothuaj e njëjtë në vendet e Evropës së ish bllokut. Siç dhe kemi prezantuar në Kapitullin II-^{të} në këto vende reformat decentralizuese u kërkuar kryesisht për të dobësuar trashëgiminë centriste përveç vendeve të ish Jugosllavisë të cilat trashëgonin një lloj kulture vet administrimi të ushtruar para viteve '90.


Gjithsesi, vendet e ish Jugosllavisë si rezultat i konflikteve etnike që sollën dhe ndarjen e Jugosllavisë në fillim patën programe për të konsoliduar shtetet e reja dhe pastaj pas marrëveshjeve të Deytonit dhe të Rambujesë (Kosova) sidomos pas fillimit të implementimit të Pakos së Ahtisaarit⁶⁴, si dhe marrëveshjes së Ohrit (për Maqedoninë) filluan reformat e tyre decentralizuese. Vendet e tjera këto reforma i kishin filluar menjëherë pas ndryshimeve politike. Sipas Dallango.B; Bartlett.W; Malekoviç.S; Manastiriotis.V, vendet e Evropës Juglindore ofruan shpejtësi dhe arsye të ndryshme se përse dhe si i zbatuan proceset decentralizuese.

Një pjesë e vendeve post konflikt i shikuan proceset decentralizuese nga këndvështrimi etnik, një pjesë tjetër si nga programet dhe objektivat politike. Sipas autorëve të mësipërm, proceset decentralizuese në vendet e Evropës Juglindore kanë patur rezultate të ndryshme, ato kanë patur pothuaj ngjashmëri për ato të Evropës Qendrore dhe Lindore. Gjithsesi ka patur dhe ndryshime të rëndësishme që kanë ardhur si rezultat i trashëgimive të ndryshme politike, sociale dhe ekonomike. Diferencat janë edhe se për decentralizmin nuk ka një zgjidhje të përgjithshme dhe të njëjtë për të gjithë vendet (Smoke P, 2001).⁶⁵

Duke konsideruar pjesën e decentralizimit fiskal si më të ndjeshmen dhe natyrisht më të rëndësishmen për një sukses apo dështim të qeverisjes vendore, në këtë kapitull do paraqesim se si është raporti i indikatorëve fiskal mes vendeve të SEE-së. Studime të tilla dhe raportime të tilla janë pothuaj periodike nga agjenci dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtar që mbështesin proceset në këto vende të cilat ndjekin reforma me qëllim anëtarësimin në BE.

Grafik III.11: PBB/fryme në vendet e rajonit për frymë (2006, 2014)

Euro




Burimi: NALAS (2015)

Në vendet e Evropës Juglindore, siç shihet dhe në Grafiku III.11, PBB/fryme në vitet 2006 dhe 2014 prezanton një rritje. Shqipëria, ashtu si vendet e tjera të rajonit, gjatë kësaj periudhë (8 vite) ka rritur PBB/fryme nga 2,404 Euro/fryme në 3,440 Euro/fryme. Kjo panoramë na vlen për të parë indikatorët e tjerë fiskal në raport me PBB-në dhe Indikatorin e Autonomisë (IA) që sipas (Akai dhe Sakata 2002) është raporti mes të ardhurave të veta të QV me të ardhurat e QV në total, ose % e të ardhurave të veta të QV-ve në raport me PBB me % me % të ardhurave Total në raport me PBB-ë (të

vendeve të ndryshme të Evropës Juglindore). Pavarësisht % në raport me PBB-në që do referohemi me poshtë në analizat për indikatorët e ndryshëm, Grafiku për PBB e vendeve të ndryshme na jep mundësinë që të krijojmë edhe idetë për shumat absolute të financimit të njësive të vendeve të SEE e të bëjmë analizë krahasuese.

Sipas Grafikut III.3, në Shqipëri për vitin 2014, të ardhurat vendore kanë zënë 9.4% të shpenzimeve të përgjithshme publike, që është më e ulëta në të gjithë vendet e rajonit. Në këtë vit, vetëm 2.5 % e PBB-së janë të ardhura vendore, edhe ky tregues është më i ulëti në rajon. Po kështu të ardhurat publike janë vetëm 24.4% e PBB-së. Duke qenë në këto shifra në krahasim edhe me vendet e rajonit shikohet qartë vështirësia e qeverisjes vendore në raport me vendet e tjera. Duke patur parasysh PBB/frymë të vendit, si dhe duke patur parasysh dhe dy indikatorët e % financave vendore në raport me PBB-në dhe të ardhurave publike si dhe % e të ardhurave publike në raport me PBB-në është e qartë që ka një arsye domethënëse që qeverisja vendore në Shqipëri quhet me mandate të pa financuara.


Grafik III.12: Të ardhurat e NJQV-ve si % e PBB dhe totalit të ardhurave publike në 2014



Burimi: Nalas; PLGP/USAID

Duke analizuar Grafikon III.13 shohim që Shqipëria e ka të lartë Indikatorin e Autonomisë Fiskale (raporti mes të ardhurave të veta/të ardhurat total) por siç edhe e pamë në Grafikon III.3 në raport me të ardhurat e konsoliduara publike Shqipëria është e fundit në rajon me vetëm 9%. Në Shqipëri të ardhurat e veta janë 38-40% e totalit (Grafiku III.13) ose (sipas të dhënave të ministrisë së financave të vitit 2014 ato janë rreth 43% - Grafiku III.2). Në këtë pikë vetëm Mali i Zi është me përpara. Të ardhurat e veta në Malin e Zi zënë 72% e të ardhurave totale të qeverisë vendore. Por, sipas këtij grafiku në Shqipëri për vitin 2014, raporti i të ardhurave të veta në raport me totalin ka rënë në krahasim me 2006, pra kemi një lëvizje në të kundërt sa i përket Autonomisë fiskale. Por, në këtë vit të ardhurat janë më të ulëta në të gjithë rajonin. Sipas Raportit të NALAS/2015 vetëm Shqipëria, Kosova dhe Bullgaria nuk kanë të zbatuar akoma në praktikë konceptin e taksave të ndara (Taksa mbi të Ardhurat Personale dhe Taksa mbi të Ardhurat e Biznesit). Në vende si Rumania, Moldavia, Serbia e Kroacia kjo taksë zë vend nga 36-54 % e totalit e të ardhurave të qeverisjes vendore.


Grafik III.13: Përbërja e të ardhurave vendore në Evropën Juglindore 2006, 2014



Burimi: PLGP/USAID

Në Grafikun III.14 tregohen të ardhurat e rajonit (Evropës Juglindore) krahasuar në tre vite të ndryshme me interval (2006-2009-2014). Në këtë figurë shihet se në krahasim me vendet e tjera të ardhurat e qeverisjes vendore kanë rënë në mënyrë të dukshme nga viti 2009 në vitin 2014. Edhe në vende si Moldavia, Mali i Zi apo Federata e Bosnje-Hercegovinës dhe RS (BiH) ka një rënie, por grafiku i Shqipërisë tregon jo vetëm rënie, por edhe nivel të ulët krahasim me vendet e tjera. Kjo rënie në Shqipëri në krahasim me një pjesë të mirë të vendeve, ndodh pavarësisht se nga 2006 e deri në 2014 PBB/frymë është rritur dukshëm (Grafiku III.11). Kjo është një tendencë centralizimi sa i përket financave publike. Vetëm Turqia, Kosova, dhe Moldavia kanë një gradient rritjeje pothuaj konstant nga viti në vit.

Grafik III.14: Të ardhurat Rajonit të SEE si % e PPB (2006-2009-2014)




Burimi: NALAS(2015)

Në Grafikun III.15 shikohet që të ardhurat e konsoliduara për frymë dhe të ardhurat për qeverisjen vendore për frymë, Shqipëria i ka më të ulëtat. Kjo ndikon dukshëm që të ardhurat e konsoliduara publike në raport me PBB për vitin 2014, por dhe më pas, janë nga 25-26% e PBB, dhe kjo është më e ulëta në gjithë rajonin e Evropës Juglindore dhe

natyrisht dhe më gjerë (Ministria e Financave). Kjo shifër natyrisht tregon për një ekonomi joformale me shifra të konsiderueshme. Bie në sy në grafik se edhe Kosova i ka të ardhurat për frymë të Qeverisjes Vendore më të mëdha se Shqipëria.

Grafik III.15: Të ardhurat e konsoliduara publike dhe ato vendore për fryme

Euro



Burimi: NALAS

Një indikator tjetër që mat peshën e shpenzimeve në njësitë vendore për investime që tregon dhe qasjen e njësive vendore në raport edhe me planet për përmirësimet kapitale është edhe investimet për frymë në nivel vendor. Sërish Shqipëria edhe në këtë indikator është mbrapa vendeve të rajonit. Jo vetëm si pozicion në mesataren 2006-2014 por edhe si tendencë nga mesatarja e këtij intervali në vitin 2014 ku zëri *investime për frymë* prezanton një ngadalësim rritjeje. Në vitin 2013 Shqipëria ka pasur vendin e fundit absolut me këtë shumë për investime vetëm 16 Euro/fryme (NALAS 2015)²³. Rritja në vitin 2014 është si rezultat i rritjes së Fondit të Zhvillimit të Rajoneve ku

²³ Raport i Indikatoreve fiskale të vendeve të SEE, NALAS 2015

Qeverisja vendore nuk ka autonomi vendimmarrëse pasi janë fonde të qeverisjes qendrore që shpenzohen nga ajo për funksione vendore.

Vende si Slloveni, Kroacia, Turqia, Rumani, Bullgaria e Mali i Zi kanë shpenzime domethënëse për frymë për investime. Këto vende janë edhe vendet që kanë tregues më të qartë të zhvillimit ekonomik vendor. Por sipas Petracos, 2001; ETF, 2007; Bartlett W, 2009, në këto vende shpenzimet kryesore kapitale kanë shkuar në kryeqytete duke i bërë ato me dinamike por njëkohësisht duke rritur pabarazitë vendore e rajonale (Petracos, 2001; ETF, 2007; Bartlett W, 2009) ⁶⁶ . Tek ky argument teorik dhe që vjen pas një vëzhgimi në vendet e SEE-se, jemi ndalur dhe kemi analizuar pabarazitë rajonale në Shqipëri.


Grafik III.16: Investime te qeverisjes Vendore 2006-2009-2014

(Euro/fryme)



Burimi: Nalas

Dukshëm kjo rënie e investimeve shikohet nga grafiku III.17 qe tregon rënien e këtyre investimeve nga viti 2009 ne vitin 2013. Në këtë grafik te NALAS shikohet kjo rënie e investimeve vendore nga 22 në 16 Euro/fryme. Kjo përkon me rënien ne përgjithësi e të ardhurave vendore siç e trajtuam me sipër,

Grafik III.17: Investime te qeverisjes Vendore 2006-2009-2013 (Euro/fryme)

Burimi: Nalas


Ne grafikun III.18 shikohet pozita ne fund e Shqipërisë sa i përket këtyre indikatorëve. Po kështu shikohet që pothuaj në të gjithë vendet Qeveritë Qendrore kanë ruajtur rolin dominues të enteve që prokurojnë punime dhe investime publike. Ky raport duket se është më logjik në vende si Turqia dhe Mali i Zi.

Por duke u nisur me % e investimeve qe kryejnë Qeveritë e këtyre vendeve në raport me PBB atëherë vihet re se pabarazia është me i madhe në Shqipëri. Kjo tregon një raport diskriminues dhe një cenim te një nga indikatorët më domethënës së strukturës së shpenzimeve publike dhe të ndikimit në zhvillimin ekonomik vendor.

Sipas (Petracos, 2001) (Heidenreich, 2003) dhe (Levitas T, 2013), investimet e ekzekutuara nga qeveria qendrore në akse zhvillimi apo në kryeqytete nuk kanë ndikimin e duhur dhe mbi të gjitha nxisin pabarazinë rajonale.

Grafik III.18: Investime Lokale / Qendrore si % e PBB

(Euro)

*Burimi: NALAS*

Indikatori që analizohet në Grafikun III.10 është indikatori që prezanton % e borxhit të njësive vendore dhe atë të qeverisë qendrore në raport me PBB. Shqipëria borxhin e qeverive vendore në tabelë e ka 0.0%, por realisht është 0.06%, praktikisht i papërfillshëm. Nga ky instrument i zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të kapitaleve, qeverisja vendore është e përjashtuar pavarësisht se ka një ligj për huamarrjen vendore që në vitin 2008. Vetëm 7 njësi, vendore nga 373 të tilla, kanë arritur të marrin hua nga banka të nivelit të dytë. Ndonëse edhe në vendet e BE-së kjo shifër është 6.1% e borxhit publik, vende si Mali i Zi me 5.2% apo Serbia e Sllovenia me 2.2% e Kroacia me 1.5% si vende të rajonit kanë vazhduar ta praktikojnë si instrument të financimit të planeve të përmirësimeve kapitale. Shqipëria sapo filloi ta përdorte si instrument zhvillimor, e ndërpreu me shkakun e masave për të futur nën kontroll borxhin publik i cili aktualisht (2014) është 69.17% e PBB-së.

KAPITULLI IV: ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR NE SHQIPERI

4.1. ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR DHE PABARAZITE RAJONALE


Të gjithë nivelet e qeverisjes, nëse do shikohet në kuadrin e tyre kushtetues dhe ligjor, si qeverisja qendrore po ashtu edhe ajo vendore e rajonale, ushtrojnë pushtetin e tyre me fokus rritjen e mirëqenies së qytetarëve të tyre nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe social, uljen e papunësisë dhe përmirësimet e shërbimeve bazë. Por, në disa studime të bëra, tregohet që nëse ndërhyhet me programe kombëtare të mbështetura nga qeveria qendrore ato rrisin pabarazinë rajonale e për pasojë disa rajone përfitojnë më shumë nga fondet publike të cilat kur mbivendosen mbi potenciale vendore e rajonale të pakta e të pamjaftueshme e thellojnë pabarazinë.

Siç dhe folëm në Kapitullin e III, në analizën për të ardhurat, shpenzimet vendore me Grante të Kushtëzuara dhe % e ulët të tyre në raport me PBB dhe me të ardhurat e konsoliduara publike ndikon dhe nxitë pabarazitë rajonale. Kjo ka ndodhur në shumë vende të Evropës Juglindore dhe vendeve të SEE-së. Sipas Petracos, 2001; Bartlett W, 2009, në këto vende shpenzimet kryesore kapitale kanë shkuar në kryeqytete duke i bërë ato me dinamike por njëkohësisht duke rritur pabarazitë vendore e rajonale (Petracos, 2001; ETF, 2007; Bartlett W, 2009)⁶⁷

Tek ky argument teorik dhe që vjen pas një vëzhgimi në vendet e SEE-së, jemi ndalur dhe kemi analizuar pabarazitë rajonale në Shqipëri. Kjo pabarazi nxitet nga politikat e çastit të ndërhyrjeve për përmirësime kapitale, mungesa e strategjive rajonale e vendore, nga mënyrat e financimit të njësive vendore, nga Grantet e Kushtëzuara të cilat i gjejmë

jo vetëm si pjesë e financimit të funksioneve të përbashkëta por edhe si pjesë e FZHR-së, ish Granti Konkurrues. Po kështu, financimet nga qeveria qendrore vijnë edhe nga FSHZH-ja e cila është një organizatë jo fitimprurëse dhe funksionon me ligj të veçantë por drejtohet në politikat e saj nga një bord në krye të cilit është Zv/Kryeministri. Në grafikun IV.1 jepet struktura e ndërhyrjeve të fondit të zhvillimit të rajoneve.

Grafiku IV.1: Shpërndarja e financimeve të FZHR 2009-2014



Burimi: Ministria e Financave

Financimi i investimeve duke filluar nga viti 2006 jepen në formën e *grantit konkurrues*²⁴. Sipas kësaj skeme bashkitë paraqesin projektet dhe vlerësimi i tyre bëhet nga komiteti përkatës i krijuar për këtë qëllim. Duke filluar nga viti 2010 financimi i investimeve edhe për disa funksione të përbashkëta bëhet edhe nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR)²⁵. Niveli i financimit të investimeve në kuadër të FZHR për

²⁴ Gjatë viteve 2006-2009, ka funksionuar në formën e Granteve Konkurruese, për të cilat Komiteti për Shpërndarjen e Grantit Konkurrues ka shërbyer si organ vendimmarrës. (Urdhëri i Ministrit të Financave nr.355 datë 13.01.2009, për ngritjen e Komitetit për Shpërndarjen e fondeve të Grantit Konkurrues).


²⁵ Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është ngritur bazuar në ligjin nr. 10190, datë 26.11.2009, "Për buxhetin e shtetit 2010". Në vitin 2014, janë miratuar kritere specifike për cdo thirrje për aplikime. Të drejtën për të aplikuar për grante për projekte investimesh, e kanë NjQV-re (qarqet, bashkitë, komunat), si edhe agjensite zhvillimore (që prej vitit 2014). Të drejtën për të aplikuar për grante për projekte

funkSIONet e përbashkëta në 5 vitet e fundit zë vetëm 7% të totalit të investimeve²⁶, ndërkohë që pjesën e "luanit" vazhdon ende ta mbajnë financimet për infrastrukturën rrugore vendore. Kjo sjellje e largon qeverinë nga roli i saj normal, ai i ndërtimit të strategjive, politikave rolit ligjvënës e rregullator sidomos për funksione me rëndësi kombëtare. Me këtë sjellje qeveria qendrore kthehet në një agjenci prokurimesh.

Sipas grafikëve të prezantuar në Kapitullin III^{të} qeverisja vendore në Shqipëri ka humbur terren sa i përket investimeve për frymë nga viti 2006 në 2013 si dhe në vitin 2014 kemi një ngritje të vogël krahasuar me 2009. Nga 21 Euro/frymë në vitin 2006, në vitin 2013 qeverisja vendore ka investuar për funksionet e veta vetëm 16Euro/frymë. Siç shihet edhe në Grafikun III.16, Shqipëria është shumë mbrapa vendeve të tjera.

Më poshtë në Grafikun IV.2 tregohet se çfarë raporti zënë shpenzimet vendore në raport me ato kombëtare sipas funksioneve në vendet e BE-së. (EuroStat 2013).

Grafik IV.2: Raportit të shpenzimeve QQ/QV në vendet e BE-së (2013)



Burimi: Eurostat 2013

investimesh, e kanë NjQV-re (qarqet, bashkitë, komunat), si edhe agjensite zhvillimore (që prej vitit 2014).

²⁶ Ky nivel financimi përfshin vetëm 3 (arsim, shërbimi parësor shëndetësor dhe kultura e trashëgimia kulturore) nga 6 funksionet e përbashkëta.


Siç shikohet në këtë grafik, për çështje si mbrojtja e ambientit, edukimi, mbrojtja sociale apo strehimi qeverisja vendore është agjencia që kryen këto shpenzime dhe roli në këto funksione i qeverisjes qendrore është modest.

Në grafikun më poshtë jepet një pamje e qartë të raportit të shpenzimeve kombëtare dhe vendore të vendeve të BE-së.

Në këtë grafik shikohet qartë pozicioni i Shqipërisë në raport me vendet e tjera (viti 2009 ka qenë viti që qeverisja vendore ka patur të ardhurat më të larta në raport me PBB-në).

Po kështu bie në sy renditja e Greqisë, e cila në këtë raport vjen pas Shqipërisë.

Grafiku IV.3: Shpenzime Vendore të Sektorit Publik (2009) %



Burimi: DEXIA 2011; Co-Plan

Fondet Publike ne Zhvillimin Ekonomik

Përveç fondeve publike që qeveria ka në masën 91% në administrimin e saj ajo ka konsumuar dhe 99.94% të borxhit të konsoliduar publik. Në ekzekutimin e këtyre fondeve qeveria ka në dispozicion e vet, siç thamë më sipër, edhe një agjenci dhe një

fond: FZSHH-në dhe FZHR-në. Fondi shqiptar i zhvillimit financohet pjesërisht edhe nga FZHR-ja, por kryesisht projektet e fondit financohen nga donatorë të ndryshëm. Më poshtë është tabela e financimeve nga donatorët për vitin 2014 si dhe faza e projekteve.

Fusha e veprimtarisë së Fondit Shqiptar të Zhvillimit është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe social, të qëndrueshëm, të balancuar dhe ndërveprues në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Sipas strategjisë së decentralizimit, qeveria dhe agjencitë e saj financiare dhe zhvillimore do të vijojnë të mbështesin fuqimisht me investime kapitale përmirësimin e infrastrukturës vendore me fonde të buxhetit të shtetit dhe donatorëve të huaj²⁷.

Tabela IV.1: Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve- Dhjetor 2014.

Paraqitja e nënprojekteve sipas donatorëve dhe statusit të tyre Dhjetor 2014							
Donatori	Totali	Projektet e fazës e përgatitjes së dokumentacionit	Në tenderim / vlerësim	Në kontraktim	Në zbatim	Projekte të përfunduara Në Garanci	Mbyllur Përfundimisht në Dhjetor 2014
KfW (RWS)	29					7	22
KfW (SIF IV) Water Component	15	1			14		
IDA GOA (SLRP)	9					1	8
OFID I & II (SLRP)	22				1	9	12
CEB (SLRP)	32						32
IPA 2008 (SLRP)	4						4
IDB – ISTISNA (SLRP)	13				1	5	7
EBRD, EIB & IPA 2010-2011(SLRP)	57		1		12	33	11
IPA 2013 (Lungomare)	1	1					
KfW & IPA 2009 (SLRP)	7	1			5	1	
PIK Bregdeti i Jugut	143	143					
Qeveria Shqiptare 2014 (FZHR)	30	9	5	6	9	1	
TOTALI	362	155	6	6	42	57	96

Burimi: FSHZH, Raport Vjetor 2014


²⁷ Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të vijojnë të jenë instrumente nxitës të zhvillimit urban dhe rural në kuadrin e politikave më të gjera të zhvillimit rajonal. Investimet në nivel vendor do të inkuadrohen në programe strategjike të zhvillimit rajonal të cilat garantojnë kohezionin ekonomik dhe social midis rajoneve dhe zonave të ndryshme të vendit. Qeverisja vendore do të mbështetet nga agjencitë e specializuara shtetërore në rritjen e kapaciteteve menaxhuese të projekteve të mëdha infrastrukturore, në menaxhimin e projekteve me financim të BE-së si dhe PPP-ve

Nisur nga përcaktimet teorike (Petracos 2001; Bartlett W, 2013) si dhe nga analiza krahasuese e vendeve të BE-së dhe vendeve të rajonit, qeveria qendrore në Shqipëri me mënyrën e ndërtimit të strukturës së shpenzimeve dhe me raportin e tyre QQ/QV ndikon në pabarazitë rajonale.

Cilat janë politikat në raport me funksionin e zhvillimit ekonomik vendor dhe si shprehen në strukturat e financimit?

Funksioni i Zhvillimit Ekonomik është funksion i veti i qeverisjes vendore dhe financimet për këtë funksion janë shumë modeste. Në një raport të OSBE-së në vitin 2014 prezantohet një grafik i cili tregon sasinë e shpenzimeve sipas funksioneve të veta të qeverisjes vendore.

Grafiku IV.4: Ndarja e grantit të pakushtëzuar sipas sektorëve



Burimi: Ministria e Financave; OSBE (2015)

Siç shikohet në grafik, nga Granti i Pakushtëzuar, fondet për zhvillimin ekonomik, janë tepër minimale. Në prezantimin e mësipërm pamë se investimet vendore janë 16Euro/frymë ose 0.8% e PBB si dhe duke analizuar treguesin e investimeve vjetore

nga qeveria qendrore sipas buxhetit të konsoliduar të shtetit janë afro 600 milion USD (2015). Duket qartë se roli i qeverisjes vendore në zhvillimin ekonomik është modest.

Zhvillimi ekonomik nuk mund të kuptohet pa financimin, në mes të tjerash, e planeve për investimet kapitale që në kushtet financiare që ka qeverisja vendore nuk mund ta luajë këtë rol. Ky rol ka mbetur në dorë të qeverisjes qendrore e cila sipas teorisë dhe situatave në rajonin e Ballkanit prezantuar në kapitujt e mësipërm nëpërmjet financimeve të drejtuara nga ajo nxit pabarazitë rajonale.

Qeveria qendrore në Shqipëri për vitin 2014 shpenzon nën autoritetin e vet 91% të shpenzimeve kombëtare dhe vetëm 9% zënë shpenzimet vendore.⁶⁸ Ky raport mes shpenzimeve kombëtare dhe vendore ka pasoja në deformimin dhe në mos projeksionin e kapaciteteve rajonale e vendore për zhvillim. Por a është vetëm në Shqipëri kjo qasje apo edhe në vendet e tjera?


Edhe në vendet e tjera të Evropës Juglindore, në vendet e Ballkanit, sa i përket pamundësisë së financimit të qeverisjes vendore në luajtjen e rolit të saj në zhvillimin ekonomik vendor, ka pasur konsekuenca negative. Sipas Petracos/2001 evidentohet se janë bërë studime mbi pasojat vendore të ruajtjes së performancës makroekonomike veçanërisht për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore si anëtare tashmë të Bashkimit Evropian. Këtu gjithashtu u përfshinë edhe Rumania dhe Bullgaria. “Megjithatë, ka edhe dëshmi për gjithë rajonin e Ballkanit që tregon se pas ndryshimeve, përqendrimi i aktiviteteve ekonomike në një numër të kufizuar të rajoneve kryesore apo boshte të zhvillimit është një tipar i përgjithshëm dhe evidenton se si rezultat i kësaj qasje pabarazitë ndër rajonale janë rritur”(Petracos, 2001; Heidenreich, 2003).

Përveç pabarazive të krijuara si rezultat i përqendrimeve të shpenzimeve të qeverisë në programe kombëtare dhe në akset kryesore të zhvillimit sërish këto shpenzime duke mos përfshirë qeverisjen vendore nuk i kanë sjellë ndonjë përfitim të madh njësisive vendore apo rajoneve ku ato janë zbatuar. Rast për t'u përmendur është Qarku i Kukësit në raport me potencialin e përfitimeve si rezultat i ndërtimit të Autostradës Durrës-Kukës-Morinë. Në vitin 2014, sipas INSTAT, evidentohen mbi 1.400.000 turistë të hyrë në pikën doganore të Qafë-Morinë dhe pavarësisht se ky rajon përfitoi më shumë nga të gjithë si rezultat i shpenzimit më të madh në Shqipëri për rrugën Durrës – Kukës – Qafë Morinë, në vitin 2013 -2014 punësimi ka rënë me 2%.^{69 28}

Natyrisht, ka shumë faktorë që ndikojnë në këto tregues punësimi dhe rritjeje ekonomike, por qeverisja vendore me financat që disponon dhe me liri veprimi financiar mbi to e ka tepër të vështirë të luajë një rol domethënës. Sa për ilustrim, mund të themi se Kukësi është rajoni me GDP/frymë më të ulët në Shqipëri së bashku me Dibrën dhe Lezhën.

Grafiku IV.5:

Pesha e çdo qarku në PBB (2013)



INSTAT, 2015

²⁸ Ndikimi i projekteve madhore të tilla është në nivele kombëtare dhe afatgjate. Por pavarësisht kësaj duke mos pasur strukture dhe infrastrukture vendore të përshtatshme nga kalimi i një numri në Qafë Morinë (vetëm hyrje dhe po kaq dalje) nuk arrihet të përfitohet nga një qark apo qytet me popullsi 10, apo 30 me i vogël.

Për të studiuar në mënyre thelbësore pavarësisht kufizimeve të prezantuara më sipër duhet që të shohim dhe të analizojmë zhvillimet rajonale në Shqipëri si dhe rajonin e Lezhës (si zonë studimi) në raport me rajonet e tjera. Një analizë krahasuese është e nevojshme për të parë pabarazitë rajonale në treguesit kryesor. Kjo do na ndihmojë për të projektuar me qartë analizën e treguesve të qarkut Lezhë në mënyrë që të evidentohen indikatorët të cilët bëjnë edhe ndryshimin thelbësor mes qarqeve si dhe për të shikuar vlerat që dukshëm janë të ndryshme nga mesatarja në nivel kombëtar. Nga kjo analizë krahasuese do dalin në pah edhe një pjesë e arsyeve se përse Lezha është më e mundshme për të bërë një studim të tillë në raport me njësitë e tjera vendore.

Nisur nga kushtet dhe mundësitë për një rritje ekonomike dhe zhvillim, rajonet në Shqipëri kanë ecur me shpejtësi të ndryshme.

Një gjë e tillë tregohet dhe në një studim të bërë nga PNUD/2010 mbi “Pabarazitë Rajonale në Shqipëri”.

Trajtimi i temave në këtë kapitull do ketë në bazë analizën krahasuese. Do të anashkalohen tema të cilat nuk janë relevante me këtë punim por gjithsesi ato do të jenë të rëndësishme për të kuptuar gjendjen dhe pozitat e rajoneve në përgjithësi dhe atë të Lezhës në veçanti si pjesë e këtij studimi.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme të indikatorëve zhvillimor dhe fiskal, do ndalem në këtë kapitull që krahasimet më së shumti mes rajoneve të bëhen nga këto indikatorë por duke përfshirë padyshim edhe ato social, demografik, ekonomik dhe zhvillimor.

4.1.1. Treguesit demografik²⁹

Mënyrat e financimit të prezantuara më sipër nga sektori publik në temat e zhvillimit ekonomik vendor si dhe shëndeti i ekonomive rajonale, natyrisht ka ndikuar në dinamikën e migrimit të popullsisë. Sa i përket të dhënave mbi popullsinë, qarku i Lezhës në raport me qarqet e tjera nuk ka pasur shumë ndryshime ndër vite pavarësisht lëvizjeve nga zona rurale në zonën urbane apo largimet nga kjo zonë në zona të tjera apo emigracion (kjo do prezantohet në nënkapitujt e mëposhtëm).

Nga studimet e bëra nga PNUD-i të dhënat për qarkun Lezhë tregojnë se në dallim me qarqet e tjera, ka pasur një ndryshim pothuajse të parëndësishëm demografik, në lidhje me numrin e popullsisë. Kjo, sa i përket arsyes se përse kjo zonë ka këtë dinamikë të moderuar zhvillimi, nuk është qëllim në vetvete i punimit, por siç duket oferta vendore e rajonale ka qenë e arsyeshme dhe ka prezantuar potenciale zhvillimi gjë që siç do e shohim më poshtë dhe siç treguam shkarazi më sipër në raport me PBB nuk ka ndodhur.

Tabela IV.2: Numri popullsisë - Qarku Lezhë

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Popullsia Qarku Lezhe	158,055	156,266	154,193	152,360	150,094	147,583	145,240
Popullsia Urbane	51,865	54,344	56,879	59,469	62,049	64,614	67,212
Popullsia Rurale	106,189	101,922	97,314	92,891	88,045	82,969	78,028
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Popullsia Qarku Lezhe	142,872	140,755	139,734	138,992	138,349	138,214	136,814
Popullsia Urbane	69,830	72,522	75,259	78,054	81,777	85,347	85,522
Popullsia Rurale	73,042	68,233	64,475	60,938	56,572	52,867	51,292

Burimi: INSTAT, 2015

²⁹ Të dhënat e kësaj pjesë të punimit i takojnë viteve 2010 deri në 2014. Në kapitujt e tjerë që do duhet për të analizuar në mënyrë më të veçantë dhe më thelbësore ndikimin e decentralizimit fiskal në zhvillimin ekonomik vendor ato janë të viteve (2002 – 2014).

Sa i përket të dhënave mbi popullsinë, më saktë dendësinë e popullsisë për km², qarku i Lezhës në raport me qarqet e tjera nuk ka pasur pothuajse aspak ndryshime.


Tabela IV.3: Dendësisë së popullsisë viti 2014

Qarqet	Popullsia	Dendësia
Shqipëria	2.894.476	100,7
Berat	143.888	80,0
Dibër	137.399	53,1
Durrës	275.698	359,9
Elbasan	302.112	94,4
Fier	316.406	167,4
Gjirokastrë	72.879	25,3
Korçë	225.116	60,7
Kukës	85.967	36,2
Lezhë	137.514	84,9
Shkodër	219.879	61,7
Tiranë	794.658	481,0
Vlorë	182.963	67,6

Burimi INSTAT (2015)

Siç shihet nga Tabela IV.3, Qarku i Lezhës ka një dendësi afër mesatares kombëtare, përveç Elbasanit. Ky tregues është një nga indikatorët që unë kam vlerësuar kur kam zgjedhur Organet e Qeverisjes Vendore për analizë. Densiteti i popullsisë për km² është një tregues domethënës në analizën e potencialeve zhvillimore dhe indikatorëve zhvillimor.

Referuar edhe tabelës së viteve 2002-2015 shikohet se dinamika ka qenë pothuajse e njëjtë në vite. Lëvizjet negative nga zona rurale drejt qendrave urbane janë kompensuar nga lëvizjet nga këto të fundit jashtë qarkut Lezhë.

Grafiku IV.6: *Dendësia e Popullsisë si Përqindje (%) e Mesatares Kombëtare*

Burimi INSTA, PNUD

Siç shikohet dhe nga grafiku , të dhënat tregojnë se Lezha që nga viti 2001 deri në vitin 2008, sa i përket densitetit, qëndron tek mesatarja në rang vendi. Po kështu si rezultat i përqendrimit të operatorëve të ekonomisë në aksin Tiranë - Durrës kemi lëvizje dinamike pozitive në këto dy qarqe. Dibra, Berati, Kukësi dhe Lezha kanë një ulje numri në këtë segment të prezantuar.

Të dhënat e INSTAT, në botimin e tij cituar më sipër, tregojnë se ndryshimi i qarkut Lezhë nga viti 2002 deri në 2015 është vetëm 13%, shumë e ulët krahasuar me qarqet e tjera.

Nisur nga Tabela IV.2 për të dhënat demografike, popullsia urbane në krahasim me atë totale në Qarkun e Lezhës ka pësuar një përmbysje në favor të asaj urbane. Në vitin 2002 popullsia urbane zinte vetëm 33% të popullsisë ndërsa në 2015 ajo zë 63%.


Qarku Lezhë ka 21 njësi vendore ku 10 janë në fushë në zonë me lartësi (0-100) m mbi nivelin e detit, 6 janë kryesisht në fushë (101-300) m mbi nivelin e detit; 1 njësi në zonën (301-500) m mbi nivelin e detit dhe 4 njësi nga (501-800) m mbi nivelin e detit.³⁰

Kjo panoramë tregon që, Qarku i Lezhës, njësitë vendore i ka në zona potencialisht të favorshme për sa i përket ekonomisë, lehtësitë për qasje në infrastrukturë dhe në qendra zhvillimi e institucioneve kryesore (ne mes të aksit Tiranë - Shkodër). Interesant është fakti që pavarësisht mundësive dhe pozicionit favorizues në raport me infrastrukturën dhe me resurset natyrore Qarku i Lezhës së bashku me Dibrën kanë GDP/frymë më të ulët në vend.

4.1.2. PBB sipas Rajoneve

Prodhimi i Brendshëm Bruto: Reformat e ndërmarra në Shqipëri pas rënies së komunizmit, privatizimet e tokës dhe shërbimeve krijuan klimë të favorshme për rritje të investimeve, vendi u bë atraktiv për investimet e huaja të cilat në mënyrë komplementare me biznesin vendas krijuan premisë për rritje ekonomike dhe jo vetëm. E parë nga ky këndvështrim interesant është vëzhgimi tendencës së PBB-së në qarkun Lezhë. Sipas të dhënave të INSTAT, Qarku i Lezhës së bashku me Dibrën janë qarqet me rritje ekonomike më të ulët.

³⁰ Sipas studimit të PNUD/2010 “Pabarazite Rajonale ne Shqiperi 2010”


Grafiku IV.7: Indeksi i PBB-së për frymë vlerësuar për qark (2013)

Burimi: INSTAT

Rritja ekonomike edhe në Qarkun e Lezhës ka pësuar ndryshime strukturore si rezultat i rishpërndarjes së fondeve. Këtë konkluzion arrin studimi i PNUD mbi Pabarazitë Rajonale të vitit 2010, ku në përgjithësi kemi një ulje të peshës specifike të Bujqësisë dhe një rritje të shërbimeve. Kjo është e pritshme si rezultat i proceseve të zhvendosjes së popullsisë nga zonat rurale me profil bujqësor në drejtim të atyre urbane. Vëzhgimet e hartuesve të raportit evidentojnë se në produktin e brendshëm bruto kemi një rritje të shërbimeve (nga 21% në 1992, deri në 59% në 2001 dhe 58% në vitin 2008). (Sjaak Boeckhout; Colm McClements, 2010)³¹.

Tabela e mëposhtme tregon pabarazi të madhe në kontributet e rajoneve në PBB. Qarqet e Fierit, Elbasanit, Durrësit dhe Tiranës janë qarqet që kanë dinamikën më të lartë në vitin 2013 për ndikim në rritjen e PBB. Nga ana tjetër qarqe si Shkodra, Lezha, Gjirokastra dhe Vlora kanë kontribut negativ.

³¹ Sjaak Boeckhout; Colm McClements, (2010) Pabarazite Rajonale ne Shqiperi

Grafiku IV.8:**Kontributi i rritjes te PBB 2013**

Burimi INSTAT

Sa i përket Lezhës, ajo ka “ruajtur” te njëjtin vend në fund të tabelës me një rritje të lehtë vitet e fundit për sa i përket PBB/frymë. Kjo shikohet edhe nga tabela e mëposhtme. Analizën e treguesve që kanë sjellë një zhvillim të tillë do e bëjmë në Kapitullin V-të.

Tabela IV.4:**PBB/fryme Qarku Lezhe (2002-2014)**

Vitet	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
PBB/fryme	177.2	188	217.1	238.6	260	282	298.3
Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
PBB/fryme	294.3	289.5	294.3	327.3	303	311³²	

Burimi: INSTAT

Interesant është fakti që nga tabela IV.4 Qarku Lezhë ka recension në vitet 2009, 2010 dhe 2013, pikërisht këto vite ku siç kemi parë në Kapitullin III politikat qendrore në raport me taksat vendore patën pasoja në të ardhurat e tyre. Një gjë e tillë do analizohet edhe në vazhdim.

³² Të dhënat e PBB për vitin 2014 janë operative, janë llogaritur me interpolim dhe disagregimi është në një raport me rritjen në nivel kombëtar të PBB-së për vitin 2014.

4.1.3. Punësimi/Papunësia

Punësimi: Sa i takon punësimit, variacioni sipas studimit të PNUD-it dhe të dhënave statistikore si dhe shpërndarja sipas qarqeve, ka ndryshuar gjatë viteve. Në disa qarqe, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë e Fier ai është goxha i lartë dhe ato pësuan një rritje të personave të punësuar. Ndërsa në qarqet Dibër, Kukës dhe Lezhë u tkurren si dhe ka pësuar një rritje jo të njëtrajtshme në vite. Në llogaritjet e bëra në studim tregohet që variacioni ($CoV=0.78$) është i lartë dhe për pasojë duhen analizuar shkaqet që krijuan atë në vite. Por Lezha në përgjithësi paraqet një lloj stabiliteti (jo dinamike).


Tabela IV.5: Punësimi dhe treguesit e lidhur me të në Shqipëri, 2001-2008

Treguesit e punësimit	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	Rritja (2001=1)
Popullsia në moshë pune	1,773	1,767	1,826	1,850	2,003	2,018	2,052	2,088	117.8
-si % e popullsisë totale	57.7	57.1	58.7	59.0	63.6	64.0	64.7	65.6	7.9 p.p.
Forca punëtore	1,101	1,092	1,089	1,088	1,085	1,084	1,383	1,292	117.3
-si % e popullsisë totale	62.1	61.8	59.6	58.8	54.2	53.7	67.4	61.9	-0.2 p.p.
Punësimi	920	920	926	931	932	935	1,198	1,123	122.1
-si % e popullsisë në moshë pune	51.9	52.1	50.7	50.3	46.5	46.3	58.4	53.8	1.9 p.p.
Papunësia e regjistruar	181	172	163	157	153	150	185	169.0	93.4
-si % e forcës punëtore	16.4	15.8	15.0	14.4	14.1	13.8	13.4	13.1	-3.3 p.p.

Burimi: INSTAT, llogaritjet tona


Sipas INSTAT (2015) në fashën e moshës 15-24 në raport me punëkërkesit e regjistruar ka një rritje në disa qarqe sa i përket periudhës 2010-2014. Në disa qarqe kjo është rritur dukshëm (Dibër, Tiranë Vlorë).

Grafik IV.9: Punëkërkuesve (15-24) si % në raport me totalin e punëkërkuesve (2010-2014)



INSTAT, Raporti 2015

Ulja e kërkesës nga të rinjtë për punë si % e totalit në disa qarqe (Lezhë, Shkodër, Elbasan) dhe rritja e kësaj kërkesë në qarqet (Vlorë, Tiranë, Durrës e Dibër) tregon dy tendenca të ndryshme. N.q.s. e krahasojmë këtë tendencë, në raport me investimet nga FSHZH-ja në këto qarqe nga vitet 2011 – 2015, mund të gjejmë lehtë një korrelacion mes fenomenit dhe investimeve.

Grafiku IV.10: Investime të FSHZH 2011-2015


Burimi: FSHZH, Llogaritjet e veta

Ulja e kërkesës për punë në këto qarqe ndërlidhet me investimet nga FSHZH në këto qarqe.

Por sa të qëndrueshme janë këto investime për të ndikuar në zhvillimin ekonomik vendor mbetet për t'u parë në vazhdim të këtij kapitulli dhe për ta matur atë në kapitullin V^{të}. Struktura e biznesit në Shqipëri është 87% ndërmarrje të vogla e të mesme për pasojë me implementimin e investimeve të FSHZH-së apo edhe FZHR-së, sërish struktura e operatorëve ekonomik nuk ndryshon, as zhvillohen bizneset

ekzistuese as hapen të reja (në Qarqet me PBB-në të ulët) dhe këtë temë do e trajtojmë në vazhdim.

Grafiku IV.11: Investime FZHR (2009-2014)



Burimi: OSBE (2015)

Pavarësisht kësaj, FZSHH-ja dhe FZHR-ja, investojnë në qarqe jo sipas planeve rajonale apo vendore të zhvillimit ekonomik por kryesisht sipas strategjive sektoriale.

Tabela e më poshtme jep një pamje të dinamikës së punësimit në (2010-2014) në qarqe të ndryshme. Qarqet e veriut bëjnë hapa mbrapa, ose përparim modest gjë që nxit edhe lëvizjen demografike drejt qarqeve të projektuar tashmë si motorë ekonomik të vendit duke nxitur akoma më tepër pabarazitë rajonale.

Tabela IV.6: Punësimi sipas qarkut, 2010 dhe 2014

Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	241.836	256.287	268.690	290.763	318.571
Berat	6.699	6.853	7.827	8.275	8.828
Dibër	4.305	3.578	3.634	3.293	4.190
Durrës	23.166	31.414	33.680	36.825	38.000
Elbasan	13.426	13.399	13.685	13.845	13.990
Fier	16.754	16.092	16.159	16.424	17.671
Gjirokastrë	5.715	6.315	3.500	4.030	4.936
Korçë	12.351	12.422	12.790	12.650	12.685
Kukës	1.828	2.095	1.968	2.076	2.040
Lezhë	7.906	8.078	8.515	8.541	9.256
Shkodër	13.457	13.727	13.665	13.764	13.882
Tiranë	119.428	124.389	135.341	153.014	173.360
Vlorë	16.801	17.924	17.928	18.024	19.732

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Burimi: INSTAT

Referuar grafikut dhe tabelave më sipër shohim që qarqet që sipas grafikut IV.5 janë pjesë e rajonit të veriut (përveç Durrësit) janë shumë statikë sa i përket zhvillimit apo peshës që zënë në PBB kombëtar. Këto qarqe, siç do ta shohim më poshtë, janë edhe qarqet që përfitojnë më pak edhe nga të ardhurat kombëtare dhe si pasojë janë në mbështetje vetëm të këtyre programeve dhe fondeve kombëtare pavarësisht sasive modeste. Por siç thamë më sipër kjo formë financimi krijon pabarazi rajonale.

Tabela IV.7: Punëkërkues të papunë afatgjatë sipas qarqeve

Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	89.269	88.768	86.975	87.276	82.133
Berat	4.213	4.369	4.788	4.696	4.174
Dibër	4.569	4.006	3.403	3.018	2.570
Durrës	3.074	3.096	3.715	4.263	3.872
Elbasan	10.262	9.960	9.882	9.933	9.953
Fier	12.490	11.865	11.288	11.501	11.584
Gjirrokastër	3.848	3.655	3.330	3.241	3.131
Korçë	5.246	5.383	5.594	6.248	6.579
Kukës	2.360	2.607	2.595	2.990	3.472
Lezhë	9.074	9.420	9.798	9.775	8.275
Shkodër	15.812	15.700	14.512	13.807	11.077
Tiranë	14.761	14.986	14.865	14.744	14.754
Vlorë	3.560	3.720	3.206	3.060	2.694
<i>Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit</i>					

Burimi: INSTAT

Nga kjo tabelë shohim tendencat e papunësisë që në qarqet Kukës dhe Elbasan treguesin e kërkesës për punë e kanë në rritje pothuaj konstante. Në përgjithësi kërkesa për punë në vitin 2014 ka rënë.

Duke e krahasuar me numrin e ndërmarrjeve të krijuara me numrin e punësimeve kuptojmë se kjo gjendje nuk ndjek trendin e rritjes ekonomike në disa qarqe të cilat siç

do e shohim në tabelën IV.12. Aludojmë që këto shifra (2014) kanë ardhur edhe si rezultat i masave të marra kundër informalitetit.

Siç shihet nga tabelat dhe grafikët në këtë kapitull dhe duke i krahasuar ndër vite, shohim që pabarazia mes rajoneve sa vjen e rritet. Rajoni i Lezhës ka ruajtur në mënyrë konstante vendin në fund të pothuajse çdo indikatorit. Ajo që bie në sy është që shpenzimet e qeverisjes qendrore, që janë 91% e shpenzimeve të konsoliduara kombëtare, krijojnë pabarazinë.

Në tabelën më poshtë shohim edhe ndikimin e rajoneve sipas NUTS-2 apo kontributin e këtyre rajoneve në PBB. Sipas ndarjeve kemi këto rajone:³³

Tabela IV.8: Rritja e PBB sipas qarqeve dhe rajoneve NUTS-2 %

Rajoni i Veriut	Dibër	42,524	3.1
	Durrës	129,726	9.6
	Kukës	30,998	2.3
	Lezhë	41,885	3.1
	Shkodër	74,707	5.5
Rajoni Mesit	Elbasan	101,238	7.5
	Tiranë	507,191	37.6
Rajoni i Jugut	Berat	49,828	3.7
	Fier	177,698	13.2
	Gjirokastër	35,083	2.6
	Korçë	78,886	5.8
	Vlorë	80,792	6.0

Burimi: INSTAT

Vetëm tre rajone në Shqipëri kontribuojnë 60.4% të PBB. Kjo ka bërë që këto zona të kenë dhe një presion të madh demografik dhe jo vetëm. Përveç Qarkut të Fierit që kontribut në këtë përqindje vjen si rezultat i kontributit të kompanive naftë nxjerrëse dhe përpunuese.

³³ NUTS - European “Nomenclature of Territorial Units for Statistics”. Sipas këtij protokollit Shqipëria ndahet në tre zona që i përkasin nivelit 2 të këtij niveli statistikor Evropian.

Nga kjo tabelë shikohet se rritja ekonomike në qarqet e veriut ka një rritje 11 herë më të ulët se mesatarja në rang vendi dhe dy rajonet e qendrës kanë rritje ekonomike 50% më shumë se mesatarja.

Tabela IV.9: PBB për çmime korrent/frymë sipas rajoneve statistikore

PBB me çmime korrent, PBB për frymë e trajtuar sipas rajoneve statistikore viti 2013								
Rajonet Statistikore niveli 2		PBB çmime korrent (milionë Lekë)	Struktura ndaj PBB-së (%)	Rritja Ekon omike (%)	Kontribu ti ndaj rritjes Reale (%)	PBB për frymë (lekë)	Rritja e PBB për Frymë (%)	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së
AL	Republika e Shqipërisë	1,350,555	100	1.1	1.11	466,131	1.4	100
AL 01	Veri	319,839	23.7	0.1	0.03	371,964	0.4	79.8
AL 02	Qendër	608,429	45.1	1.6	0.71	557,320	1.7	119.6
AL 03	Jug	422,287	31.3	1.2	0.37	446,487	1.8	95.8

Burimi: INSTAT

Përfundimisht, nga grafikët dhe nga një analizë krahasuese, mund të themi që rajonet (apo siç njihen ndryshe qarqet) kanë një pabarazi të madhe zhvilluese. Sipas studimeve të PNUD/2010 këto pabarazi janë rritur me kalimin e viteve dhe nuk ka një program që të ndikojë në minimizimin e tyre. Për pasojë rajonet e zhvilluara janë në një presion të fortë zhvendosjesh në drejtim të tyre që sjell mes të tjerash edhe vështirësi të njëpasnjëshme në menaxhimin e dinamikës urbane, sociale dhe jo vetëm. Rajonet e Veriut janë më pak të zhvilluara, ndërsa të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut më të zhvilluara. Spikasin rajonet e Tiranës, Durrësit dhe Fierit të cilët përbëjnë rreth 60% PBB. Konkluzionet mund t'i formatojmë ashtu siç dhe përfshihen në studimin e PNUD që:

- Diferencimin e qartë rajonal nëse shihen ekstremet: qarqet më të zhvilluara – të Tiranës dhe pastaj Durrësit dhe ato më pak të zhvilluara (të prapambetura)– Dibër, Kukës.
- Migrimin që duket se është një çështje kritike, veçanërisht në lidhje me presionin e lartë në infrastrukturë dhe shërbime në zonat më tërheqëse dhe me humbjen e popullsisë në disa zona të prapambetura. Kjo çon në mungesë efieçence në ofrimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve (shkollat, qendrat shëndetësore, rrugët, furnizimi me ujë etj.).
- Diferencimin ekstrem në nivelet vendore të bashkisë dhe komunës (i matur në të ardhurat e veta vendore, dhe në të shkuarën edhe nga treguesit e varfërisë).
- Struktura të vjetruara ekonomike dhe hapësinore (punësim jashtëzakonisht i lartë në bujqësi, urbanizim i ulët);
- Nivel i lartë papunësie i kombinuar me flukse të mëdha migrimi të jashtëm dhe të brendshëm, që çojnë në transferime të problemeve sociale dhe ekonomike në hapësirë.

4.1.4. Treguesit Rajonal për Biznesin

Të dhënat e QKR (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) japin shifrën që në janar 2014 në Shqipëri ishin të regjistruara afro 157 mijë biznese, ndër të cilat 8441 ishin biznese të mëdha (xhiro mbi 15 milionë lekë në vit); 3430 biznese të mesme (8-15 milionë lekë xhiro vjetore) dhe pjesa tjetër biznese të vogla ose të papërcaktuara.

Përqendrimi gjeografik i bizneseve përkon me të dhënat e zhvillimit ekonomik: mbi gjysma e bizneseve të përgjithshme (52%) dhe e bizneseve të mëdha (56%) operojnë në

korridorin Tiranë – Durrës, me përqendrim akoma më të madh në rajonin e Tiranës. Fieri dhe Vlora vijnë të dytat për nga renditja nga pikëpamja e numrit të bizneseve aktive, së bashku me mbi 15% të numrit të bizneseve gjithsej e atyre të mëdha³⁴.

Një strukturë e tillë biznesi prezantohet edhe nga vendet e BE-së siç shihet në tabelën IV.10.

Tabele IV.10: Numri i ndërmarrjeve sipas klasifikimit në BE (2012)


	Micro	Small	Medium	SMEs	Large	Total
Number of enterprises						
Number	19,143,521	1,357,533	226,573	20,727,627	43,654	20,771,281
%	92.2	6.5	1.1	99.8	0.2	100
Employment						
Number	38395819	26771287	22310205	87477311	42318854	129796165
%	29.6	20.6	17.2	67.4	32.6	100
Gross value added						
EUR Millions	1307360,7	1143935,7	1136243,5	3587540	2591731,5	6179271,4
%	21,2	18,5	18,4	58,1	41,9	100

Burimi: BE, Raport vjetor për SME (NVM) 2012; Eurostat,

Në tabelën e mësipërme, në BE (2012) ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme janë jo vetëm më të shumta në numër (99.8 %) por edhe japin 67% të punësimeve si dhe kontributin në ekonomi e kanë shumë domethënës (58.1%). Këto shifra janë në korrelacion të plotë me politikat e shpenzimeve vendorë në raport me ato kombëtare të këtyre vendeve. (Grafiku IV.2 dhe IV.3)

E kundërta ndodh në vendin tonë. Qeverisja vendore shpenzimet e saj në raport me PBB e ka më të ulët në rajonin e Evropës Juglindore si dhe investimet vendore zënë vetëm 0.8% të PBB (më të ulët në rajon) si dhe investimet vendore në vit janë 16Euro/frymë (2013) që kanë pësuar rënie krahasuar me vitin 2006 kur kanë qenë 22Euro/frymë. Kjo politike zhvillimore rajonale ka sjellë edhe pabarazitë që i prezantuar me sipër dhe që më dukshëm janë edhe në klimën dhe numrin e bizneseve sipas rajoneve.

³⁴ Extract nga te dhena për Analizen për reformen e territorit. Co-Plan (2014)

Grafiku IV.12: Treguesit Rajonal të Biznesit

Burimi: INSTAT

Grafiku IV.12 tregon ulje-ngritjen e lindshmërisë së bizneseve si dhe krijimin e bizneseve të reja. Ky grafik përkon me uljen e të ardhurave të veta dhe Granteve të Pakushtëzuara për qeverisjen vendore siç tregohet në Grafiket III.4 dhe III.8 në kapitullin e mëparshëm (III). Siç tregojnë edhe të dhënat e QKR, numrin më të madh të bizneseve aktive e kanë qarqet që kanë peshë në PBB-në si dhe janë qendra të mëdha administrative. Shifrat e viteve 2013 , 2014 tregojnë se një hendek i tillë po rritet vazhdimisht. Qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Gjirokastrës paraqesin një zvogëlim numri të ndërmarrjeve aktive ndërsa Tirana dhe Elbasani prezantojnë një rritje të ndërmarrjeve aktive.

Tabela IV.11: Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe pronësisë (2013-2014)

Qarqet	2013					2014				
	Gjithsej	1-4	5-9	10-49	50+	Gjithsej	1-4	5-9	10-49	50+
Gjithsej	111.083	99.782	5.235	4.660	1.406	112.537	101.025	5.387	4.647	1.478
Berat	4.557	4.261	105	151	40	4.302	4.003	110	146	43
Dibër	2.077	1.816	81	145	35	2.164	1.899	81	149	35
Durrës	10.599	9.482	505	461	151	9.578	8.460	517	431	170
Elbasan	7.442	6.866	230	292	54	7.859	7.275	253	272	59
Fier	9.830	9.125	316	308	81	9.693	9.001	308	307	77
Gjirokastrë	2.814	2.515	103	159	37	2.681	2.368	117	159	37
Korçë	6.728	6.222	208	241	57	7.311	6.820	217	218	56
Kukës	1.062	865	80	92	25	1.068	871	79	95	23
Lezhë	3.189	2.878	133	138	40	3.388	3.066	144	136	42
Shkodër	5.945	5.377	221	276	71	5.446	4.890	219	265	72
Tiranë	47.477	41.701	2.920	2.104	752	49.467	43.479	3.006	2.184	798
Vlorë	9.363	8.674	333	293	63	9.580	8.893	336	285	66

Burimi: INSTAT

Tabela IV.12: Ndërmarrje aktive sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik (2014)

Aktiviteti ekonomik			Qarqet											
Vitet	2014	Gjithsej	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Gjithsej		112.537	4.302	2.164	9.578	7.859	9.693	2.681	7.311	1.068	3.338	5.446	49.467	9.580
Bujqësia, pyjet, peshkimi		2.260	165	56	160	107	668	63	165	34	88	141	185	428
Industria		10.154	530	275	1.034	794	950	309	785	99	332	503	3.723	820
Ndërtimi		4.575	80	91	500	193	325	107	188	55	153	157	2.197	529
Tregtia		44.969	2.007	751	3.998	3.354	4.269	1.096	3.124	394	1.424	2.348	18.648	3.556
Transporti dhe magazinimi		7.562	316	303	693	800	681	209	812	89	285	340	2.318	716
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor		18.061	641	344	1.348	1.253	1.383	401	1.097	166	505	863	8.041	2.019
Informacioni dhe komunikimi		2.590	80	35	133	168	179	42	127	13	38	81	1.541	153
Shërbime të tjera		22.366	483	309	1.712	1.190	1.238	454	1.013	218	563	1.013	12.814	1.359

Burimi: INSTAT

Tabela IV.12 tregon strukturën e ndërmarrjeve dhe tipin e aktivitetit. Struktura e operatorëve ekonomike sipas qarqeve shikohet se ndërmarrjet më të shumta sipas gjithë tipave të aktiviteteve ekonomike dominohen nga qarqet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit Fierit etj. Vetëm ndërmarrjet me aktivitetin ekonomik peshkim, bujqësi etj. (që janë të pakta në numër afro 2% e totalit) janë të shpërndara në mënyrë uniforme.

Tabela IV.13 Klasifikimi ndërmarrjeve sipas numrit të punonjësve

Qarqet Counties	Gjithsej Total	Grupuar sipas numrit të të punësuarve Group by number of employed				
		1	2 ÷ 4	5 ÷ 9	10 ÷ 49	50+
Gjithsej Total	109,252	66,143	31,356	6,104	4,570	1,079
Berat	4,730	3,372	973	182	163	40
Dibër	2,060	1,380	415	88	153	24
Durrës	12,975	7,707	4,073	655	423	117
Elbasan	7,520	5,209	1,631	347	280	53
Fier	10,167	6,971	2,355	418	347	76
Gjirokastrë	3,168	2,039	765	151	178	35
Korçë	7,211	5,097	1,493	298	269	54
Kukës	1,093	551	328	85	108	21
Lezhë	3,107	1,793	961	171	150	32
Shkodër	6,683	4,563	1,531	247	288	54
Tiranë	41,565	21,692	14,450	3,027	1,885	511
Vlorë	8,973	5,769	2,381	435	326	62

BURIMI: INSTAT

Nga tabela V.13 shikohet se 92-95% e bizneseve janë mikro, të vogla dhe të mesme (sipas klasifikimit numër punonjës). Kjo strukturë është si e BE-së por në vendin tonë politikat e nxitjes së biznesit dhe të zhvillimit ekonomik janë kundra kësaj logjike dhe nxisin pabarazitë rajonale.

Ky konkluzion mbështetet në tregues të instrumenteve fiskal vendor në krahasim jo vetëm me vendet e BE-së por në krahasim me vendet e rajonit. Po kështu investimet në infrastrukturë nëpërmjet fondit të zhvillimit të rajoneve apo fondit shqiptar të zhvillimit si instrumente të zhvillimit rajonal nuk ia kanë dalë që ta ngushtojnë këtë pabarazi.

4.2. DECENTRALIZIMI FISKAL NDIKIMI NË ZHVILLIMIT EKONOMIK VENDOR (NJËSITË VENDORE LEZHË)

4.2.1. Përse zgjidhet Lezha si një kampion studimor?

Së pari, duhet të themi se periudha që shtrihet studimi ka patur një organizim territorial tjetër nga sa është aktualisht, meqenëse punimi shtrihet në periudhën para reformës administrativo territoriale, diskutimi ynë vlen për atë periudhë. Njësitë vendore në Shqipëri, deri në fund të 2014, përbëheshin nga dy nivele, bashki/komuna dhe qarqet. Nëse flasim dhe duam të analizojmë njësitë e qarkut Lezhë më përpara duhet të sqarojmë se përse Lezha?

Qarku i Lezhës përbëhet nga pesë bashki dhe 16 komuna, me 9 qytete dhe 170 fshatra, me një popullsi prej 134,027 banorë³⁵. Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe prej 1,588.4 km² dhe kufizohet me Qarkun Shkodër në Veri, qarqet Kukës dhe Dibër në Verilindje,


³⁵ INSTAT, Census 2011

- *Migracioni*
- *Pozicioni gjeografik, burimet natyrore dhe lehtësitë në infrastrukturë*
- *PBB për Qarkun Lezhë*
- *Stabiliteti politik*


Ndryshimi i popullsisë

Nëse flasim për demografinë, ashtu si dhe në qarqet e tjera të vendit, edhe në qarkun Lezhë lëvizjet e brendshme të popullsisë kanë qenë të dukshme, me largime nga fshati drejt qendrave urbane dhe largime nga qendra urbane drejt qyteteve të tjera me mundësi e potencial më të lartë ekonomik. Gjithsesi, pavarësisht kësaj, nga viti 2002 deri në vitin 2014 Qarku i Lezhës ka pësuar një ulje modeste të popullsisë në krahasim me dinamikën demografike të qarqeve të tjera. Një gjë e tillë shikohet në paraqitjen grafike në Grafiket IV.13 dhe IV.14. Në këto tabela shikohet qartë që si nga ndryshimi natyror po kështu edhe për normën bruto të ndryshimit të popullsisë, Lezha është pothuaj konstant.

Grafik IV.13: Koefficienti i ndryshimit të popullsisë sipas Rajoneve (2010-2014)



Burimi: INSTAT/Vjetari Statistikor rajonal 2015

Grafik IV.14: Ndryshimet demografike rajonale (2010-2014)

Burimi: INSTAT/Vjetari Statistikor rajonal 2015

Densiteti i popullsisë

Tjetër element demografik që më ka nxitur të zgjedh Lezhën është densiteti i popullsisë.

Lezha, përveç Elbasanit, ka densitetin prej 84.9 banorë/km² me afër mesatares kombëtare që është 100.7 banorë/km² (Tabela IV.14)

**Tabela IV.14: Densiteti i popullsisë/km²
Qarku Lezhë (2010-2014).**


Qarqet	Popullsia	Dendësia
Shqipëria	2.894.476	100,7
Berat	143.888	80,0
Dibër	137.399	53,1
Durrës	275.698	359,9
Elbasan	302.112	94,4
Fier	316.406	167,4
Gjirokastrë	72.879	25,3
Korçë	225.116	60,7
Kukës	85.967	36,2
Lezhë	137.514	84,9
Shkodër	219.879	61,7
Tiranë	794.658	481,0
Vlorë	182.963	67,6

Burimi: INSTAT/Vjetari Statistikor rajonal 2015

Migracioni

Po kështu, Lezha paraqet një raport më të ekuilibruar mes të ardhurve dhe të larguarve nga qarku, ky raport është pothuaj i balancuar. Pra, nga migracioni i brendshëm, Lezha ka një balancim pothuaj perfekt mes të ardhurve dhe të larguarve me një përqindje të vogël e të larguarve. shih Grafikon IV.15.

Grafiku IV.15: Migracioni, Qarku Lezhë (2010-2014)



Burimi: INSTAT/Vjetari Statistikor rajonal 2015

Nga tabela e mëposhtme shikohet qartë migrimi nga zona rurale në atë urbane dhe ka një stabilitet vitet e fundit duke vendosur një ekuilibër mes zonës rurale dhe asaj urbane.

Tabele IV.15: Dinamika e demografisë së Qarkut Lezhë


LEZHA	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Demografia	156,266	154,193	152,360	150,094	147,583	145,240	142,872	140,755	139,734	138,992	138,349	138,214
Dem Urban	54,344	56,879	59,469	62,049	64,614	67,212	69,830	72,522	75,259	78,054	81,777	85,347
Dem Rural	101,922	97,314	92,891	88,045	82,969	78,028	73,042	68,233	64,475	60,938	56,572	52,867

BURIMET: INSTAT

Lezha, ndryshe nga një qark tjetër, nuk ka një qendër të madhe administrative e cila dominon të gjithë qarkun, por qarku Lezhë ka gjithsej 5 bashki (Lezha, Laçi, Rrësheni dhe Rubiku dhe Mamurrasi) ku dy më të mëdhatë Lezha (qendër qarku) dhe Laçi kanë

një numër banorësh me diferencë jo më pak se 1000 banorë. Kjo tregon se si model statistikor sa i përket temave të zhvillimit përbën një model shumë qendror zhvillimor.

Grafik IV.16: Dinamika demografike Qarku Lezhë



Burimi: INSTAT , Llogaritjet e veta

Burimet natyrore dhe mundësitë në infrastrukturë

Qarku Lezhës ka një pozitë gjeografike mjaft të mirë si dhe vlera të shumta natyrore. Kombinimi i maleve, fushave dhe bregdetit i japin një gamë të madhe mundësish të ndërtimit të profileve ekonomike. Duke analizuar këto potenciale , mund të themi që për periudhën 1989-2002, popullsia e Qarkut të Lezhës ka patur rritjen më të madhe në të gjithë vendin (28,1%). (PNUD/2005:11) ⁷⁰

Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe turistike bregdetare prej 11000 ha, me vijë bregdetare 38 km dhe gjerësi të brezit bregdetar 3 km, që nga Velipoja në Veri, deri në Kepin e

Rodonit në Jug. Gjatë vijës bregdetare ka vende mjaft të përshtatshme për fshatra turistik apo porte turistike .

Një element mjaft i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik vendor është edhe infrastruktura rrugore, hekurudhore, energjetike, detare (porti Shëngjin) madje edhe ajrore (nëse aeroporti i Gjadrit do të bëhej funksional), sistemi i ujit të rrjedhshëm si dhe shërbimi i rregullt urban.(PNUD/2005:11)

Por, pavarësisht faktit që Lezha është qendër administrative si dhe ka akses më të mirë në infrastrukturën hekurudhore, në aksin Tiranë-Shkodër, me dalje në det dhe me pasuri natyrore dhe jo me klimë ekstreme, dhe një rrjet arsimore dhe kulturor si dhe me një akses në rrjetin e specializuar shëndetësor, ajo (në mes Tiranës dhe Shkodrës) ka një PBB/frymë ndër më të ulët në rang vendi. Lezha renditet e 10-ta në 12 qarqe sa i përket PBB/frymë 327,000L/frymë (2013) duke lënë prapa vetëm Kukësin dhe Dibrën.

PBB për Qarkun Lezhë

Lezha ndër vite ka prezantuar një trajektore pothuaj konstante sa i përket PBB. Në tabelën e mëposhtme prezantohet se si ka ndryshuar PBB ndër 13 vitet e studimit. Lezha pothuajse në të gjithë këtë periudhë, si Qark, ka “ruajtur” të njëjtin pozicion në krahasim me Qarqet e tjera. Lezha ka qenë gjithmonë e renditur në fund të kësaj tablele së bashku me qarqet e tjera të Veriut, si Kukësi e Dibra, por duke patur pozita dhe avantazhe krahasuese shumë më të favorshme se këto qarqe.

Tabela IV.16: Rritja Reale e PBB % sipas Qarqeve


Rritja reale e PBB-së				
Qarku=100	2009	2010	2011	2012
Republika e Shqipërisë	3,4	3,7	2,5	1,6
Dibër	4,0	7,4	-2,3	13,2
Durrës	2,9	11,3	1,3	1,2
Kukës	4,3	3,8	4,5	-4,3
Lezhë	3,0	-1,8	1,6	9,6
Shkodër	4,3	6,8	-1,7	-2,7
Elbasan	2,4	12,9	5,6	-0,8
Tiranë	3,9	0,5	1,5	2,1
Berat	3,1	6,8	4,9	-2,1
Fier	1,6	6,7	3,3	8,6
Gjirokastrë	3,3	4,6	14,3	-11,3
Korçë	3,4	1,5	1,9	1,2
Vlorë	3,2	-4,5	6,8	-5,5

Burimi: INSTAT

Tabela IV.17: PBB/frymë qarku Lezhë.

000 L

QARKU LEZHE	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
PBB/fryme_000L	177.2	188	217.1	238.6	260	282	298.3	294.3	289.5	294.3	327.3	303	311



Burimi: INSTAT, Llogaritjet e veta

Ky fakt, të pasurit pasuri natyrore por tregues ekonomik (PBB) ndër më të ulët në rang vendi, ka qenë edhe një nga arsyet që unë kam zgjedhur Lezhën për ta patur si rast studimor.

Stabiliteti politik (ekuilibri me mandate politike në mes të majtës dhe të djathtës në periudhën në studim)

Është gjerësisht e njohur dhe lehtësisht e kuptueshme se ka njësi vendore që asnjëherë, ose fare pak herë kanë ndërruar kahun politik. Sipas të dhënave nga KQZ, dhe INSTAT në qarkun Lezhë, mandatet janë fituar nga subjektet politik sipas asaj siç edhe tregohet në Tabelën IV.19. Duke patur një ndryshim të koalicioneve edhe brenda mandatit 2011-2013 ky ekuilibër ka patur një rol të veçantë për të ndryshuar mandatet në këtë qark. Siç shihet dhe nga grafiku në nivel qarku përfaqësimi është i balancuar nga ana politike.

E bëj këtë parashtesë, sepse vazhdimisht ka patur raporte nga organizata partnere ndërkombëtare që kanë vënë në dukje dhënien e fondeve me preferencë politike⁷¹ (Tabela IV.18). Një gjë e tillë do ta bënte të vështirë dhe jo krejt të besueshëm studimin e hipotezës dhe për pasojë dhe konkluzionet.

Tabela IV.18: Krahassimi i granteve të Fondit të Zhvillimit Rajonal me NJQV-të sipas përkatësisë politike

	PS	PD
Nr. i NJQV-ve në secilin prej katër viteve	13 nga 26 50%	25 nga 33 76%
<i>Shuma totale e granteve</i>		
2006	741,347	1,075,506
2007	1,266,275	1,343,739
2008	351,303	571,790
2009	496,982	1,271,132
<i>Granti mesatar për çdo vit</i>		
2006	28,513	32,591
2007	48,702	40,719
2008	13,511	17,327
2009	19,114	38,519

Burimi: PLGP/USAID

Sipas PLGP/USAID, PNUD, OSBE, CoE qeveria qendrore ndan fondet nga Granti i Kushtëzuar apo Granti Konkurrues apo FZHR në mënyrë preferenciale. Një gjë e tillë

vazhdon dhe tani. Duke mos marrë në konsideratë këto raporte, por thjeshtë leximin statistikor të mandateve, besoj se zgjedhja e Lezhës si model studimor, më ndihmon në nxjerrjen e një rezultati sa më të qartë teknik dhe pa ndikime politike.

Tabela IV.19: Mandatet sipas bashkive

QYTETET E QARKUT LEZHE	2000	2003	2007	2011
Laç	Bardhi Rica PD+	Luigj Isufi PD+	Luigj Isufi PD	Artur Bardhi AA
Mamurras	Andon Frrokaj PD+	Andon Frrokaj PD+	Ded Ndrecë PS,LSI,PSD,AD	Ilir Pjetraj AQ
Lezhë	Gjok jaku PS	Gjokë Jaku PS	Viktor Tushaj PS,LSI,PSD,AD	Viktor Tushaj AQ
Rrëshen	Marie Biba PS+	Preng Toma PD+	Gjon Dedaj PD, PDK	Ndue Kolaj AA
Rubik	Gjovalin Prenga PD+	Mark Ruci PD	Mark Ruci PD,BLD	Gjok Vukaj AA

Burimi: Open Data Albania; KQZ, INSTAT

Tabela IV.20: Mandatet sipas komunave

Komunat e Qarkut Lezhë	2000 Emri i plotë / Subjekti propozues	2003 Emri i plotë / Subjekti propozues	2007 Emri i plotë / Subjekti propozues	2011 Emri i plotë / Subjekti propozues
Komuna Blinishte	Lek Ndoc Lufi PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Gjovalin Gac Lleshi PD+PR+PBL	Jak Dod Zhuba PS+ LSI+ PSD+ PDS+ AD	Jak Dodë Zhuba Aleanca për Qytetarin
Komuna Dajç - Lezhë	Mikel Shtefjen Miloti PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Rrok Lin Rroku PDK	Rrok Lin Rroku PD+ PDK	Gjergj Gjini Doçi Aleanca për Qytetarin
Komuna Kallmet	Nikoll Gjini Gjini PSSH	Shtjefen Gjokë Haberi PSSH	Petrit Prend Marku PD	Petrit Prend Marku Aleanca për Qytetarin
Komuna Kolsh-Lezhë	Dedë Frrok Deda PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Pjetër Kol Toni PAA	Andi Llesh Marku - i pavarur	Ferdinand Ded Ndoj Aleanca për të Ardhmen
Komuna Shëngjin	Ndue Nikoll Koleci PSSH	Ndue Nikoll Koleci PSSH	Luigj Pashko Prelaj PD	Salvador Petrash Kaçaj Aleanca për të Ardhmen
Komuna Shënkoll	Gjergj Mark Kqira PSSH	Fran Gjon Frrokaj pd+pr+pbl	Fran Gjon Frrokaj PD+ PLL	Fran Gjon Frrokaj Aleanca për Qytetarin
Komuna Ungrej	Pal Gjon Zefi PSSH	Gjovalin Frrok Gjoni PD+PR+PBL	Gjovalin Frrok Gjoni PD+ PR	Gjovalin Frrok Gjoni Aleanca për Qytetarin

Komuna Zejmen	Gjergj Pjetër Toma PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Gjergj Simoni Malshi PSSH	Arben Ndue Doci PD	Arben Ndue Doçi Aleanca për Qytetarin
Komuna Fan	Nikoll Gjet Shyti PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Mark Ndue Prenga PSSH	Gjergj Ndue Prenga PD+ PDK	Gjergj Ndue Prenga Aleanca për Qytetarin
Komuna Kaçinar	Kastriot Mark Ndoj PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Kastriot Mark Ndoj PD+PR+PBL	Kastriot Mark Ndoj PD	Petro Bib Doda Aleanca për të Ardhmen
Komuna Kthellë	Preng Pjetër Toma PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Nokë Mark Mrruku PD+PR+PBL	Tom Ndue Lleshi PD+ PDK	Prend Zef Lekgegaj LZHK
Komuna Orosh	Luigj Llesh Lleshi PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Luigj Llesh Lleshi PD+PR+PBL	Aleksandër Gjokë Lala PD+ PDK	Aleksandër Gjokë Lala Aleanca për Qytetarin
Komuna Selitë-Mirditë	Viktor Frrok Gjikola PD+PLL+PBL+P BKD+PBD	Nikolin Marash Lleshaj PD+PR+PBL	Nikolin Marash Lleshaj PD+ PLL	Vladimir Nikoll Gjikolaj Aleanca për Qytetarin

Burimi: Open Data Albania; KQZ, INSTAT

Arsyet e prezantuar më sipër, ato demografike, natyrore, infrastrukturore, ekonomike e politike dhe migracioni më kanë nxitur që si rast studimor të marr shumën e njërive vendore të Qarkut Lezhë. Fakti që treguesit ekonomik janë në nivel qarku, por qarku si entitet publik nuk ka asnjë peshë në vendimmarrje apo nuk ofron shërbime, si dhe nuk ka një profil enti që bën politika fiskale, më ka shtyrë që në modelin tim studimor të marr shumën e njërive të nivelit të parë të Qarkut Lezhë por jo të përfshirë vetë Qarkun Lezhë si njësi vendore e nivelit të dytë.

4.2.2. Situata dhe treguesit ekonomik bazë të qarkut Lezhë


Qarku i Lezhës ka një pozitë tepër të mirë dhe të favorshme. Pjesa që prezanton edhe motorin ekonomik të qarkut ndodhet në mes të rrugëve kryesore të komunikimit me Veriun, Shqipërinë e Mesme dhe me Kosovën. Shëngjini, porti i tij, është vetëm 8 km larg nga qendra e njësisë administrative të qarkut.

Janë shkurtuar ndjeshëm distancat jo vetëm brenda qarkut dhe me qarqet kufitare, por dhe me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë, përmes superstradës Shkodër-Hani i Hotit dhe autostradës Durrës-Kukës-Morinë. Ndërtimi i këtyre rrugëve jo vetëm që ka shkurtuar distancat dhe ulur kohën e udhëtimit, por ato kanë ndihmuar në rritjen e bashkëpunimit e shkëmbimeve tregtare, rritjen e numrit të turistëve, zhvillimin e ekonomisë, etj.⁷²

Gjithashtu në këtë zonë ndodhet njëri prej tre porteve më të mëdhenj të vendit, porti i Shëngjinit dhe aeroporti i Gjadrit.

Në krahasim me qarqet e tjera Qarku i Lezhës ka një ekonomi e cila sipas treguesve të PBB(2013) për frymë klasifikohet i fundit në 12 qarqet e vendit.

Grafiku IV.17: PBB për frymë sipas qarqeve (2013)



Burimi: INSTAT

Struktura e operatorëve ekonomik të Qarkut Lezhë është një strukturë që në përmbajtjen e saj dominon biznesi i vogël. Si e tillë, duke shikuar në tabelën më poshtë, edhe në konfigurimin e tij ka një lidhje të fortë me qeverisjen e vendore e cila nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, përmirësimeve kapitale, të shërbimeve publike si dhe

kuadrit rregullator vendor dhe rajonal ndikon në zhvillimin e biznesit. Në përmirësimin e kësaj klime, përveç qeverisjes vendore, qeverisja qendrore kontribuon me investimet e saj direkt në mbështetje të politikave kombëtare e sidomos të atyre rajonale ku një pjesë e mirë e investimeve vendore janë në funksion të tyre.

Më poshtë jepet Tabela IV.21 që e prezanton më së miri strukturën e biznesit në qarqet e vendit të vitit 2014.


Kjo situatë ekonomike ka bërë që nga viti 2013 deri në vitin 2014 në Qarkun Lezhë të kemi një rritje punësimi me 8% (Grafiku IV.19).

Tabela IV.21: Ndërmarrje aktive sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik 2014

Aktiviteti ekonomik	Vitet 2014	Qarqet												
		Gjithsej	Berat	Dibër	Durrës	Elbasan	Fier	Gjirokastrë	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Gjithsej		112.537	4.302	2.164	9.578	7.859	9.693	2.681	7.311	1.068	3.338	5.446	49.467	9.580
Bujqësia, pyjet, peshkimi		2.260	165	56	160	107	668	63	165	34	88	141	185	428
Industria		10.154	530	275	1.034	794	950	309	785	99	332	503	3.723	820
Ndërtimi		4.575	80	91	500	193	325	107	188	55	153	157	2.197	529
Tregtia		44.969	2.007	751	3.998	3.354	4.269	1.096	3.124	394	1.424	2.348	18.648	3.556
Transporti dhe magazinimi		7.562	316	303	693	800	681	209	812	89	285	340	2.318	716
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor		18.061	641	344	1.348	1.253	1.383	401	1.097	166	505	863	8.041	2.019
Informacioni dhe komunikimi		2.590	80	35	133	168	179	42	127	13	38	81	1.541	153
Shërbime të tjera		22.366	483	309	1.712	1.190	1.238	454	1.013	218	563	1.013	12.814	1.359

Burimi: INSTAT

Po kështu nga tabelat e INSTAT-it për rritjen e ndërmarrjeve në dinamikë në 4 vitet e fundit tregohet një ecje pozitive. Kjo tregon që zhvillim kanë patur ndërmarrjet e vogla (Grafiku IV.18) pasi kjo vërtetohet edhe në strukturën e operatorëve ekonomik të qarkut.

Grafiku IV.18: Ndërmarrjet jo Bujqësore Qarku Lezhë


Burimi: Drejtoria Rajonale e Tatimeve; Llogaritjet e veta.

Nga Grafiku IV.18 i bizneseve/ndërmarrjeve jo bujqësore kemi një luhatje, të bizneseve të vogla kryesisht, dhe kjo vjen si rezultat i politikave fiskale të ndjekura nga qeveria jo vetëm si rezultat i klimës ekonomike.⁷³

Sa i përket punësimeve, nga Grafiku IV.19 shikohet se punësimet në sektorin jo bujqësor janë rritur. Ky fakt tregon se një trend pozitiv ka patur kryesisht në qendrat urbane, krahasuar këto të dhëna edhe me lëvizjet demografike siç folëm në kapitujt e mësipërm nga zona rurale në atë urbane mund të themi që ofrimi i biznesit në zonat urbane bën të qartë se ai është me afër autoritetit vendor dhe nevoja e tij për shërbime, investime për infrastrukturë dhe plan investimesh kapitale si dhe mbështetja me kuadër rregullator dhe planifikim strategjik është shumë evidente.

Grafiku IV.19:

Ndryshimi i punësimit 2013 -2014



Burimi: INSTAT

Tabela e mëposhtme, sa i përket ndryshimit të ndërmarrjeve të reja sipas qarqeve, tregon një trend pozitiv në vitin 2014 për Lezhën. Ky tregues u krahasua me të dhënat e Bashkisë Lezhë dhe rezultoi që në Bashkinë Lezhë që është edhe pesha më e madhe specifike në krahasim me njësitë e tjera vendore të qarkut në vitin 2014 ka patur një rritje domethënëse në vitin 2014. Kjo është një qasje në të gjithë qarqet dhe ka shumë mundësi që të jetë si rezultat i luftës kundër informalitetit të ndërmarrë në këtë vit nga strukturat tatimore. Kjo ka bërë, që edhe një pjese e bizneseve të lëvizin nga ai i vogël në biznesin e madh si dhe të ndryshojnë regjistrim (Tabela IV.21).

Tabela IV.22:


Bizneset Bashkia Lezhë.

Evidenca e subjekteve						
Qyteti Lezhë	Gjendja me 01.01.2014	Te reja	Te larguara			Gjendja me 18.12.2014
			Aplikim çregjistrim	për	Transferim, pezulluar,	
Biznese gjithsej	921	437	108		15	1235
Biznes i madh	238	52	15		4	271
Biznes i vogël	683	385	93		11	964

Burimi: Bashkia Lezhë, Llogaritjet e veta.

Grafiku IV.20:

Ndërmarrjet e reja sipas qarqeve



Burimi: INSTAT

Në Grafikun IV.20, shikohet qe dinamika pothuaj është e njëjte në gjithë qarqet e vendit, me ulje ne vitet 2011, 2012, 2013 dhe me një ngritje ne vitin 2014.

Tabela IV.23:

Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor.

Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	241.836	256.287	268.690	290.763	318.571
Berat	6.699	6.853	7.827	8.275	8.828
Dibër	4.305	3.578	3.634	3.293	4.190
Durrës	23.166	31.414	33.680	36.825	38.000
Elbasan	13.426	13.399	13.685	13.845	13.990
Fier	16.754	16.092	16.159	16.424	17.671
Gjirokastrë	5.715	6.315	3.500	4.030	4.936
Korçë	12.351	12.422	12.790	12.650	12.685
Kukës	1.828	2.095	1.968	2.076	2.040
Lezhë	7.906	8.078	8.515	8.541	9.256
Shkodër	13.457	13.727	13.665	13.764	13.882
Tiranë	119.428	124.389	135.341	153.014	173.360
Vlorë	16.801	17.924	17.928	18.024	19.732

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Burimi: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tabela e mësipërme sa i përket punësimit tregon një rritje domethënëse në vitin e fundit si rezultat i luftës ndaj informalitetit. Por, në vitet e mëparshme situata ka qenë pothuajse konstante e ndarë në dy segmente (2009-2010 dhe 2011-2013).


Ky indikator është ngushtësisht i lidhur me punën e Bashkisë. Meqenëse 87% sipas INSTAT është biznes i vogël dhe i mesëm, tregon që punësimi është i lidhur ngushtësisht me të dhe pikërisht njësitë vendore janë faktor me ndikim domethënës në krijimin e klimës së përshtatshme për përmirësimin e klimës dhe për të nxitur rritjen e bizneseve të reja. Struktura e këtyre njësive sipas qarqeve dhe aktiviteti i tyre ekonomik shikohet në tabelën më poshtë. Nga tabela, shikohet se nga 3887 biznese të qarkut 3241 janë biznese me profil shërbimi. Referuar që në biznese të mëdha janë kryesisht kompani ndërtimi dhe të lidhura me to, atëherë roli i njësive vendore për mbarëvajtjen e tyre del dhe me ndikues. Si strukturë, në Qarkun Lezhë rreth 84.6% e bizneseve janë biznese me bazë shërbimin.

Tabela IV.24: Njësitet vendore sipas qarqeve/aktiviteti ekonomik dhe pesha specifike % sipas aktivitetit ekonomik në total

Njësitet lokale sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik Local units by prefectures and economic activity											
Gjendje në fund të vitit / End of the year											
Qarqet Prefectures	Gjithsej Total	Prodhuesit e të mirave Producers of goods	Bujqësia, pyjet, peshkimi Agriculture, forestry, fishing	Industria Industry	Ndërtimi Construction	Prodhuesit e shërbimeve Producers of services	Tregtia Trade	Transporti dhe magazini Transport and storage	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor Accommodation and food service activities	Informacioni dhe komunikacioni Information and communication	Shërbime të tjera Other Services
Gjithsej Total	124.508	18.117	2.319	10.920	4.878	106.391	47.160	8.466	18.254	2.873	29.638
Berat	4.955	821	169	568	84	4.134	2.056	365	648	89	976
Dibër	2.502	470	57	316	97	2.032	777	346	344	38	527
Durrës	10.565	1.815	162	1.117	536	8.750	4.213	783	1.375	160	2.219
Elbasan	9.055	1.178	108	853	217	7.877	3.476	871	1.259	182	2.089
Fier	10.884	2.068	675	1.046	347	8.816	4.453	764	1.393	199	2.007
Gjirokastrë	3.146	507	63	328	116	2.639	1.145	260	402	56	776
Korçë	8.335	1.225	170	848	207	7.110	3.252	894	1.099	145	1.720
Kukës	1.435	221	40	112	69	1.214	414	128	166	19	487
Lezhë	3.887	646	96	371	179	3.241	1.503	320	516	48	854
Shkodër	6.341	886	145	561	180	5.455	2.469	413	876	101	1.596
Tiranë	52.994	6.407	196	3.914	2.297	46.587	19.707	2.531	8.147	1.664	14.538
Vlorë	10.409	1.873	438	886	549	8.536	3.695	791	2.029	172	1.849
%											
Gjithsej Total	100	14,6	1,9	8,8	3,9	85,4	37,9	6,8	14,7	2,3	23,8
Berat	100	16,6	3,4	11,5	1,7	83,4	41,5	7,4	13,1	1,8	19,7
Dibër	100	16,6	3,4	11,5	1,7	83,4	41,5	7,4	13,1	1,8	19,7
Durrës	100	18,8	2,3	12,6	3,9	81,2	31,1	13,8	13,7	1,5	21,1
Elbasan	100	17,2	1,5	10,6	5,1	82,8	39,9	7,4	13,0	1,5	21,0
Fier	100	13,0	1,2	9,4	2,4	87,0	38,4	9,6	13,9	2,0	23,1
Gjirokastrë	100	19,0	6,2	9,6	3,2	81,0	40,9	7,0	12,8	1,8	18,4
Korçë	100	16,1	2,0	10,4	3,7	83,9	36,4	8,3	12,8	1,8	24,7
Kukës	100	14,7	2,0	10,2	2,5	85,3	39,0	10,7	13,2	1,7	20,6
Lezhë	100	15,4	2,8	7,8	4,8	84,6	28,9	8,9	11,6	1,3	33,9
Shkodër	100	16,6	2,5	9,5	4,6	83,4	38,7	8,2	13,3	1,2	22,0
Tiranë	100	14,0	2,3	8,8	2,8	86,0	38,9	6,5	13,8	1,6	25,2
Vlorë	100	12,1	0,4	7,4	4,3	87,9	37,2	4,8	15,4	3,1	27,4

Burimi: INSTAT

Grafiku IV.21: Ndërmarrje aktive krijuar (shkallë lindshmërie)



Burimi: INSTAT

Sic do ta sqarojmë në kapitujt më poshtë, ku të bëjmë lidhjen mes ambientit ligjor dhe institucional në raport me biznesin e vogël dhe të mesëm, do shohim nga analiza se në vitin 2009 ka patur vendimmarrje në kuadrin ligjor që ka ndikuar në uljen e ndërmarrjeve të vogla e të mesme në rang vendi. Mbase kjo nuk ka ardhur nga mos funksionimi ë tyre por nga kalimi nga biznesi i vogël në atë të mesëm si rezultat i procesit të administrimit të taksës mbi biznesin e vogël dhe uljes së interesit të njësive vendore për të.

Tabelat IV.21, na tregon punësimin në qarqe sipas aktivitetit ekonomik dhe sipas grupimit në raport me fashën e numrit e të punësuarve. Sipas ligjit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme ndërmarrjet ndahen në 4 grupe: 1) mikro ndërmarrjet 2) ndërmarrjet e vogla 3) të mesme dhe 4) të mëdha.

Mikro ndërmarrjet janë ndërmarrjet, te cilat punësojnë deri në **5 punonjës**; ndërmarrjet e **vogla** janë ndërmarrjet të cilat punësojnë **6-20 punonjës**; ndërmarrjet e **mesme** janë ndërmarrjet të cilat punësojnë **21-80** punonjës por kanë kushtin që xhiroja vjetore të mos jetë më shumë se 8 milion lekë /vit.⁷⁴

Në tabelat më poshtë mund të shohim se sa është pesha specifike e këtyre ndërmarrjeve në punësim. Bazuar në tabela, Qarku i Lezhës sipas strukturës së biznesit dhe sipas ndarjeve të ligjit për ndërmarrjet e vogla e të mesme punëson në këto ndërmarrje mbi 90% e të punësuarve.

Tabela IV.25: Numri i punonjësve sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe qarqeve

Qarqet Counties	Gjithsej Total	Grupuar sipas numrit të të punësuarve Group by number of employed				
		1	2 ÷ 4	5 ÷ 9	10 ÷ 49	50+
Gjithsej Total	109,252	66,143	31,356	6,104	4,570	1,079
Berat	4,730	3,372	973	182	163	40
Dibër	2,060	1,380	415	88	153	24
Durrës	12,975	7,707	4,073	655	423	117
Elbasan	7,520	5,209	1,631	347	280	53
Fier	10,167	6,971	2,355	418	347	76
Gjirokastrë	3,168	2,039	765	151	178	35
Korçë	7,211	5,097	1,493	298	269	54
Kukës	1,093	551	328	85	108	21
Lezhë	3,107	1,793	961	171	150	32
Shkodër	6,683	4,563	1,531	247	288	54
Tiranë	41,565	21,692	14,450	3,027	1,885	511
Vlorë	8,973	5,769	2,381	435	326	62

Qarqet Counties	Gjithsej Total	Grupuar sipas numrit të të punësuarve Group by number of employed				
		1	2 ÷ 4	5 ÷ 9	10 ÷ 49	50+
Gjithsej Total	100	60.5	28.7	5.6	4.2	1.0
Berat	100	71.3	20.6	3.8	3.4	0.8
Dibër	100	67.0	20.1	4.3	7.4	1.2
Durrës	100	59.4	31.4	5.0	3.3	0.9
Elbasan	100	69.3	21.7	4.6	3.7	0.7
Fier	100	68.6	23.2	4.1	3.4	0.7
Gjirokastrë	100	64.4	24.1	4.8	5.6	1.1
Korçë	100	70.7	20.7	4.1	3.7	0.7
Kukës	100	50.4	30.0	7.8	9.9	1.9
Lezhë	100	57.7	30.9	5.5	4.8	1.0
Shkodër	100	68.3	22.9	3.7	4.3	0.8
Tiranë	100	52.2	34.8	7.3	4.5	1.2
Vlorë	100	64.3	26.5	4.8	3.6	0.7

Burimi: INSTAT

4.2.3. Treguesit fiskal të njësive vendore të Qarkut Lezhë (2002-2014)


Qarku Lezhës ka 16 njësi vendore dhe është një nga qarqet që nuk ka një qendër të madhe administrative dhe njësi vendore rurale të cilat nuk kanë asnjë farë aktiviteti. Në këtë qark, 5 bashkitë dhe 11 komunat, pavarësisht pothuajse homogjenitetit brenda llojit (Bashki dhe Komunë) kanë edhe dallime thelbësore të cilat dalin në dukje nga një analizë krahasuese në vite.

Treguesit fiskal të këtyre njësive vendore janë të lidhur me tre elemente kryesore e të ardhurave të tyre: të ardhurat e veta, grantet e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara.

Analiza krahasuese është bërë duke i grupuar njësitë sipas rretheve të cilat pas reformës së territorit (2014) janë njësi vendore në vete. Po kështu ia vlen të analizojmë ecurinë në vite edhe sa i përket shpenzimeve vendore. Sipas kësaj tablele dhe figurës ilustruese përkatëse, si në vitin 2011 ashtu dhe në vitin 2014, pesha specifike e të ardhurave vendore pavarësisht strukturës së njësive vendore brenda qarkut (1/3 janë Bashki) është në qendrën e qarkut. Të ardhurat, si ato të vetat po ashtu edhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukture (apo e ndërtimit) janë të përqendruara në Lezhë. Sa i përket taksës mbi tokën bujqësore është pothuaj zero pavarësisht se më sipër në Tabelën IV.24 të INSTAT-it tregohet që mbi 10% deri në 15% e bizneseve janë biznese bujqësore

Më poshtë, në Tabelën IV.26, jepen treguesit kryesor të vitit (2011; 2014) e të ardhurave të veta të njësive vendore Lezhë si dhe dy komponentët më të rëndësishëm që përbëjnë të ardhurat e veta. Kjo tabelë tregon dinamikën në 4 vitet e fundit se si kanë lëvizur këto elemente të ardhurave të veta në tre rrethet e qarkut Lezhë.

Tabele IV.26: Të Ardhurave të Veta, Taksë Ndërtuese/ Tokë Bujqësore (Q. Lezhë)



Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e Veta

Tabele IV.27: Të dhëna statistikore financiare të NJQV Qarku Lezhe. (2013)

NJQV-të e reja	Popullsia	Sip. në km2	Granti i pakush tëzuar për frymë	Granti i kushtëzuar / frymë	Të ardhurat e veta për frymë	Taksa e pasurisë për frymë	TBV për frymë	Total i të ardhur. (pa grante të Sigurimeve Shoq.) për frymë
Mirditë	22,103	881	8,028	3,009	2,285	65	351	13,322
Fan	2,977	201	7,299	19,855	718	16	34	27,872
Kaçinar	1,016	86	12,076	299	554	76	79	12,930
Kthehtë	2,209	106	5,900	0	96	24	12	5,996
Orosh	1,899	131	8,452	228	5,575	37	676	14,254
Rrëshen	8,803	160	7,216	736	3,075	101	626	11,026
Rubik	4,454	119	8,832	0	2,189	35	171	11,022
Selite	745	78	15,449	242	246	197	0	15,937
Lezhë	65,633	505	3,264	1,060	3,460	325	415	7,783
Ballëdren	6,142	70	3,286	72	3,258	238	63	6,615
Blinisht	3,361	49	3,164	18,518	1,724	351	70	23,406
Dajç	3,834	39	3,434	54	1,309	367	75	4,796
Kallmet	4,118	44	3,264	44	2,579	391	59	5,887
Kolç	4,228	34	3,076	244	1,330	56	34	4,649
Lezhe	15,510	5	4,221	43	6,440	441	1,173	10,704
Shengjin	8,091	44	2,343	38	7,306	622	470	9,687
Shenkoll	13,102	54	2,193	49	966	136	223	3,208
Ungrej	1,587	120	8,534	2,268	525	124	11	11,327
Zejmen	5,660	46	3,018	45	1,327	284	172	4,390
Kurbin	46,291	267	4,175	595	1,416	187	273	6,186
Fushë Kuqe	5,460	63	3,056	1,898	695	68	110	5,649
Laç	17,086	23	4,985	140	1,998	222	353	7,124
Mamurras	15,284	56	4,233	53	1,319	216	363	5,605
Milot	8,461	125	3,155	1,651	883	141	56	5,688
Qarku Lezhe	134,027	1,653	15,467	4,664	7,161	577	1,039	27,291

Burimi: PLGP/USAID; Llogaritjet e veta (tregues financiar njësi Qarku Lezhe)

Pra, siç shikohet në këtë tabelë (IV.27), njësitë e ndryshme kanë edhe peshë të ndryshme gjë që ndikon në rolin që ato luajnë në klimën e biznesit si dhe rolin pro aktiv dhe pro biznes të tyre në kuadër të programeve të Zhvillimit Ekonomik Vendor (kryesisht Bashkia Lezhë)

Një analizë të plotë mund ta japim nëpërmjet tabelës integrale që prezantohet me poshtë. Në këtë tabelë tregohen të ardhurat e njësi përbërëse të qarkut Lezhë. Në këtë


tabelë shikohen në mënyrë krahasuese, shëndeti institucional decentralizues fiskal edhe sipas elementeve përbërës të financave vendore për çdo njësi, si dhe të ardhurat integrale për frymë. Të dhënat janë të vitit 2013 dhe janë marrë në Ministrinë e Financave. Në këtë vërehet se, pavarësisht ndarjes së grantit të pakushtëzuar me formulë, të ardhurat nga ky grant për frymë janë të ndryshme (Tabela VI.14).

Në Grafikon VI.10 jepen të dhëna nga dinamika e të ardhurave (2002-2014) për Grantin e Pakushtëzuar të njësive vendore të Qarkut Lezhë. Ky Grant ka pasur pikën më të ulët në vitin 2009 dhe më të lartën në 2012. Vlen të sqarohet, që Granti i Pakushtëzuar jepet me formulë dhe njësitë vendore kanë liri të plotë vendimmarrje për caktimin e tij me kusht që një pjese (jo me pak se 40% të jete për investime)³⁷.


Pavarësisht se formula e grantit për periudhën në fjalë nuk ka ndryshuar kemi luhatje të mëdha e cila vjen nga rezultati i të Ardhurave të Veta të njësisë vendore të vitit paraardhës. Formula parashikon një variabël, që nëse një vit më parë njësia vendore ka performancë jo të mirë në të ardhurat e veta, vitin më pas kompensohet në Grant të Pakushtëzuar.

Një gjë e tillë, disa njësi vendore kryesisht komuna, nuk i ka bërë të interesuara të rrisin të ardhurat e veta meqë do zbritet Granti në vitin më pas. Po të shikohet, në Grafikon IV.23 të Ardhurave të Veta në vitin 2011, të ardhurat janë rritur në krahasim me vitin 2010, për pasojë Granti në vitin 2012 ka ardhur më i ulët.

³⁷ Kjo vlerë ndryshon sipas formulës së grantit dhe kushteve buxhetore të vendosura nga qeverisja vendore.


Grafiku IV.22: Grant i Pakushtëzuar Qarku Lezhë (2002-2014)

Burimi: Ministria Financave, Llogaritjet e veta.

Grafiku IV.23: Të ardhurat e veta Qarku Lezhë (2002-2014)

Burimi: Ministria Financave, Llogaritjet e veta

Interesant është fakti që në periudhën e marrë në studim (2002-2014), ky Grant ka ardhur në rritje. Për sa i përket këtij lloji financimi të qeverisjes vendore, njësitë vendore nuk kanë asnjë lloj lirie veprimi për të ndryshuar paracaktimin apo vendin e fondit. Ky fond përbëhet nga financime për investime të ministrive sipas sektorëve respektiv ku njësitë vendore konkurrojnë për të fituar financimin e projekteve të tyre.


Grafiku IV.24: Granti i Kushtëzuar - Qarku Lezhë (2002-2014)

Burimi: Ministria e Financave, Llogaritjet e veta


Në paraqitjen grafike të mësipërme shikohet se, duke filluar nga viti 2002, progres është bërë. Të ardhurat vendore janë rritur ndjeshëm si vlerë absolute, po kështu është rritur me të njëjtin gradient edhe Granti i Pakushtëzuar.

Një tendencë më dinamike shikohet pas vitit 2008, një rritje të një gradienti shumë domethënës. Kjo rritje e fondeve të ministrive në nivel vendor, për çështje që i përkasin funksioneve të përbashkëta të njësive vendore, shikohet që ka ndodhur pikërisht kur ka filluar dhe një ulje e moderuar e të Ardhurave të Veta dhe Granteve të Pakushtëzuara të njësive vendore (shih Grafikon IV.22, IV.23.).

Kjo tregon, mes shumë analizave që do të bëhen këtu, që shpenzimet në nivel vendor janë rritur, që ministrinë e linjës nga viti në vit (sidomos pas vitit 2008) kanë rritur shpenzimet në Qarkun Lezhë dhe që njësitë vendore pas këtij viti (2008) kanë patur një ulje e të Ardhurave të Veta (nga taksat e tarifat vendore) e cila tregon një mos interesim të tyre sa i përket këtij funksioni. Pas vitit 2012, vërehet një tendencë për rritjen e të Ardhurave të Veta, por siç do ta shohim në Grafiku IV.25 më poshtë me një ulje të shpenzimeve në Qarkun Lezhë nga ana e FZSHH-së. Fondet e FSHZH-së janë fonde të investuara kryesisht për objekte infrastrukture siç tregohet në Grafiku IV.26.

Grafiku IV.25: Investime FZSH Qarku Lezhë (2002-2014)

Burimi: FSHZH

Grafiku IV.26: Shpërndarja e financimeve të FZHR 2009-2014

Burimi: OSBE; FSHZH

4.3. Analiza e Treguesve Ekonomik dhe Fiskal (2002-2014)

Nisur nga sa prezantuam dhe komentuat në kapitullin më sipër, mund të themi që, pavarësisht rritjes së Grantit të Pakushtëzuar për periudhën (2002-2014) me dy herë, ose rritjes së të Ardhurave të Veta nga viti në vit dhe një ngecje apo amulli në 2008-2014, si dhe rritjes dinamike pas vitit 2008 të Granteve të Kushtëzuara, sërish shpenzimet e qeverisjes vendore në raport me PBB-në janë në nivelin 1.8% (2008) në 2.3% (2014)

që është dhe më e fundit në Rajon e Ballkanit Jugperëndimor (siç pamë në Kapitullin III). Por, a kanë ndikuar këto shpenzime në rritjen e biznesit, rritjen e të ardhurave nga biznesi, si dhe rritjen e punësimit në Qarkun Lezhë? Këto pyetje lidhen me pyetjet kërkimore.


Cilët janë faktorët e decentralizimit fiskal dhe si ndikojnë ato në rritjen apo përmirësimin e indikatorëve të zhvillimit ekonomik vendor?

Nga Grafiku IV.27, shohim që nga viti 2002 kemi një rritje të numrit të bizneseve të vogla deri në vitin 2008, kur edhe të ardhurat vendore filluan të bien si dhe Granti i Pakushtëzuar filloi të bie. Numri i ndërmarrjeve të vogla ka një rënie të dukshme. Pavarësisht, siç e pamë në kapitullin e mësipërm, që shpenzimet e qeverisë për investime të ministrive të linjës dhe kryesisht në infrastrukturë janë rritur nga viti 2008 (Grafiku IV.25), numri i bizneseve të vogla ka rënë. Nga sa prezantuam më sipër në këtë kapitull nxorëm që bizneset e vogla e të mesme në Qarkun Lezhë zënë mbi 90% të numrit total të bizneseve. Trendi i numrit të bizneseve ndjek në mënyrë bashkëvepruese trendin e grafikut e të Ardhurave të Veta të njësive vendore, për pasojë 90% e bizneseve të këtij qarku janë të lidhura me këtë trend. Shpenzimet e granteve të kushtëzuara si dhe shpenzimet e FSHZH-së, siç jepen në Grafikon IV.24 dhe Grafikon IV.25 nuk duket se kanë një ndikim në këtë klimë biznesi. Natyrisht infrastruktura është e rëndësishme, por kjo kërkon një autonomi vendimmarrëse për të patur ndikim në tipologjinë e këtyre operatorëve ekonomik siç janë mikro bizneset, bizneset e vogla dhe të mesme.

Në Grafikon IV.27 shohim se, pavarësisht uljes dhe ngritjes së numrit të bizneseve (2002-2014), të ardhurat nga bizneset luhaten në mënyrë me të lehtë pra jo aq dinamike (Grafiku IV.28). Edhe se, pas vitit 2008, kemi një rritje mbi dy herë të numrit të bizneseve të mesme dhe të mëdha në Qarkun Lezhë, të ardhurat pas këtij viti kanë rënë


dhe kanë ndjekur trendin e bizneseve të vogla, çka tregon që ekonomia në këtë qark është ngushtësisht e lidhur me këtë strukturë biznesi dhe se ky biznes, në shpjegimet e grafikëve të mësipërm, pas një analize krahasuese del që ka një lidhje bashkëveprimi me të Ardhurat e Veta dhe Grantet e pakushtëzuara.

Grafiku IV.27: Numri total i bizneseve - Qarku Lezhë (2002-2014)



Burimi: Drejtoria e tatimeve Lezhe, llogaritjet e veta


Grafiku IV.28: Realizimi i të ardhurave nga bizneset - Qarku Lezhë (2002-2014)



Burimi: Drejtoria e tatimeve Lezhë, Llogaritjet e veta

Rritja e treguesve rajonal fiskal e të Ardhurave të Veta dhe të Grantit të Pakushtëzuar nga viti 2002 deri në vitin 2008, si dhe rënia e tyre pas vitit 2008 me një ngritje të moderuar pas këtij viti, kanë sjellë të njëjtën qasje të shifrave të punësimit në Qarkun e Lezhës. Në grafikun IV.27 në vitet 2008-2009 dhe 2013-2014 shihen uljet dhe ngritjet. Kjo lakore tregon se pavarësisht rritjes së biznesit të madh , nga viti 2008 rreth 2,5 herë, nuk ka ndikuar në punësim. Ky është edhe një fakt tjetër që ndikimin në treguesit e indikatorëve të zhvillimit ekonomik vendor e kanë të ardhurat vendore të cilat ose janë të Ardhurat e Veta të njësive vendore ose edhe Grante të Pakushtëzuara.

Grafiku IV.29: Të punësuar- Qarku Lezhë (2002-2014)




Burimi: Drejtoria e tatimeve Lezhë, Llogaritjet e veta

Autonomia fiskale, sipas (Nakai dhe Sakata), matet me raportin e shpenzimeve/ të ardhurave të veta me shpenzimet/të ardhurat në total. Në kapitullin IV kemi folur për këtë tregues që në Shqipëri është mesatarisht 40-45%, Më poshtë po japim një grafik VI.18 për dinamikën e këtij treguesi për Qarkun Lezhë.

Duke bërë raportin e të Ardhurave të Veta/të ardhurat total dhe raportin e të Ardhurave të Veta + Grant të Pakushtëzuar (meqë bashkia ka autonomi në shpenzime)/të ardhurat totale. Shohim që me rritjen e fondeve dhe të shpenzimeve në nivel Qarku(Lezhë), autonomia fiskale ka rënë deri në vitin 2010 (vetëm 13% dhe me gjithë Grantin e Pakushtëzuar 34%). Pas këtij viti, koeficienti i autonomisë fiskale ka patur një lëvizje horizontale, pra kemi një balancë mes të Ardhurave të Veta dhe Granteve të Pakushtëzuara dhe Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (të kushtëzuar).

Grafiku IV.30: Autonomia fiskale- Qarku Lezhë (2002-2014)



Burimi: Drejtoria e tatimeve Lezhë; Llogaritjet e veta

Përfundimisht mund të themi se, koeficienti i autonomisë fiskale dhe trendi i tij, përveçse tregon autonominë fiskale në Qarkun Lezhë që është nën nivelin e autonomisë fiskale në rang vendi, tregon dhe lidhjen e ngushtë mes tij dhe numrit të bizneseve të vogla dhe punësimit si indikator thelbësor që prezantojnë edhe zhvillimin ekonomik vendor. Korrigjimi i kësaj situate, me qëllim përmirësimin e implementimit për të patur efekte në politikat e punësimit, vjen duke rritur dialogun mes Qeverisjes Qendrore dhe vendore⁷⁵.

KAPITULLI V MATJA E NDIKIMIT TE DECENTRALIZIMIT FISKAL NE ZHVILLIMIN EKONOMIK VENDOR

Siç vërejtëm në kapitujt e mësipërm, vendet e ndryshme kanë patur qasje të ndryshme në reformat decentralizuese. Një nga elementet më të rëndësishëm të periudhës së ndryshimeve pas viteve '90 ka qenë krijimi i marrëdhënieve mes qeverive qendrore dhe atyre vendore.

Reformat e qeverisjes vendore janë reforma të rëndësishme si pjesë e transformimit të sistemeve politike por në të njëjtën kohë, ato si reforma kanë dhënë edhe kontributet e tyre si reforma në zhvillimin ekonomik në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. (Horvath, M.Tomas, 2000:22)⁷⁶ Po kështu edhe në vendet e Evropës Juglindore reformat kanë pasur të njëjtën trajektore, me vështirësi më të mëdha, të filluara më vonë sidomos pas shpërbërjes të Jugosllavisë dhe marrëveshjes së Deytonit, pas marrëveshjes së Ohrit si dhe pas Planit të Ahtisarit. Nisur nga këto, autor si Will Barlett vënë në dukje që:

“Në vendet e SEE-së decentralizimi i qeverisjes në nivel rajonal qoftë në reforma administrative apo fiskale ka pasur zgjerime apo implikime të ndryshme. (Barlet, W. 2013:4)”

Sa i përket decentralizimit dhe rolit të tij në zhvillimin ekonomik, nga vëzhgimet dhe disa matjeve empirike në vendet e SEE-së kemi komente dhe përfundime të ndryshme që tregojnë se nuk ka një recetë të ngjashme apo “gjithëpërfshirëse”. P.sh në Bosnje-Hercegovinë, prishja apo dëmtimi i kapitalit social dhe humbja e besimit reciprok ka dhënë një efekt negativ në sektorin e zhvillimit të SME-ve (Rus and Iglic, 2005-Barlet,W:7). Duke i krahasuar këto me modele transformimi në Poloni apo edhe në

Sllloveni (Evropa Qendrore dhe Lindore) kur politika fokusohet në krijimin e mundësive duke mobilizuar resurse vendore ajo mund edhe të mbështetet nga burime të jashtme për financime infrastrukturore apo rritje kapacitetesh njerëzore. Në këto vende shumë vëmendje i është dhënë raportit apo ndërlidhjes mes decentralizimit dhe rritjes ekonomike apo zhvillimit ekonomik.

Duke përmirësuar llogaridhënien apo edhe raporteve dhe marrëdhënieve në term, atë vetëqeverisjes vendore, ka mendime që decentralizimi mund të mbështesë zhvillimin vendor dhe për rrjedhojë nga shuma e këtyre ekonomive vendore sjell ngritjen e ekonomisë së vendit. (Oates, 1993).

Por a mund të kemi evidencë empirike nga këto vëzhgime, dhe si janë ato në vendet e tjera të Evropës Lindore apo Qendrore? Sipas Limi (2009), ka studime që kanë gjetur lidhje mes decentralizimit dhe rritjes ekonomike, ndërsa të tjerë kanë gjetur lidhje negative (Rodrigues Pose and Bodman, 2011). Kurse të tjerë nuk kanë gjetur lidhje apo ndërveprim ndërmjet këtyre ndryshoreve (Rodrigues Pose and Bëire; Bodman 2011). Për ekonomitë në ndryshim, Rodrigues Pose dhe Kroijer (2009)⁷⁷, kanë gjetur në matjet e tyre empirike lidhje negative mes rritjes ekonomike dhe decentralizimit fiskal në 16 vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, edhe pse rritja e fuqisë për taksa vendore duhet të ketë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. (Bartlett. M; Malekoviç. S; Manastiriotis. V, 2013:8)

5.1. Zgjedhja e Modelit Ekonometrik

Prezantuar nga shume autorë në vende të ndryshme marrë në konsideratë stadi të ndryshme apo edhe kohë të ndryshme dhe qasje politike të ndryshme kanë arritur në konkluzione të ndryshme, pesimiste apo optimiste bile edhe neutral. Kjo të intrigon që

në këtë punim të bëhet një matje e tillë për herë të parë në Shqipëri duke zgjedhur njësinë (njësitë vendore), intervalin kohor se kur të bëhet studimi dhe indikatorët zhvillimor dhe fiskal.

Në tabelën V.1 janë indikatorët të cilët formojnë ndryshoret e varura dhe të pavarura. Modeli i zgjedhur është ai i regresit linear të shumëfishtë. Zgjedhja e këtij modeli u bë bazuar tek punimet analoge dhe siç do ta shohim më poshtë rezulton i përshtatshëm për të dhënat tona.

Nga kjo metodë do kemi disa përfundime: N.q.s. kjo metodë vlen për sa më sipër, pra nëse ndryshoret janë në ndërveprim, nëse kanë ndikim indikatorët fiskal (pra ndryshoret e pavarura) në ato zhvillimor (ndryshoret e varura) dhe sa është pesha e këtyre indikatorëve në këtë ndikim nëse ka.

5.2. Regresi i shumëfishtë (trajtesë e shkurtër teorike)

Modeli i regresit linear të shumëfishtë shprehet me ekuacionin:

$$y = \beta_0 + \beta_1 x_1 + \beta_2 x_2 + \dots + \beta_k x_k + \epsilon$$

Ekuacioni i regresit të shumëfishtë $E(y) = \beta_0 + \beta_1 x_1 + \beta_2 x_2 + \dots + \beta_k x_k$

Bazuar në të dhënat e zgjedhjes, gjendet ekuacioni i vlerësuar i regresit të shumëfishtë në të cilin koeficientet gjenden nëpërmjet metodës së katrorëve më të vegjël.

Ekuacioni i vlerësuar $\hat{y} = b_0 + b_1 x_1 + b_2 x_2 + \dots + b_k x_k$

Përpara se të kryhet analiza, duhet të shihet plotësimi i supozimeve të modelit të regresit të shumëfishtë. Këto supozime janë:

1. Modeli është linear në parametra

2. Zgjedhja duhet të jetë e rastit dhe asnjë ndryshore e pavarur nuk duhet të jetë perfekt kombinim linear i ndryshoreve të tjera.
3. Mbetjet kanë shpërndarje normale dhe vlera e pritshme e termit të gabimit është 0.
4. Mbetjet janë homoskedastike, pra varianca (mospërputhja) e mbetjeve është konstante.
5. Mbetjet, në dy periudha të ndryshme kohore, janë të pa bashkevepruara (pra të pavarura).

5.3. Përzgjedhja e indikatorëve (ndryshoreve të pavarura dhe të varura)

Për të matur decentralizimin fiskal janë përdorur këto ndryshore:

- 1) Granti i Pakushtëzuar, 2) Të Ardhurat e Veta, 3) Shpenzimet e Veta, 4) Investime të FSHZH (transfertë e kushtëzuar)

Zgjedhja e tyre është bërë duke ditur se këto indikator janë elementet që përbëjnë strukturën e të ardhurave/shpenzimeve të njësive vendore për të cilat njësitet vendore kanë liri veprimi të plotë apo të pjesshme në vendimmarrje.

Për të matur ZHEV janë përdorur këto ndryshore:

- a) GDP/frymë, b) Realizimi i të ardhurave të qarkut nga bizneset, c) Nr. bizneseve të vogla e të mesme, d) Të punësuar.

Zgjedhja e tyre është bërë në bazë të teorisë së indikatorëve (dhënë në Kapitullin Nr. II) që matet zhvillimi ekonomik Vendor/rajonat në të cilët njësitet vendore bazuar në kompetencat e tyre kanë ndikim me vendimmarrjet e tyre sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Në analizën tonë, si variabël i varur është përdorur secili prej të ZHEV ndërsa si ndryshore të pavarura të gjithë ndryshoret që matin decentralizimin fiskal.

Modeli i regresit të shumëfishtë i ndërtuar për secilin nga rastet do të jetë si më poshtë:

- (1) $GDP/fryme = \beta_0 + \beta_1 \text{grant i pakusht} + \beta_2 \text{të ardhurat e veta} + \beta_3 \text{shpenzime} + \beta_4 \text{investime të FSHZH} + \varepsilon$
- (2) $\text{Realizimi i të ardhurave nga Bizneset Qarkut} = \beta_0 + \beta_1 \text{grant i pakusht} + \beta_2 \text{të ardhurat e veta} + \beta_3 \text{shpenzime} + \beta_4 \text{investime të FSHZH} + \varepsilon$
- (3) $\text{Nr. Bizneseve të Vogla + Mesme} = \beta_0 + \beta_1 \text{grant i pakusht} + \beta_2 \text{të ardhurat e veta} + \beta_3 \text{shpenzime të veta} + \beta_4 \text{investime të FSHZH} + \varepsilon$
- (4) $\text{Te punësuar} = \beta_0 + \beta_1 \text{grant i pakusht} + \beta_2 \text{të ardhurat e veta} + \beta_3 \text{shpenzime} + \beta_4 \text{investime të FSHZH} + \varepsilon$

Tabela më poshtë është tabelë integrale e variabëlve të varur dhe të pavarur që prezantojnë indikatorët e zgjedhur për ZHEV dhe DF.

Tabela V.1:

Indikatorët e Zhvillimit dhe Indikatorët Fiskal

	Emërtimi i indikatorëve	Shkurtime	Burimi i të dhënave
1	Prodhimi i Brendshëm Bruto në nivel rajonal për frymë	PBB/f	INSTAT
2	Numri i Bizneseve të Vogla e të Mesme jo Bujqësore të Qarkut Lezhë	NBV+M	Drejtoria Rajonale e Taksave Lezhë/INSTAT
3	Të ardhurat nga bizneset Lezhë	TAB	Drejtoria Rajonale e Taksave Lezhë
4	Të punësuar gjithsej nga Biznese jo bujqësore	PNBjB	Drejtoria Rajonale e Taksave Lezhë /INSTAT
a	Grant i Pakushtëzuar	GPK	Min. Fin, Llogaritjet e Veta
b	Të ardhurat e Veta	TAV	Min. Fin, Llogaritjet e Veta
c	Shpenzimet e Veta	SHV	Min. Fin, Llogaritjet e Veta
d	Investime nga FSHZH	IFZHS	FSHZH
e	Huamarrje Vendore*	HV	Bashkia Lezhë/Open data Albania

*Ky indikator do trajtohet në mënyrë të veçantë pas analizës së variabël it të parë (PBB)

5.4. Regresi i shumëfishtë në matje të ndikimeve fiskale në Zhvillimin Ekonomik Vendor

Analizojmë me radhë ndikimin e Variabëlve te decentralizimit Fiskal tek ZHEV.

Duke bërë analizën regressive ku si variabël i varur është përdorur log_PPB/frymë dhe si variabël të pavarur të gjithë treguesit e DF të logaritmuar, për të dhënat në formën e serisë kohore prej 2002-2014. Nga përpunimi i të dhënave me Eviews, u përftua tabela e mëposhtme:

Dependent Variable: PBB/Fryme				
Method: Least Squares				
Date: 01/04/16 Time: 16:17				
Sample: 2002 2014				
Included observations: 13				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	144.0021	23.36898	6.162102	0.0005
GPK	5.12E-05	9.13E-05	0.560350	0.5927
TAV	0.000129	0.000107	1.200422	0.2690
SHV	3.93E-05	1.66E-05	2.371661	0.0495
IFSHZH	1.58E-08	1.61E-08	0.981257	0.3592
HV	-1.78E-06	1.35E-06	-1.320260	0.2283
R-squared	0.886396	Mean dependent var	267.7385	
Adjusted R-squared	0.805250	S.D. dependent var	48.05650	
S.E. of regression	21.20754	Akaike info criterion	9.250629	
Sum squared resid	3148.319	Schwarz criterion	9.511375	
Log likelihood	-54.12909	Hannan-Quinn criter.	9.197034	
F-statistic	10.92352	Durbin-Watson stat	2.907526	
Prob(F-statistic)	0.003339			

Tabela më sipër, na mundëson gjetjen e ekuacionit linear që lidh PBB/frymë (y) me ndryshoret e pavarura GPK(x_1); TAV (x_2); SHV (x_3); IFSHZH (x_4) dhe HV (x_5).

Kemi që:

$$\hat{y} = 144 + 0.000051 x_1 + 0.000129 x_2 + 0.0000393 x_3 + 0.0000000158 x_4 - 0.00000178 x_5$$

Nga kjo tabelë shohim që:

- të gjitha ndryshoret e pavarura kanë ndikim pozitiv tek ndryshorja e varur me përjashtim të ndryshores x_5
- Ajo ndryshore që ndikon me shumë është x_3
- Modeli në tërësi është i rëndësishëm statistikisht meqë prob (F-statistic) = 0.003339 < $\alpha = 0.05$.

Kontrollojmë tani plotësimin e supozimeve klasike të modelit të regresit të shumëfishtë:


1. Mbetjet duhet të kenë shpërndarje normale

Formulojmë hipotezat:

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale

H_a : Mbetjet nuk kanë shpërndarje normale

Duke kryer testin **Jarque - Bera** kemi:



Nga kjo tabelë, meqë $p=0.98 > \alpha =0.05$, konkludojmë se hipoteza bazë nuk mund të hidhet poshtë. Pra mbetjet kanë shpërndarje normale

Po këtu, meqë $\text{Mean}=1.42\text{E}-14$, mund të themi se mesatarja e mbetjeve është 0

2.Mbetjet duhet të jenë të pavarura

Formulojmë hipotezat:

H_0 :Mungon korrelacioni serial i rendeve të larta mes mbetjeve

H_a : Ka korrelacion serial të rendeve të larta mes mbetjeve

Duke kryer testin **Breusch-Godfrey** Serial Correlation LM Test përftohet tabela e mëposhtme:

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:				
F-statistic	2.011253	Prob. F(2,5)	0.2286	
Obs*R-squared	5.795793	Prob. Chi-Square(2)	0.0551	
Test Equation:				
Dependent Variable: RESID				
Method: Least Squares				
Date: 01/04/16 Time: 16:25				
Sample: 2002 2014				
Included observations: 13				
Presample missing value lagged residuals set to zero.				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	-39.70486	32.84588	-1.208823	0.2808
GPK	0.000131	0.000121	1.078171	0.3302
TAV	-3.99E-05	0.000107	-0.373186	0.7243
SHV	-1.12E-05	1.57E-05	-0.710919	0.5089
IFSHZH	-4.41E-09	2.39E-08	-0.184575	0.8608
HV	8.98E-07	1.38E-06	0.648850	0.5451
RESID(-1)	-1.115994	0.583520	-1.912520	0.1140
				0.4224
RESID(-2)	-0.683125	0.782203	-0.873335	
R-squared	0.445830	Mean dependent var	1.42E-14	
Adjusted R-squared	-0.330007	S.D. dependent var	16.19753	
S.E. of regression	18.67995	Akaike info criterion	8.968037	
Sum squared resid	1744.703	Schwarz criterion	9.315698	
Log likelihood	-50.29224	Hannan-Quinn criter.	8.896577	
F-statistic	0.574644	Durbin-Watson stat	1.919661	
Prob(F-statistic)	0.756250			

Nga kjo tabelë, meqë $p = \text{Prob. Chi-Square}(2) = 0.0551 > \alpha = 0.05$, konkludojmë se hipoteza bazë nuk mund të hidhet poshtë. Pra, mbetjet janë të pavarura.

3. Për çdo vërtetim, mbetjet duhet të kenë shpërndarje normale me variancë të njëjtë.

Formulojmë hipotezat:

H_0 : Mbetjet kanë shpërndarje normale me variancë të njëjtë

H_a : Mbetjet kanë shpërndarje normale jo me variancë të njëjtë

Duke kryer testin **Breusch-Pagan-Godfrey**, përftohet tabela e mëposhtme:

Heteroskedasticity Test: Breusch-Pagan-Godfrey				
F-statistic	9.675029	Prob. F(5,7)	0.0048	
Obs*R-squared	11.35666	Prob. Chi-Square(5)	0.0547	
Scaled explained SS	3.010153	Prob. Chi-Square(5)	0.6984	
Test Equation:				
Dependent Variable: RESID^2				
Method: Least Squares				
Date: 01/04/16 Time: 16:25				
Sample: 2002 2014				
Included observations: 13				
Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	768.8474	174.8350	4.397561	0.0032
GP	-0.002800	0.000683	-4.098363	0.0046
TAV	-0.000292	0.000803	-0.363369	0.7271
SHV	0.000805	0.000124	6.499987	0.0003
IFSHZH	-2.73E-08	1.20E-07	-0.226777	0.8271
HV	-4.54E-05	1.01E-05	-4.499474	0.0028
R-squared	0.873589	Mean dependent var	242.1784	
Adjusted R-squared	0.783296	S.D. dependent var	340.8362	
S.E. of regression	158.6642	Akaike info criterion	13.27549	
Sum squared resid	176220.2	Schwarz criterion	13.53624	
Log likelihood	-80.29071	Hannan-Quinn criter.	13.22190	
F-statistic	9.675029	Durbin-Eaton stat	2.934017	
Prob(F-statistic)	0.004773			

Nga kjo tabelë, meqë $p = \text{Prob. Chi-Square}(5) = 0.0547 > \alpha = 0.05$, konkludojmë se hipoteza bazë nuk mund të hidhet poshtë. Pra, mbetjet kanë variancë të njëjtë.

Të hetojmë tani nëse modeli i zgjedhur i regresit të shumëfishtë është i përshtatshëm për të dhënat tona.

Formulojmë hipotezat:

H_0 : Modeli i zgjedhur është i përshtatshëm

H_a : Modeli i zgjedhur nuk është i përshtatshëm

Duke kryer testin **Ramsey RESET test**, u përftua tabela e mëposhtme:

Ramsey RESET Test:				
F-statistic	6.225836	Prob. F(1,6)	0.0568	
Log likelihood ratio	9.253295	Prob. Chi-Square(1)	0.0024	
Test Equation:				
2. Mikro ndërmarrjet janë ndërmarrje të cilat punësojnë deri në 5 punonjës.
3. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet, të cilat:
 - a) Punësojnë 6-20 punonjës;
 - b) Xhiroja vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;
 - c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të këtij ligji, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.
4. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet, të cilat:
 - a) punësojnë 21-80 punonjës;
 - b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;
 - c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte,
 të cilat në kuptim të këtij ligji, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Pra, si të tilla, zhvillimi apo përmirësimi i këtyre ndërmarrjeve janë në interes jo vetëm të qeverisjes vendore por edhe të qeverisë qendrore e cila në programin e saj ka të dy objekte kryesore: rritjen ekonomike dhe uljen e papunësisë.³⁹

Në vendet e Bashkimit Evropian SME-të lozin një rol domethënës në rritjen ekonomike, në zhvillimin ekonomik vendor, në punësim etj. Sipas Eurostat(2012) ndërmarrjet e vogla e të mesme në vendet e BE-së zënë 92.2% të numrit të përgjithshëm të operatorëve ekonomike dhe punësojnë 58.8% të numrit të përgjithshëm të punësuarve.⁷⁹

Grafiku VI.1: Numri i NVM, Punësuar dhe Vlere e Shtuar e NVM



Burimi: Eurostat/National Statistics Offices of Member States/Cambridge Econometrics/ Ecorys

Siç e kemi prezantuar në kapitujt e mësipërm pas reformave decentralizuese qeverisja vendore mori një rol të rëndësishëm në Zhvillimin Ekonomik Vendor, për pasojë edhe në ruajtjen, konsolidimin dhe rritjen e SME-ve nëpërmjet strategjive dhe planeve të zhvillimit ekonomik vendor. Njësitë vendore në Evropë filluan të lozin një rol substancial me programet e zhvillimit vendor, në krijimin e planeve të përmirësimeve

³⁹ Programi Qeverisë 2013-2017

kapitale për pasojë duke luajtur një rol bazë në zhvillimin e biznesit, kryesisht atij të vogël e të mesëm. Kjo bëri të mundur që NJQV-të të ndikonin dukshëm në hapjen e vendeve të reja të punës.

Si hap i parë për të pasur këtë qasje dhe këtë rol, u bë e mundur nëpërmjet legjislationit, duke i dhënë jo vetëm kompetenca vendimmarrëse dhe administrative por nëpërmjet decentralizimit fiskal, kryesisht nëpërmjet te drejtës për të aplikuar në tregjet financiare për të financuar planet e tyre të Zhvillimit Ekonomik Vendor.

6.2. Financimi i Zhvillimit Ekonomik Vendor.

Zhvillimi Ekonomik Vendor, si funksion i veti i qeverisjes vendore në Shqipëri

Neni 9 i Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore përcakton tre lloje funksionesh për NJQV-të: funksione e veta, të përbashkëta dhe të deleguara.

Në funksionet e veta ligji përcakton kategoritë kryesore të funksioneve të veta, të cilat përfshijnë (i) infrastrukturën dhe shërbimet publike (ii) zhvillimin ekonomik vendor (iii) funksionet sociale, kulturore dhe argëtuese si dhe sigurinë civile.

Zbatimi i funksioneve të veta është përmirësuar, ballafaquar edhe me disa mangësi të tilla si mungesa e kapaciteteve të administratës vendore për të hartuar e zbatuar strategji dhe programe të mira të Zhvillimit Ekonomik Vendor, vështirësi e pamundësi për t'i financuar këto plane, vështirësi në menaxhimin e disa shërbimeve të tilla si ujësjellës-kanalizime dhe menaxhimin e mbetjeve për shkak të mungesës së një qasjeje të qartë në lidhje me rajonalizimin apo decentralizimin e disa shërbimeve dhe gjendjes kritike të stokut të trashëguar të investimeve të munguara, e shoqëruar nga mungesa e burimeve financiare për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës vendore. Por "Politikat dhe

programet e ndërmarra për rritjen e zhvillimit ekonomik vendor nga qeveritë dhe nga agjencitë private mund të kenë efekte pozitive, ose jo. Në disa raste, mungesa e efekteve mund të rezultojë nga dizajni i dobët i programit ose nga fonde të pamjaftueshme” shprehet (Smith, 2004). Pra një nga problemet e evidentuara në mungesën e efikasitetit të planeve të Zhvillimit Ekonomik Vendor është financimi i tyre.

Financimi i Zhvillimit Ekonomik Vendor.


Në ekonomitë e përparuara qeverisjet vendore kanë mundësi të shumta, por tregjet e kapitalit dhe në veçanti obligacionet (bond) duket që janë një instrument i preferuar, falë mundësisë për të tërhequr investitorë institucionalë si fonde investimesh; afateve më të gjata të maturimit si dhe në përgjithësi mundësisë për të tërhequr hua më të mëdha siç është rasti me kreditë bankare. Në vendet e Evropës instrumentet dhe institucionet e financimit të projekteve të zhvillimit vendor janë të pranishëm në shumë forma. Në këto vende këto institucione shërbejnë si ndërmjetës për të rritur qasjen e Njësive Vendore në tregjet e kapitaleve financiare, në tregjet e kreditit.^{80 40}

Gjithsesi, kostot e qasjes në tregjet e kapitalit, në veçanti kostot e lidhura me njoftimin dhe matjen e performancës dhe vlerësimin janë relativisht të larta. Për këtë arsye, njësitë e vogla dhe të mesme vendore edhe në vendet më të pasura janë përgjithësisht të detyruara të kërkojnë terma më të favorshme nëpërmjet institucioneve ndërmjetësuese financiare, të cilat jo vetëm ulin riskun dhe kostot e huas për huamarrësit, por ofrojnë edhe siguri shtesë për huadhënësit/investitorët duke marrë përsipër kryerjen e analizave financiare dhe institucionale.

⁴⁰ European Union, Committee of the Regions, (2014) “Financing Europe 2020, a consolidated view”

Ne vendet e SEE-se situata është pothuaj e ngjashme. Grafiku VI-1 me poshtë e tregon me se miri diçka të tillë. Te gjithë vendet, pavarësisht se kanë stade te ndryshme decentralizimi fiskal siç kemi parë në kapitujt e mësipërm, tek huaja vendore kanë të njëjtin trend, rritjen e moderuar. Por, ndryshimi është se siç e pamë në të dhënat krahasuese e të ardhurave dhe shpenzimeve në vendet e Evropës Juglindore, Shqipëria zë vendin e fundit në këtë tregues ne krahasim me PBB, për pasojë mungesa e huas vendore është me e ndjeshme.

Grafiku VI -2. Ecuria e borxhit publik/PBB ne vendet e rajonit.



Burimi: IMF world economic outlook. October 2015. Ministria e Financave.

6.3. Financimi i zhvillimit ekonomik vendor rasti i Shqipërisë

Sipas ligjit organik në Shqipëri Zhvillimin Ekonomik Vendor përmbledh në vetvete:

- Përgatitjen e programeve të Zhvillimit Ekonomik Vendor;
- Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë;
- Zhvillimin i biznesit të vogël, si dhe zhvillimin e veprimtarive nxitëse si panaire e reklama në vende publike;

c) Organizimin i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor si informacioni, struktura dhe infrastruktura e nevojshme; etj.

Siç shikohet, ky funksion dhe elementet përbërës kanë rëndësi në përmirësimin e jetës së komuniteteve vendore dhe rajonale dhe për pasojë ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të punës që është një nga çështjet më të rëndësishme si për qeverisjen vendore dhe atë qendrore.

Planet e Zhvillimit Vendor dhe ato rajonal, në një nga pikat më të rëndësishme të parashikimeve të tyre dhe të ndërhyrjeve të tyre për përmirësimin e klimës së biznesit, kanë planet e përmirësimeve kapitale. Këto plane janë plane që kërkojnë paketa financiare të konsiderueshme për të pasur efektivitet në terma afatshkurtër dhe afatmesëm.

Financat vendore në Shqipëri

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila kapitullin e VI-të të saj ia kushton Qeverisjes Vendore, së bashku me miratimin e ligjit Nr. 8652, 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, sanksionohen të drejtat dhe kompetencat e njësive të qeverisjes vendore për autonomi financiare, kjo dhe në përputhje me kushtetutën. Në ligjin e mësipërm thuhet: *“Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga pushteti qendror dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare”*, si dhe *“Komuna dhe bashkia marrin hua për qëllime publike vendore, në përputhje me mënyrat e përcaktuara me ligj”*.

Nga një dokument studimor i bërë nga USAID⁴¹ dilet në konkluzion që nuk është arritur konsolidimi i autonomisë fiskale dhe për këtë duhen akoma reforma ligjore. Paparashikshmëria e transfertave financiare është e ulët si dhe funksionet përgjithësisht janë shoqëruar me financa por ku bëhet fjalë për investimet kapitale ato mbeten të pa financuara në shumicën e rasteve edhe pse qeveria qendrore është ende duke eksperimentuar nëpërmjet instrumenteve të ndryshme (skema e granteve konkurruese, fondi i zhvillimit rajonal, etj.). Varësia e qeverisjes vendore nga qeveria qendrore shikohet edhe në një aspekt tjetër, ku 53% e financave vendore (2014) përbëhen nga transfertat ndërqeveritare që janë grantet e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara (konkurruese/fondi për zhvillimin e rajoneve).

Të ardhurat dhe shpenzimet

Që me fillimin e zbatimit të strategjisë së decentralizimit dhe me vënien në zbatim të ligjit organik No.8652, të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisjes vendore në terma absolut kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Duke e konsideruar si bazë nivelin e shpenzimeve të vitit 2002, pas një dekade këto janë trefishuar.


Struktura e të ardhurave

Duke krahasuar me prodhimin e brendshëm bruto, përqindja e të ardhurave të qeverisjes vendore në raport me GDP dhe me shpenzimet e konsoliduara publike janë shumë modeste. Këto kanë patur një rritje domethënëse nga viti 2002 deri në 2007, dhe pas vitit 2010 fillon rënia e theksuar e tyre. Po kështu krahasuar me vendet e rajonit dhe të BE-së Shqipëria radhitet absolutisht e fundit. Shifrat tregojnë një rënie edhe në raport

⁴¹PLGP/USAID; “White paper on fiscal decentralization” (2012), Wright.G, Levitas.T.

me vitin 2002 e cila merret si një vit krahasues për decentralizimin fiskal, % është pothuaj në të njëjtin nivel.

Grafiku VI.3: Të ardhurat e NJQV-ve si % e PBB dhe totalit të shpenzimeve publike në 2014



Burimi: NALAS, PLGP/USAID

Ndryshimet strukturore japin përshtypjen se qeverisjes vendore i është dhënë më shumë pavarësi nga krahasimi i të ardhurave vetjake në vite, të cilat janë në mënyrë të konsiderueshme më të larta krahasuar me vitin 2002, por, në krahasimin e nivelit të të ardhurave të veta si përqindje e buxhetit të shtetit dhe të PBB-së, situata është pothuajse e njëjtë. Duke marrë parasysh edhe faktin se që nga viti 2005 më shumë funksione të reja janë transferuar në njësitë e qeverisjes vendore situata financiare i bie të jetë më e vështirë.

Si pjesë e strukturave të saj për financim, qeverisja vendore ka dhe burimet e saj të jashtme të cilat potencialisht mund të mbulojnë nevojat e saj për investime, për përmirësime kapitale në kuadër të implementimeve të planeve të saj strategjike për zhvillimin ekonomik vendor. Si burime të ardhurash të jashtme janë: Huat, Grantet, Partneriteti Publik Privat (PPP). Grantet dhe PPP nuk janë objekt i studimit.

Struktura e shpenzimeve

Kreu i IV i ligjit organik Nr.8652/2000 përcakton gjerësisht përgjegjësitë e qeverisjes vendore të mbështetura këto në parimin e subsidiaritetit parim ky në themel të kartës Evropiane të Vetëqeverisjes vendore dhe kushtetutës së vendit. Duke u ballafaquar me këto përgjegjësi, qeverisja vendore ka patur mjaft vështirësi kur bëhet fjalë për mënyrën dhe sasinë e financimit për përmbushjen e përgjegjësiave të saj. Të ardhurat e veta të qeverisjes vendore janë 44.6% (2013) e të ardhurave totale, në 2014 46.1% por janë më pak se në 2012 47.6% (Tabela VI.1), që tregon që Q.V është shumë e ndjeshme për sa i përket transfertave ndërqeveritare. IA – është edhe indikator i Autonomisë fiskale (shpjeguar në kapitullin III^{të}).


Tabela VI.1: Përbërja e të ardhurave të qeverisjes vendore në %

000L

	2010	2011	2012	2013	2014
Të Ardhurat e Veta	13,784,927	13,724,336	13,119,062	12,983,190	14,596,301
Grant i Pakushtëzuar	10,214,692	9,762,712	8,756,561	10,453,171	11,474,557
Grant i Kushtëzuar	9,251,880	6,698,803	5,672,209	5,661,569	5,574,213
Të Ardhurat e QV Total	33,251,499	30,185,851	27,547,832	29,097,930	31,645,072
Indikatori i Autonomisë (IA) %	41.5	45.5	47.6	44.6	46.1

Burimi, MF dhe llogaritjet e veta.

Shpenzimet e qeverisjes vendore janë në vitin 2013 vetëm 2.2% e GDP dhe 7.5% e shpenzimeve publike (Grafiku VI.3).

Grafiku VI.4: Tendenca e shpenzimeve te qeverisjes vendore. (2002-2013)

Burimi: NALAS; PLGP/USAID

Nga grafiku mësipërm shikohet qartë se nga viti 2007 shpenzimet e qeverisjes vendore si në raport me PBB-në është dhe me shpenzimet e konsoliduara publike vijnë në rënie, kjo pavarësisht të raportit të shpenzimeve të konsoliduara publike me PBB-në.

Tabela VI.2: Struktura e Shpenzimeve e QV-ve

%


Viti	Shpenzime aktuale për paga	Shpenzime aktuale operative dhe mirëmbajtje	Pagesa interesash	Shpenzime kapitale
2011	37.7%	29.3%	0	32.9%
2012	37.7%	29.4%	0,10	32.8%
2013	37.8%	29.3%	0,10	32.8%
2014	33.64%	31.92%	0	34.44%

Burimi MF, llogaritjet e veta

Në krahasim me vendet e tjera Shqipëria ka një nivel tepër të ulët të shpenzimeve për GDP. Po kështu, në Shqipëri struktura e shpenzimeve paraqitet në një raport ku vetëm 33% e tyre i zë zëri i investimeve dhe 38% pagat dhe 29% shërbimet. Më poshtë është grafiku, që tregon % e shpenzimeve për investime në raport me GDP krahasuar me

vende të tjera të Evropës. Investimet në QV janë vetëm 0.9% (2011) dhe investimet për frymë në Qeverisjen Vendore kanë rënë nga 21 Euro/frymë (2006) në 16 Euro/frymë (2013).

Grafik VI.5: Investimet e qeverisjes vendore si pjesë e GDP (2006-2014)



Burimi: NALAS 2012

Duket qartë që QV në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera është mjaft prapa vetëm 1% e GDP.


Grafik VI.6: Investimet e qeverisjes vendore Euro/fryme (2006-2009-2014)



Burimi: NALAS 2015

Ne grafikun VI.6 shikohet se pavarësisht se ka kuota të ulëta sa i përket investimeve për fryme ne qeverisjen vendore, Shqipëria ka pasur një trend me domethënës rritës në vitet 2006-2009. Ne intervalin 2009-2014 ky trend është shumë me modest dhe rritja për këtë interval është shumë modeste. Shqipëria, përveç vendeve të Bosnje Hercegovinës të cilat për arsye politike të vet strukturës së shtetit dhe vështirësive që kalon në konsolidimin e institucioneve, ruan vendin e fundit sa i përket investimeve të qeverisjes vendore për fryme.

Grafiku VI.7: Shpenzimet e qeverisjes vendore(% PBB) EEA 2012, Alb 2011



Burimi: Eurostat për vendet EEA; Min. Fin dhe Co-Plan për Shqipërinë – 2,1% për 2011. EU-28 mesatarja 11,8%.

Këto dy grafikë tregojnë qartë situatën e rënduar sa i përket investimeve në Shqipëri. Vetëm 1% e PBB për investime dhe vetëm 2.2% PBB (2013) për shpenzime të qeverisjes vendore. Këto dy shifra dhe situata tejet e rënduar e rrjeteve inxhinierike si dhe e nevojës për përmirësime kapitale bëjnë të domosdoshëm rritjen e këtyre treguesve nëpërmjet thellimit të decentralizimit fiskal duke u përmbajtur parimit të shumëllojshmërisë së burimeve e të ardhurave.

Ndërsa potencia financiare e granteve qeveritare u bë e qartë më sipër me shifrat e tyre modeste në krahasim me vendet e tjera të Evropës Juglindore si dhe në krahasim në vite ato kanë ardhur duke u zvogëluar (pas vitit 2007), mbetet si alternativë partneriteti Publik Privat dhe Huamarrja. Partneriteti Publik Privat nuk është qëllimi i këtij studimi për tu analizuar, ndonëse edhe në këtë instrument pjesa e partnerit Publik kërkon peshën e vet të financimit që siç e theksuam më sipër mungon.

6.4. Huamarrja, si një instrument i zhvillimit ekonomik vendor.

Huamarrja vendore është përdorur gjerësisht si instrument i rëndësishëm i financimit të planeve të përmirësimeve kapitale, plane këto që janë pjesë e strategjive të zhvillimit ekonomik Vendor. Huamarrja vendore përdoret për të njëjtat arsye si huaja nga qeverisja qendrore, për të financuar investime, projekte me rëndësi të madhe dhe me efekt domethënës në zhvillimin e qëndrueshëm. Harry Kitchen, profesor në Universitetin e Ontarios, në një punim të tij shprehet për burimet e jashtme të financimit të investimeve kapitale që është dhe substanca e Planeve të Zhvillimit Vendor, pjesa e programeve me kosto më të madhe. Ai shprehet që burimet e jashtme (njërit nga të cilëve dhe ne do i referohemi) të financimit të planeve kapitale janë: “Grantet, Partneriteti Publik Privat dhe Huat Vendore” (Kitchen, 2004).

6.4.1. Huamarrja vendore, rasti i Shqipërisë.

Para se të flasim për rastin e Shqipërisë dua të prezantoj një definicion për sa i përket Autonomisë Lokale e cila është e sanksionuar me kushtetutë e cila në nenin 13 të saj shprehet se qeverisja ushtrohet në sajë të parimit të autonomisë vendore. Po si e definon Clarc, që studion autonominë vendore e cila i shkon përshtat përshkrimit të situatës së financimit të qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore: “Përdormi i definicionit

Autonomi Vendore si një kombinim i fuqisë për nisma dhe imunitetit për kontrolle nga nivele të larta.” (Clarc, 1984.).

Huamarrja Vendore

Huamarrja vendore e sanksionuar si e drejtë dhe instrument i financimit të njërive vendore në kuadër të konsolidimit të autonomisë u bë e mundur pas miratimit të ligjit për huamarrjen vendore në vitin 2008. Ligji Nr. 9869, datë 2008/04/02 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, rregullon kushtet mbi të cilat qeveritë vendore mund të marrë borxh dhe përcakton edhe çështjet e lidhura me to. Ky ligj synon zgjerimin e autonomisë vendore përmes rregullimit të huamarrjes së qeverisjes vendore dhe krijimin e mundësive të përshtatshme si dhe ofron rregullat për të siguruar një proces transparent të huamarrjes në përputhje me politikat e zhvillimit të përgjithshëm dhe që siguron stabilitetin makroekonomik dhe besueshmërinë e institucioneve publike në tregjet financiare.

Huat e para u nënshkruan në vitin 2010 nga bashkitë e Korçës, Pogradecit, Vlorës, Elbasanit, Petrelës dhe Lezhës. Portofoli i borxhit vendor është përbërë nga hua të marra në bankat e nivelit të dytë nga gjashtë bashki/komuna, për të kryer kryesisht investime në infrastrukturë.(Tabela 3). Këto punime kanë të bëjnë kryesisht me sistemime rrugësh, asfaltime, gjelbërime, rikonstruksione rrugësh në blloqe banimi dhe rrugë e lagje kryesore. Në fund të vitit 2015 ky borxh vlerësohet të jetë 940 milion lekë ose 0.065% e PBB. Në raport me stokun e borxhit publik, borxhi vendor zë rreth 0.09% të totalit.

Tabela VI.3. Huat e nënshkruara nga pushteti vendor.

	Kreditori	Huaja në milion lekë	Viti i Nënshkrimit	Afati i maturimit
Korçë	Pro Credit	100	31.03.2010	10 vjet
Pogradec	Pro Credit	113	05.10.2010	10 vjet
Vlorë	Banka Kombëtare Tregëtare	420	21.12.2010	10 vjet
Petrelë	Banka Kombëtare Tregëtare	15	04 .09.2010	6 vjet
Elbasan	Banka Kombëtare Tregëtare	141.28	29.09.2010	10 vjet
Lezhë	Raiffeisen Bank	-120		
Korçë	Intesa San Paolo Bank	200	15.05.2014	10 vjet
Elbasan	Banka Kombëtare Tregëtare	565	Maj 2014	10 vjet
Lezhë	Intesa San Paolo Bank	107.49	Maj 2014	9 vjet
Shuma	Total	1.541,77		

Burimi: Ministria e Financave

Qeveria në përpjekje të saj për të kontrolluar Stokun e Borxhit ka nxjerrë një sërë rregullash që në fakt e bënin të pamundur marrjen e huave. Në fakt, siç shprehet Bahl.R:

“Vendet në zhvillim dhe në tranzicion tentojnë të jenë ekonomi të ekspozuara, nganjëherë të vogla nganjëherë në eksporte primare relativisht të vogla, me tendencë për inflacion dhe mjaft të ndjeshme nga ndikimi i jashtëm. Pra ka argument që instrumente kryesor financiar-taksat, shpenzimet dhe borxhi – duhet të jenë të kontrolluara nga pushteti qendror. Nën centralizim financiar, qeveria ka fleksibilitet maksimal për t’iu përgjigjur çështjeve madhore”. (Bahl, 1999).

Një nga argumentet që u përdor për të frenuar huamarrjen vendore ishte dhe nevoja për mos kalim kufiri të borxhit të konsoliduar publik të nivelit të 60% të PBB-së pavarësisht, që edhe n.q.s. ato trajtoheshin me hua të gjitha njësitë vendore ato nuk do e kishin rritur borxhin më shumë se 1%. (Gjika, A: 2012)⁸¹. Gjithsesi vetë qeveria, që nga

viti 2013, e ka kaluar kufirin prej 60% të PBB-së, por kufizimet e rrepta të vendosura nga Ministria Financave në Udhëzimet për NJQV^{-të} nuk janë lehtësuar ose hequr.

Kufizimet e zbatimit të ligjit.

Për të përmbushur këtë funksion, qeverisja vendore ka nevojë për resurset financiare të përshtatshme. Ashtu siç përshkrova më sipër shpenzimet e qeverisjes vendore përveç se janë më të ulëta krahasuar me vendet e tjera të rajonit ato janë më të ulëta që nga viti 2002. Po si ka rrjedhur situata për huat vendore që nga Viti 2008 e deri në fund të vitit 2013?

Më 27 janar 2010, Ministri i Financave lëshoi urdhrin administrativ Nr.857, që kufizonte kreditë gjatë vitit 2010 (për kredi-shitësi tashmë të miratuara) në 5% të shpenzimeve operative të vitit 2009 dhe në dhjetor 2010 Ministri i Financave ka lëshuar një tjetër urdhër administrativ Nr.17.752, datë 28.12.2010 duke kufizuar edhe më shumë në 2.5% të shpenzimeve operative të vitit 2009. Gjatë vitit 2011 dy urdhrat e kanë kufizuar rëndë aftësinë e komunave për të marrë borxh gjatë tre viteve të fundit, pavarësisht miratimit të legjislacionit që është projektuar për të bërë financimin e borxhit. Si përfitues nga ligji i huamarrjes për njësitë e qeverisjes vendore janë vetëm 6 njësi vendore nga 373 të tilla.

Në tabelën VIII.3. paraqitet ecuria e nënshkrimit të marrëveshjeve për huamarrjen vendore. Siç evidentohet më sipër angazhimet për nënshkrim të marrëveshjeve të reja me pushtetin vendor ka vetëm në vitet 2010 dhe 2014. Në 2010 filloi për herë të parë procesi i huamarrjes vendore dhe në 2014 u hoqën kufizimet e vendosura në vitet 2010-2013 (udhëzimet e Ministrit të Financave lidhur me pagesat e huas vendore dhe heqja e kufizimit të stokut të borxhit publik).

Tabela VI.4 Stoku i borxhit vendor sipas NJQV.

NJQV	Stoku 2010	Stoku 2011	Stoku 2012	Stoku 2013	Stoku 2014
Korçë	44.36	63.98	82.42	75.46	211.90
Pogradec	18.00	33.72	31.15	28.35	25.23
Vlorë	59.70	55.22	82.89	126.51	111.55
Petrelë	6.00	9.00	10.50	11.17	8.67
Elbasan	19.20	48.26	67.12	119.28	419.66
Lezhë	-	7.70	13.80	30.20	77.88
Stoku i borxhit vendor	147.26	217.88	287.88	390.97	854.88

Burimi: Ministria e Financave

Pjesën më të madhe të portofolit të stokut për vitin 2015 e kanë bashkitë e Elbasanit (49,09%), Korçës (24,79%), Vlorës (13.05%) dhe Lezha (7,85%).

Ne tabelën VIII.5 jepet dinamika e pagesave. Gjatë viteve 2010-2013 ecuria e pagesave të huamarrjes vendore ka qenë e ngadaltë dhe në nivele të ulëta të cilat realisht ishin në trend zbritës për shkak të ruajtjes së limiteve të borxhit publik në raport me PBB.

Tabela VI.5. Ecuria e pagesave.**(2010 - 2014)**

Ne milion ALL	Disbursimet 2010	Disbursimet 2011	Disbursimet 2012	Disbursimet 2013	Disbursimet 2014
Korçë	45	23.8	24	0	149
Pogradec	18	18	0	0	0
Vlorë	59.7	0	35	56	0
Petrelë	6	3	3	3	0
Elbasan	19.2	32.03	25	65	317
Lezhë	0	8.24	8	23	52
Total pagesat	147.90	85.07	95.00	147.00	518.00

Burimi: Ministria e Financave

Në pamje të parë dhe natyrisht bën kuptim që qeverisja qendrore ka për detyrë dhe bën kujdes për kontrollin e treguesve makroekonomike ndër të cila edhe nivelet e borxhit të

konsoliduar publik, por, është e dukshme se çështjet e kontrollit të termave dhe kostove të borxhit publik nuk duhet të anashkalojnë dhe të lenë jashtë vëmendjes qoftë tregues e rritjes ekonomike qoftë programet e uljes së papunësisë që trajtohen në nivel vendor.

Evidentoj këto probleme nisur nga struktura e ekonomisë së vendit që dominohet nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme të cilat kanë për natyrë lidhje të forta me komunitetin, gjë që i sjell shumë afër qeverisjes vendore e cila është sipas ligjit përgjegjëse për përmirësimin e ambientit për bizneset e tyre nëpërmjet programeve të zhvillimit ekonomik dhe planeve të përmirësimeve kapitale. E thënë me fjalë të tjera, qeverisja qendrore duke kufizuar nismat vendore dhe autonominë fiskale nuk bën gjë tjetër por pengon dhe zvarris dhe dy objektiva tejet madhore për të, siç janë rritja ekonomike dhe ulja e papunësisë.

Pra, siç shprehet Ahmad J. "Me marrëdhënie të shëndosha fiskale ndërqeveritare dhe rregullim të duhur, huamarrja në nivel vendor është edhe e mundshme dhe e dëshirueshme. Aty ku këto kushte nuk janë në vend, huamarrja në nivel vendor mund të çojë në detyrimet e paplanifikuara për qeverinë qendrore dhe në këtë mënyrë duhet të kufizohen, ndërsa institucionet që mundësojnë janë zhvilluar' (Ahmad, 1999). Pra një rëndësi ka kuadri rregullator jo bllokimi absolut. Po kështu, Litwack, Ahmed, J, Bird (1998)⁴² definojnë që qeverisja vendore duhet të mundësohet të marrë hua sepse ajo kërkon akses në tregjet financiare për dy arsye kryesore; **e para:** për të financuar shpenzimet kapitale në situata të vështira ekonomike, **e dyta:** kërkesa për hua dhe mundësi në tregje financiare është një sinjal për një zhvillim të dobët në qeverisjen vendore kështu indirekt ajo nxit llogaridhënien politike.

⁴² Ahmad, J. (1999, January). Decentralizing Borrowing Powers. World Bank/ Number 15, January 1999,

Situata në huamarrjen vendore në Shqipëri, është në kundërshtim edhe me Strategjinë e BE-së e miratuar nga takimi ndërministror i Sarajevës për “Rritjen e Punësimit në Rajonin e Evropës Juglindore”⁸², ku në mes të tjerash thuhet: Krijimi i një mjedisi të tillë kërkon më shumë se sa eliminimin e tatimeve të rënda mbi bizneset dhe një reduktim në çmimet diskriminuese e shërbimeve publike për subjektet private. Qeveria vendore duhet të pajisen me të ardhura të veta të përshtatshme dhe transferta qeveritare të parashikueshme dhe të përshtatshme në përputhje me parimet e parashikuara në Kartën e BE-së për Vetëqeverisje Lokale.

6.4.2. Marrëveshja me FMN-në dhe kufizimet që sjell në huamarrjen vendore.

Gjatë vitit 2013 nuk kishte asnjë huamarrje të re dhe kufizimet për pushtetin vendor ishin të ndjeshme në vijim të urdhrave të mëparshëm për uljen e pagesave (nga 5% në 2.5% të shpenzimeve të një viti më parë). Në kushtet e heqjes së kufizimeve të borxhit publik (60% e PBB) ishte përsëri prezent mungesa e qartësisë së ecjes përpara lidhur me borxhin dhe nivelin e tij sa i përket njësive vendore. Gjithsesi, gjatë vitit 2014, në kushtet e mungesës së limiteve ligjore, Ministria e Financave lejoi huamarrjen vendore me kredi të reja. Ndërkohë në situatën financiare të krijuar gjatë viteve 2014-2015 kërkohej konsolidimi i financave publike dhe në marrëveshje me FMN u përgatitën parashikime për uljen e stokut të borxhit publik në një periudhë afatmesme. Por në këtë kohë nuk pati ndonjë qëndrim të qartë për hapësirat e huamarrjes vendore, ndërkohë që vijonte huamarrja për qeverisjen qendrore. Në vitin 2015, Ministria e Financave në kuadër të stabilitetit makroekonomik dhe reformës territoriale nuk ka klasifikuar asnjë njësi vendore të mundur për të marrë hua.

Viti 2014 ishte viti i një marrëveshje me FMN për trajtimin dhe ratifikimin e borxhit publik dhe huas për të mbuluar deficitet buxhetore. Situata e borxhit kishte dy pamje, atë të njohur dhe një anë të panjohur në raport me detyrimet e qeverisë për faturat e papaguara për shërbime dhe investime të bëra ndër vite nga operator ekonomik të ndryshëm kryesisht pune në infrastrukture.

Në pamundësi për t'iu përgjigjur shpenzimeve të larta, në kushtet e mungesës së lartë të përgjegjësisë nga ana e qeverisë, u akumuluan qindra fatura të papaguara. Rreth 6% e GDP ishte borxh i fshehur dhe bashkë me të, borxhi publik në total shkoi në rreth 70%. Pjesa më e madhe e pagesave të prapambetura ishin investime publike, por dhe shpenzime në arsim, shëndetësi, vonesa të gjata në kompensime të TVSH dhe në pagesat e taksës mbi fitimet.

Kështu FMN, në pikën No.60 të marrëveshjes shprehet për “ Zhvillimin e një programi të reformave të qeverisjes vendore për të adresuar rreziqet/risqet fiskale”. Përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe rritjen e kapaciteteve që duhet për të zvogëluar rreziqet fiskale, ndërkohë përmirësimin dhe cilësinë e shërbimeve publike në nivel vendor. Mbështetja aktuale nga marrëdhëniet bilaterale dhe me BE-në për të krijuar njësi më të mëdha dhe më efikase të qeverisjes vendore duhet të vazhdojë.’ (IMF, 2014).

Marrëveshja e FMN (e ri negociuar), e cila vë në detyrë të qeverisjes qendrore kontrollin me rigorozitet të treguesve makroekonomik, ndër të tjera edhe ato të Borxhit të konsoliduar publik, vë gjithashtu si një kusht edhe mbajtjen në nivel konstant edhe të shpenzimeve të qeverisjeve vendore për vitet e ardhshme në nivelin 2,1% të GDP.

Kjo situatë dhe kjo prognozë e bën të vështirë thujtë të pamundur rolin e njësive

vendore në zhvillimin ekonomik vendor nëpërmjet përdorimit të këtij instrumenti.

Po kështu në këtë marrëveshje FMN shprehet që brenda një skenari bazë Borxhi Publik do kalojë nën shifrat e 60% të GDP vetëm në fund të vitit 2019. Pra, parakushtet e Ministrisë së Financave për të bërë të pasur të drejtë për Hua nga Qeverisja Vendore realizohen vetëm në fund të vitit 2019.

6.5. Konkluzione dhe Rekomandime

6.5.1. Konkluzione

Sa i përket situatës nisur nga raportet teorike në lidhje me financimin e zhvillimit ekonomik vendor si dhe me situatat në rajon duke u krahasuar edhe me treguesit fiskal identifikohen një sërë faktorësh pengues objektiv dhe subjektiv që QV-ve ju heqin mundësinë për të luajtur rolin e saj kushtetues dhe ligjor në Zhvillimin Ekonomik Vendor nëpërmjet pamundësisë së financimit të projekteve me peshë të madhe financiare. Më poshtë po radhisim një pjesë të tyre si gjetje nga trajtesa dhe analiza e mësipërme:

- a. Financat vendore, grandet e kushtëzuara, të pakushtëzuara si dhe të ardhurat e veta janë modeste për programe të investimeve kapitale. Ato aktualisht mundësojnë mbulimin e shërbimeve në mënyre, tradicionale, modeste dhe pa standard.
- b. Qeverisja vendore në Shqipëri e ka të pamundur të ushtrojë funksionin e saj kushtetues dhe ligjor sa i përket zhvillimit ekonomik vendor për arsye se asaj i mungojnë kapacitetet financiare.

- c. Me kalimin e kohës si rezultat i rritjes së nevojës për të financuar kostot e amortizimeve të kapitaleve themelore nevoja për ndërhyrje do jetë akoma më e madhe. Degradimet e projekteve inxhinierike në mungesë të këtyre ndërhyrjeve dhe amortizimi i pronave në mungesë të vënies në efikasitet do ketë akoma më shumë nevojë për ndërhyrje financiare.
- d. Financimi i programeve të qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore nëpërmjet granteve konkurruese (kushtëzuar) paraqet mungesë kriteresh objektive dhe nuk ka shumë transparencë.
- e. Investimet në nivel vendor dhe rajonal nga programe dhe ndërhyrje nga Qeverisja Qendrore rrisin pabarazinë rajonale duke përqendruar financat dhe burimet e afta njerëzore në rajone apo akse të caktuar zhvillimor.
- f. Nevoja për kontroll makroekonomik nuk duhet të shkelë autonominë vendore, sidomos atë fiskale si dhe të reduktojë fuqinë e nismave të qeverisjes vendore.
- g. Qeveria çdo vit merr hua në tregun financiar dhe një pjesë e kësaj huaje kalon në qeverisjen vendore nëpërmjet granteve të kushtëzuar që administrohen nga fondi i zhvillimit të rajoneve, apo Fondit Shqiptar të Zhvillimit.
- h. Marrëveshja me FMN e bën të pakuptimtë debatin në këtë pikë pasi ka një kufi shumë domethënës dhe nuk nxit qeverisjen vendore të rrisë të ardhurat e saj nëpërmjet programeve të zhvillimit ekonomik vendor.

6.5.2. Rekomandime

Siç shihet nga analiza dhe nga gjetjet në fund të saj, Qeverisja Vendore mund të thuhet i ka duart e lidhura sa i përket gjetjes së instrumenteve financiar, kapitaleve financiare të cilët do financonin Zhvillimin Ekonomik Vendor. Pa këto instrumente QV vështirë se

mund të luaj rolin e vet duke përdorur vetëm të ardhurat e saj si nga tatimet por dhe taksat po kështu dhe me anë të granteve të pakushtëzuara apo konkurruese. Nisur nga analiza e mësipërme, sigurisht aq sa ishte dhe objekti i kësaj teme, mund të ofrohen këto rekomandime:

- a. Rishikim i ligjit për huamarrjen vendore me qëllim të rritjes së autonomisë fiskale vendore duke reduktuar peshën e QQ në ngushtimin e Autonomisë Vendore e cila frenon edhe Iniciativën Vendore në fusha të Financimit të Projekteve në mbështetje të Planeve Strategjike të Zhvillimit Vendor.
- b. Rishikim i marrëveshjes me FMN-në në lidhje me shpenzimet e qeverisjes vendore duke parashikuar rritjen e peshës specifike të Shpenzimeve vendore në Raport me GDP deri në vitin 2019 aq sa është edhe marrëveshja me FMN^{në}.
- c. Kontrolli i treguesve makroekonomik më saktë uljes së stokut të borxhit publik duke financuar dora-dorës programe të zhvillimit ekonomik vendor nëpërmjet marrëveshjes mes përfaqësuesve të Qeverisjes Vendore dhe QQ. Këtë rol mund ta luaj Këshilli konsultativ QQ me QV që mendohet të ngrihet gjatë vitit në vazhdim.
- d. Ndarje në përqindje të peshës së borxhit publik në mes të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore duke identifikuar dhe aprovuar indikatorë më të qartë nxitës dhe kontrollues për huamarrjen vendore.
- e. Krijimi i një institucioni të specializuar në financimin e projekteve vendore që do të shërbejnë si ndërmjetësues financiarë për të lehtësuar mundësinë e njësive të qeverisjes vendore në tregjet e kreditit dhe të kapitalit. P.sh. këtë rol mund ta luajë Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

- f. Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore të QV dhe të agjencive të tjera për të bërë të mundur që ato të luajnë rolin e tyre me efikasitet dhe efikasitet.

KAPITULLI VII GJETJE, KONKLUZIONE, REKOMANDIME

Bazuar në gjetjet gjatë studimit, bazuar në punën kërkimore ky kapitull prezanton gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për të ardhmen e njësive vendore. Këto rekomandime i drejtohen mjedisit të zyrtarëve vendorë dhe institucioneve të politik bërjes dhe atyre vendimmarrëse. Duke patur parasysh se analiza në gjithë punën kërkimore nuk është shteruese, ky punim i vihet në dispozicion modestësisht studiuesve dhe ekspertëve të fushës që të përdorin, aq sa e shohin të arsyeshme, konkluzionet dhe rekomandimet duke u bazuar në kërkimet e bëra dhe duke uruar që një trajtesë e tillë të vijojë në të ardhmen.

Këto rekomandime do të ndihmojnë njësitë vendore të kuptojnë në mënyrë empirike, krahasuese larg politikave të ditës rolin, nevojat dhe mundësitë e tyre në përmbushjen e mandatit në shërbim të qytetarëve duke luajtur një rol aktiv në zhvillimin ekonomik vendor. I gjithë studimi është realizuar duke synuar plotësimin e qëllimit dhe të objektivave të temës.

Bazuar mbi teorinë e lidhjes mes decentralizimit fiskal dhe zhvillimit ekonomik vendor, gjatë punës kërkimore në këtë temë doktorate, sollëm shembuj nga vende të ndryshme të Evropës Lindore që u përfshinë në reforma decentralizuese me fokus zhvillimin ekonomik vendor.

Gjithashtu, bazuar në të dhënat nga studime dhe botime të këtyre vendeve ose nga monitorime dhe raporte të agjencive të ndryshme e partnerë ndërkombëtar që mbështetën dhe procesin, sollëm në këtë punim sjelljen e institucioneve përkatëse, të dhënat dhe rezultatet e arritura nga reformat.

Duke vëzhguar këto rezultate të vendeve të rajonit ato kaluan në një analizë krahasuese me të dhënat dhe rezultatet e Shqipërisë pamë që krahasuar me vendet e tjera të ekonomive ne ndryshim të rajonit tone jemi në vend të fundit sa i përket shumë indikatorëve fiskal vendor dhe jo vetëm.

Por analiza nuk mbeti me kaq. Puna kërkimore vazhdoi me dinamikën e këtyre indikatorëve duke i krahasuar me vetveten gjatë më shumë se një dekade. Kjo bëri të mundur që të dalin në pah, “historitë” ligjore, institucionale dhe fiskale që kanë afektuar qeverisjen vendore dhe rezultatet e saj.

Krahasimi i tyre me indikatorët e zgjedhur që japin një panoramë të zhvillimit ekonomik vendor të qarkut Lezhë nëpërmjet analizës empirike bëri të mundur që të gjejmë lidhjet mes këtyre të fundit që prezantuan ndryshoret e varura me indikatorët e decentralizimit fiskal që janë treguesit bazë dhe që u morën si ndryshore të pavarura.

Në fund, puna kërkimore përfundoi me një analizë të indikatorit apo instrumentit ligjor financiar të qeverisjes vendore siç është Huaja Vendore për të kuptuar situatën në raport me këtë instrument të përdorur në Shqipëri.

Në mënyrë të përmbledhur po rreshtojmë me poshtë gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet pas një pune kërkimore në lidhje me zhvillimit të hipotezës dhe dhënies përgjigje të pyetjeve kërkimore.

7.1. Gjetjet e punimit nga analizat

- 1) Në Shqipëri, në qeverisjen vendore, është bërë progres i madh që nga viti 1992 e sidomos mbas viti 2000. Është hartuar kuadri bazë ligjor i plotë që përfshin decentralizimin politik, administrativ dhe fiskal.

- 2) Që nga viti 1999 nuk ka patur një strategji tjetër decentralizimi që të merrte parasysh ndryshimet social-ekonomike dhe politike të ndodhura për më shumë se një dekadë.
- 3) Pas një periudhe ngritjeje të financave vendore nga viti në vit, sidomos pas vitit 2002, vitet e fundit po bien të ardhurat nga burimet e veta si dhe granti i pakushtëzuar.
- 4) Shqipëria është vendi i fundit në rajon sa përket financimeve të qeverisjes vendore në raport me PBB-në, vetëm 2.3% e PBB-së janë të ardhurat totale të NJQV-ve.
- 5) Shqipëria ka nivelin më të ulët të shpenzimeve për investime të NJQV-ve si përqindje e PBB-së si dhe kjo ka tendence të ulet më tepër.
- 6) Shqipëria është e parafundit për të ardhurat nga mbledhja e taksës së pasurisë.
- 7) Në Shqipëri, ka tendencë për rritje në mënyrë të qëndrueshme të grantit të kushtëzuar ose FZHR, duke ndikuar apo dëmtuar koeficientin e autonomisë vendore dhe duke bërë që Njësitë Vendore të jenë cenueshme nga qasjet politike të caktimit të fondeve.
- 8) Ka një boshllëk të madh mes përgjegjësi të njësive vendore dhe burimeve financiare duke bërë njësitë vendore të quhen edhe mandate të pa financuara.
- 9) Në Shqipëri nuk ka një ligj për financat vendore për pasojë kjo fushë apo ky funksion rregullohet kryesisht me ligje procedural si ligji për procedurat tatimore, ligji për sistemin e taksave vendore si dhe me ligje të buxheteve vjetore.
- 10) Si rezultat i ndërhyrjes me akte nënligjore, pavarësisht se ka një ligj për Huamarrjen Vendore, NJQV-të nuk kanë mundësi të marrin hua për të investuar planet e tyre të përmirësimeve kapitale si një nga elementet më të rëndësishëm të investimeve të planeve të zhvillimit ekonomik vendor.

- 11) Vitet e fundit, Indeksi i Autonomisë Fiskale ka rënë si rezultat i rritjes së grantit të kushtëzuar në raport me të ardhurat totale.
- 12) Financimi i programeve të qeverisjes vendore nga qeverisja qendrore nëpërmjet granteve konkurruese (kushtëzuar) paraqet mungesë kriteresh objektive dhe nuk ka shumë transparencë.
- 13) Indeksi i autonomisë fiskale të njësive vendore në qarkun Lezhë në raport me këtë indeks në rang vendi është më i ulët.
- 14) Financimi nga granti i pakushtëzuar i zhvillimit ekonomik vendor ndodhet në kuota minimale, dhe është një nga funksionet më pak të financuara të NJQV^{ve}.
- 15) Investimet në nivel vendor dhe rajonal nga programe dhe ndërhyrje të Qeverisjes Qendrore kanë rritur pabarazinë rajonale duke përqendruar financat dhe burimet njerëzore në rajone apo akse të caktuar zhvillimore.
- 16) Qeveria çdo vit merr hua në tregun financiar dhe një pjesë e kësaj huaje kalon në qeverisjen vendore nëpërmjet granteve të kushtëzuar që administrohen nga fondi i zhvillimit të rajoneve, apo nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

7.2. Konkluzione për decentralizimin fiskal dhe ndikimin në zhvillimin ekonomik vendor

Puna kërkimore që ka ndjekur zhvillimin e këtij punimi ka kaluar në një sërë etapash. Nga analiza e fakteve, situatave në qeverisjen vendore në Shqipëri, krahasimi i saj me vendet e rajonit si dhe krahasimi i situatës së decentralizimit përgjatë viteve në Shqipëri sjell një panoramë që krijon mundësinë e daljes me konkluzione.

Analiza krahasuese, ajo empirike dhe analiza statistikore dhe institucionale e gjetjeve ka bërë të mundur gjithashtu që nëpërmjet kësaj metodologjie këto konkluzione të jenë specifik dhe jo përgjithësues.

Shqipëria, qeverisja vendore, si një qeverisje që ndërtohet sipas parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë ka bërë përparime, por, vitet e fundit vend ka ngelur në vend ose ka bërë dhe hapa prapa sa i përket financave vendore.

Kjo ka ardhur para se gjithash sepse si në vendet e Lindjes në përgjithësi, si në vendet e Evropës Juglindore, por edhe në Shqipëri decentralizimi është bërë duke u orientuar nga objektiva kryesisht politik.

Trashëgimia centriste në mentalitet dhe në praktikën e drejtimit të vendit ka bërë që reformat në këtë drejtim të ecin në fillim më shpejt derisa është arritur një nivel minimal i domosdoshëm i treguesve decentralizues të pushtetit, një amulli apo ngecje në vend rezulton mbas kësaj faze dhe një hap mbrapa vitet e fundit sa i përket financave vendore. Sa i përket zhvillimit vendor, pak është bërë në këtë drejtim.

Siç është parë nga analiza e bërë në këtë punim, mungesa e planeve strategjik në njësitë vendore të qarkut Lezhë si dhe mungesa e financimeve aty ku ekzistojnë këto plane (pavarësisht se të pa përditësuar) ka bërë të mundur që zhvillimi të jetë pa objektiva të qarta, kaotik, pa rezultate domethënëse dhe me tregues dukshëm poshtë qarqeve të tjera. Pavarësisht që pozita gjeografike është e përshtatshme, qarku Lezhë nuk ka pasur mundësi të shkëputet nga vendi i fundit (në disa vite i parafundit) sa i përket treguesve të zgjedhur të zhvillimit vendor si: PBB/frymë, numri i ndërmarrjeve të vogla e të mesme si dhe punësimi/papunësia. Mungon një kuadër ligjor i dedikuar për zhvillimin vendor.

Ashtu si me të gjitha përpjekjet e decentralizimit ka rreziqe të mundshme për vazhdimin në rrugën drejt një sistemi plotësisht të decentralizuar. Disa nga këto rreziqe evidentohen më poshtë.

- Evidentohet nga gjetjet e mësipërme, krahasuar edhe me vendet e tjera në Evropën Juglindore, një mungesë angazhimi dhe i mbështetjes organizative në nivel kombëtar për promovimin e programeve të decentralizimit.
- Kushtet makroekonomike, marrëveshjet me institucionet financiare ndërkombëtare si FMN dhe BB parandalojnë rritjen e mëtejshme e të ardhurave. Po kështu, këto marrëveshje frenojnë në një farë mase arritjen e një shpërndarje më të barabartë të burimeve duke ndikuar në pabarazi rajonale.
- Në Shqipëri, deri në vitin 2014 vit që është dhe pjesa e fundit e intervalit në studim, nuk bëhen përmirësime në kuadrin ligjor dhe veçanërisht, në miratimin e Ligjit për Financat Vendore që do të stabilizonte buxhetin dhe sistemin e transfertave si dhe burimeve të tjera e të ardhurave.

Pavarësisht arritjeve vitet e fundit (2014), ka pasur një ngecje në vend sa i përket reformave decentralizuese. Vlerësimi i situatës evidenton përpjekje për të rigjallëruar, përpjekje për të arritur rezultate më të qëndrueshme në mënyrë që të bëhet e mundur që njësitë vendore të lozin një rol në zhvillimin vendor dhe jo vetëm. Situata aktuale përveç problematikës ligjore, burimeve të kufizuara financiare, aftësive dhe kapaciteteve të limituara ka dhe një mungesë dialogu politik për të analizuar dhe nxjerrë konkluzione të duhura.

Duke u bazuar në gjetjet gjatë punës në këtë temë në lidhje me hipotezën por edhe kërkimeve dhe analizës së fakteve për t'i dhënë përgjigje pyetjeve kërkimore mund të

themi që hipoteza është vërtetuar: Decentralizimi fiskal ka ndikim në Zhvillimin Ekonomik Vendor.

Analiza empirike ka bërë të mundur ndërtimin e 4 ekuacioneve të mëposhtme që japin një panoramë të qartë të lidhjes së ndryshoreve të pavarura (fiskale) me ato të varura (ekonomike vendore).

Në këto ekuacione, një pjesë e ndryshoreve fiskale kanë peshë të konsiderueshme tek një pjesë e ndryshoreve të Zhvillimit Ekonomik Vendor. Ato tregojnë peshën e secilit dhe në disa raste edhe ndikimin apo kahun e këtij ndikimi.

Nëse transfertat e pakushtëzuara dhe të ardhurat e veta do kishin një peshë specifike më të madhe në totalin e të ardhurave vendore, pra nëse qeverisja vendore financohet me tepër nga transfertat apo kanë mundësi në gjenerim më të madh të ardhurash vendore, ky ndikim do ishte akoma më i madh. Kjo mbështetet u pa dhe gjatë trajtesës së disa studiuesve që analizojnë rolin e qeverisjes vendore në Zhvillimin Ekonomik Vendor, sidomos kjo në vendet në zhvillim.

Ekuacionet janë si më poshtë dhe këtu shihen qartë faktorët (ndryshoret) me ndikim të dukshëm pozitiv (me të gjelbër), po kështu, ndryshorja me ndikim negativ (me të kuqe).

1. PBB/f	$\hat{y} = 144.8 + 0.0000668 x_1 + 0.000158 x_2 + 0.0000228 x_3 + 0.00000000927 x_4$
2. NBVM	$\hat{y} = 1904 + 0.000915 x_1 + 0.001062 x_2 - 0.00000585 x_3 - 0.000000194 x_4$
3. RABQ	$\hat{y} = 252761 + 1.628 x_1 + 2.39 x_2 + 0.09 x_3 + 0.0000542 x_4$
4. NPBjB	$\hat{y} = 8974 + 0.001 x_1 + 0.003 x_2 + 0.0006 x_3 - 0.0000000519 x_4$

Nga analiza e gjetjeve mund të radhisim këto konkluzione:

- 1) Tek ekuacioni i regresit të shumëfishtë që lidh ndryshoren e varur **PBB**, ndikimin më të madh, ndonëse jo me peshë specifike të madhe, e ka ndryshorja X_2 (**Të**

ardhurat e Veta), ndërsa ndikimin më të vogël e ka ndryshorja X_4 (Investimet e FSHZH).

- 2) Tek ekuacioni i regresit të shumëfishtë që lidh ndryshoren e varur **NBVM** ndikimin më të madh e ka sërish ndryshorja X_2 (**Të ardhurat e Veta**) dhe pas saj ndikim ka ndryshorja X_1 (**Granti i pakushtëzuar**), ndërsa ndikim negativ ka IFSHZH-ja.
